



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Rregullt e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Datë: 26 shkurt e vazhduar më 27 shkurt 2026.

Filloi në ora: 10:00.

Vendi: Salla për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në “Shtëpinë e Bardhë” - Prizren.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë të Kuvendit të Komunës: Simir Krasniqi – Kryesues, Adrit Krasniqi, Agim Muqaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj, Alban Bislimaj, Albulena Balaj Halimaj, Arianit Berisha, Astrit Temaj, Dafina Alishani, Daut Panikaj, Dea Gavazaj, Drita Qenaj, Driton Sallauka, Dzenqis Saliji, Eldis Abazi, Endrit Zogaj, Haziz Hodaj, Ilir Gashi, Karanfil Haxhillari, Liridona Veçgishti, Mergiton Gavazaj, Mimoza Memaj, Nazife Kokollari, Nerimane Pllana Gashi, Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi, Sefidin Islamaj, Selman Sokolaj, Sevil Kazazi, Sevilay Igci Hapçi, Shqipe Shatri Çoçaj, Shukri Quni, Sulltan Badalli, Tefik Tarashaj, Trëndelina Kastrati, Ymran Fusha, Zgjim Kryeziu, Zikreta Aliti.

Mungoi: Adem Shabanaj.

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Kryetari i Komunës z. Shaqir Totaj, Nënkryetari i Komunës për Komunitete z. Furkan Bütüçi, drejtorët e Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë, fillojmë pra. Përshëndetje për të gjithë. Përshëndetje të nderuar anëtarë të kuvendit. I nderuar nënkryetar i komunës për komunitete, zoti Furkan Bytyç. Të nderuar drejtorë të ekzekutivit, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe ju të pranishëm. Përshëndetje për të gjithë. Konfirmoj se në sallë janë 34 anëtarë të kuvendit dhe konstatoj se kemi kuorumin për të filluar me punimet e kësaj mbledhje. Për sot kemi thirrur mbledhjen e dytë të rregullt të Kuvendit të Komunës me këto pika të rendit të ditës, të cilat i kemi shqyrtuar dhe është rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa për në mbledhjen e djeshme. Fillojmë me rendin e ditës të përgatitur për ditën e sotme.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 16 janar 2026.

Para se ta hedhim në votim procesverbalin, fjalimet e kuvendarëve të komunitetit Boshnjak na kanë ardhur me vonesë nga zyra e përkthimeve dhe këtë votim e hedhim me plotësimin dhe fjalimet e tyre që do të hyjnë në procesverbal. A kemi diçka për të shtuar rreth procesverbalit? Atëherë që nuk kemi e hedhim në votim. Kush është për? 36 janë të pranishëm. Unanimisht votohet procesverbali pra i mbledhjes së kaluar. Atëherë fillojmë pra me rendin e ditës. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës. A keni me shtuar rreth rendit të ditës? Po, fjala për ju, Shukri Çuni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje koleg kuvendarë, ekzekutiv, përshëndetje të pranishëm. Unë kryesues edhe dje nuk e votova rendin e ditës, për shkak se është shumë i ngarkuar. Edhe çka është që nuk u pajtova më së shumti sepse janë lënë pika të cilat janë shumë me rëndësi për me i diskutu, për shembull raporti i punës, pastaj raporti financiar vjetor janar dhjetor 2025, edhe diskutim rreth raportit të zyrës kombëtare të auditimit. Domethënë, për këtë kam kërkuar që këto pika të largohen krejtësisht nga rendi ditës dhe t'i mbajmë në një mbledhje tjetër ose të hudhen në pikën e tretë atje apo të katërt. Për atë nuk jam pajtuar dhe prapë nuk pajtohem me këtë rend ditës për shkak se ka ngarkesë të madhe. Edhe kisha kërkuar që këtu, nëse janë të pajtimit edhe kolegët kuvendarë, që këto pika le të shtyhen për një mbledhje të ardhshme, po mendoj. Jo me shty këtë mbledhje, por me u caktu mbledhja tjetër që me u diskutu se janë tre pika që kanë shumë vlerë të madhe për ne me i diskutu të gjitha ato dhe me i pa se çka ka në të. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë pra, këta që nuk kanë qenë në KPF pra, ky është rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit të Ankesave;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zgjedhjen dhe delegimin e përfaqësuesve nga Ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës në Asociacionin e Komunave të Kosovës;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale KRM "Eko Regjioni" Sh.A. Prizren;

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prizren;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të tij;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad hoc për organizimin e procesit të zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të Këshillit të Fshatit Zym i Hasit;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të veprimit për transparencë 2026-2030;
12. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2025;
13. Raporti financiar vjetor janar-dhjetor 2025;
14. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2024 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024;
15. Informatë rreth raportit për planin e Integritetit për vitin 2025;
16. Informatë rreth raportit të performancës për Komunën e Prizrenit për vitin 2024;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;

Simir Krasniqi (Kryesues): E hapim diskutimin rreth rendit të ditës. Po, Dafina Alishani e ka fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Edhe ne jemi të mendimit të njëjtë meqë janë pikat tejet me rëndësi, sidomos raporti i punës së kryetarit të komunës edhe raporti i zyrës kombëtare të auditimit, ku ka rekomandime tejet serioze edhe tejet me rëndësi për secilën drejtori, mendoj që duhet, do të duhej që këto dy pika të diskutohen veçmas edhe të mirren shumë seriozisht secili rekomandim që është bërë aty, e secili edhe keq klasifikim apo shpenzime të panevojshme që ka ndodhur në drejtori. Shumica prej rekomandimeve besoj që këtu drejtorat veç janë, domethënë pavarësisht që kanë qenë në drejtori të tjera, unë mendoj që këto dy pikat lypin shumë një diskutim më serioz edhe mendoj që mirë do të ishte që së paku t'i kemi këto në fillim, më pastaj këto të tjera që kanë nevojë për votim edhe për diskutime apo informata, nuk ka problem me mbet në fund. Pra, propozoj pika 13, raporti i punës së kryetarit, raporti financiar vjetor dhe diskutimi rreth raportit të zyrës kombëtare të auditimit të diskutohet në fillim të seancës. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju, Selman.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Edhe pse në këtë rend të ditës ka shumë pika, mirëpo njëra që është harruar, apo është mënjanuar me qëllim po mendoj, është zgjedhja e anëtarëve të bordit për menaxhimin e objekteve kulturore, sportive rinore në komunën e Prizrenit. Në mandatin e kaluar nuk e keni zbatuar këtë rregullore dhe tash po shihet që nuk doni me zgjedh hiç një bord të tillë. Kështu që kjo nuk mundet me u anashkalu zoti kryesues. Domethënë për shkak se ju mund të bëni shkelje ligjore për shkak se rregulloret janë mbi kryetarin, janë mbi ne të gjithë, janë ligje që i miratojmë këtu dhe duhet t'i zbatojmë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, një sqarim këtu. Është seanca e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal pra për këtë vit. I vjen radha dhe zgjedhjes së këtij bordi. Dikush tjetër fjalën?

Atëherë e hedhim në votim pra propozimin e Dafina Alishanit. Kush është për që nga pika e 13 deri në pikën e 17 qiten në fillim të pikave. Kush është për? 11 për. Kundër? 19 kundër. Abstenim? Abstenim nuk ka atëherë mbetet ky rendi i ditës siç është rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Kush është për rendin e ditës që ky rend i ditës për ditën e sotme pra në këtë seancë? 37 janë prezent. Kush është për? 22 për. Kundër? 8 kundër. Abstenim? 2 abstenim. Atëherë, miratohet rendi i ditës ashtu siç është rekomanduar nga komiteti për politikë dhe financa. Ju faleminderit.

2. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë fillojmë me pikën e radhës. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme. Para se të fillojmë te pyetjet dhe kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme, ju kisha lutur për shkak të volumit shumë të madh të pikave që t'i përmbahemi rregullores së kuvendit dhe minutazhes. Mos të vjen deri te ajo që t'ia ndalim zërin dikujt. Pra, ta respektojmë rregulloren e kuvendit dhe minutazhen që këto pika të kryhen sa më shpejt që është e mundur. Atëherë, fillojmë pra. Fjala për ju Shqipe Shatri.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit i nderuar kryesues, zotëri Krasniqi. Edhe pse ka mungesë të ekzekutivit, megjithatë, unë çështjet janë shumë të rëndësishme, më duhet t'i parashtroj. Fillimisht, është çështja për drejtorinë e shëndetësisë. Më duhet sot ta ngre një çështje shumë të rëndësishme për fëmijët me diabet në komunën e Prizrenit. Aktualisht, ekziston një sensor modern, i cili bën matjen e vazhdueshme të glukozës, i cili vendoset në trupin e fëmijës dhe i dërgon të dhënat në kohë reale në telefonin e prindërve. Kjo pajisje po mundëson prindërve gjendjen shëndetësore me përcjellë më lehtë dhe kur ka nevojë ata menjëherë me ndërhy. Fatkeqësisht shumica e familjeve nuk kanë mundësi t'i blejnë rregullisht këta sensor për shkak të kostës së lartë mujore. Andaj kisha kërkuar nga komuna e Prizrenit, bashkë me drejtorinë e shëndetësisë që të shqyrtohet mundësia e një zgjidhje buxhetore për mbështetjen e fëmijëve me diabet në sigurimin e këtyre sensorëve dhe uroj që kjo çështje të trajtohet me seriozitet dhe të shqyrtohet pozitivisht që t'ju gjenden këtyre familjeve. Jam e bindur se një mbështetje e tillë do të ishte ndihmë e madhe për prindërit dhe në përkrahje të fëmijëve dhe shëndetit të tyre. Gjithashtu, meqë është drejtoresha e arsimit këtu, ju drejtohem edhe drejtorisë së arsimit. E nderuara drejtoreshë zonja Veselaj Gutaj, duke pasur parasysh se gjithëpërfshirja është një segment thelbësor i sistemit tonë arsimor e duke u bazuar edhe në udhëzimin administrativ të Mashtit me numër 16/2022, për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, kërkoj nga Drejtoria Komunale e Arsimit që sa më parë të rifunksionalizohet ekipi vlerësues pedagogjik komunal dhe të nis menjëherë procesi i vlerësimit dhe rivlerësimit të nxënësve që janë në pritje. Ngase vërtetë mosfunksionimi i këtij ekipi po krijon vështirësi serioze në shkolla, duke i lënë mësimmësuesit, mësuesit mbështetës, asistentët pa rekomandime profesionale për hartimin për shembull të planit individual të arsimit dhe për përshtatjen e procesit mësimor sipas nevojave specifike që kanë nxënësit me nevoja të veçanta. Ju faleminderit në konsideratë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju, Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për ju, për drejtorët, anëtarët e kuvendit, media, këtu mysafirët që janë në sallë. Nuk e di, ju kujtohet sigurisht, juve që keni qenë ekzekutiv, para pesë-gjashtë vjetëve në fillimin e mandatit tuaj në debatin publik në Gjonaj për buxhetin, e kam bërë të vetmen kërkesë dhe këtë kërkesë e kam përcjellë disa herë. Po sot nuk mund me justifikuar atë çka është bërë brenda kësaj, brenda kësaj kohe. Unë pse jam në bashkëqeverisje me ju, bashkë me anëtarët e kuvendit, nuk domethënë që nuk duhet me i ngrit edhe edhe çashtjet edhe me sy kritik me i parë. Nuk mund ta justifikoj gjithë atë punë që është bërë edhe deri edhe vijat e bardha, edhe shenjat e komunikacionit janë qit nëpër skuta, nëpër rrugë të familjeve, e lihet rruga kryesore pa u rregulluar. Ende, thashë, mbas pesë-gjashtë vjetëve kërkesë, që vazhdimisht e kam përsëritur edhe ripërsërit. Kështu që, drejtor, po ta bëj këtë kërkesë, jo sot me u përgjigj, por studioje mirë, shihe mirë dhe të lutem trego se kur mundet me u përfundu rruga kryesore në Gjonaj. Kur mundet me u përfundu? Njëherë e mirë. Apo duhet me prit ndoshta zgjedhje të tjera dhe para zgjedhjeve me shku me edhe njëherë me përshkru qashtu në atë formë që është përshkruar dhe ka mbetur në atë gjendje. Është sinqerisht për çdo kritikë dhe vazhdimisht ne që mirremi me punë, me aktivitet, vazhdimisht hasim në këto kritika se te secili qytetar, jo veç në Gjonaj por në krejt Hasin. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjalën e ka Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxha (Guxo): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. I nderuari drejtor i shërbimeve publike, është një kërkesë prej pranorëve të fshatit Vlashnje, që të ndryshohet shenja e ngasjes së makinave dhe automjeteve në brendësi të fshatit Vlashnje, sepse shqetësimi i tyre është që të bëhet parandalimi i ndonjë fatkeqësie, sepse prej orës 6:00 të mëngjesit dhe deri në orën 10:00 të mëngjesit, ka shumë automjete me tone të larta, të cilët ngasin në brendësi të fshatit Vlashnje, me shpejtësi diku 60-70km/orë. Dhe njëkohësisht i bëj thirrje edhe drejtoreshës së inspektoriatit që të qet në terren inspektoriatin të ambientit dhe të verifikoj, sepse këto kamione me zhavor të mbingarkuara nga ku janë duke shkuar dhe ku janë duke e marrë. Po ashtu edhe nëpërmjet kësaj foltore bëj apel edhe Policisë së Kosovës që të bëj shpeshherë edhe ndonjë ndalesë ose postbllok në fshatin Vlashnje, sepse kjo rrugë ka filluar të jetë rrugë tranziti edhe për shumë mallra të tjera ilegale. Ndërsa i nderuar drejtor i bujqësisë, shqetësimi i banorëve të lagjes Bajram Curri është shumë i madh. E di që ju lagjen Bajram Curri e njihni në çdo cep të saj, mirëpo ka të bëjë me qentë endacak, ku ka mbetur do të thotë përfundimi i këtij objekti, sepse ka shqetësime edhe prej prindërve të cilët po i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe ka edhe shqetësime edhe prej stafit të infermierëve të QMF-së, do të thotë janë në punë prej orës 6:30 dhe atëherë ka shumë qen endacak në lagjen e Bajram Currit. Thjesht kërkojmë që të na jepni një shpjegim se ku ka mbetur procedura dhe kur do të jetë në përfundim strehimorja e qenëve endacak. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Petrit. Fjala për ju Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues, ekzekutiv, të nderuar kolegë kuvendar. Çështja e parë që do të ngrisë është çështja e rrugëve të lagjes 2 Korriku. Është e vërtetë që me dhjetëra rrugë në lagjen 2 Korriku kanë qenë në gjendje të mjerueshme për vitete të tëra. Por tash që një vit e gjysmë, a e di nga mjerimi në çfarë gjendje janë duke kaluar qytetarët e asaj lagje, që rrjedhimisht të jenë me mijëra banorë në atë lagje, të cilët për çdo ditë kanë filluar t'i kalojë edhe në kosto, në harxhime, duke i shkatërruar veturat dhe gjithçka tjetër aty. Kur është plani që të

rregullohen dhe të ndreqen ato rrugë, sepse keq kanë qenë, po e dinë të gjithë, por janë bërë edhe më keq tashmë. Kjo është pyetja për rrugët dhe për ndriçim, po ashtu drejtori i shërbimeve publike, nuk mbahet mend ndonjë qeverisje të kalume që është shpenzuar më së shumti për ndriçim publik, sesa katër vitet e kalume. Dhe prapë sot Prizrenin e kemi pothuajse shumicën e rrugëve, si kryesore e ato lokale janë në terr. Cili është plani dhe për sa kohë drejtor do të rregullohet ndriçimi, sepse konsiderojmë që ndriçimi nuk është luks, po thjesht hyn edhe në buxhetimin gjinor, thjesht hyn edhe në sigurinë e qytetarëve dhe ndërliidhen shumë sende me ndriçimin publik në komunën tonë. Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, ne si kuvendar në mandatin e kaluar në Kab e kemi votuar kodin buxhetor 532, ku ka qenë rruga Struzhë apo Qafë Kushnini në stanët e Struzhës. Ai kod u hjek, a mund të kemi një përgjigje të saktë çfarë ka ndodhur? Sepse projekti ka filluar nga stanët e Struzhës 1.2 km, është asfaltuar, por që ka mbetur pjesa e tjetër që ka edhe 7 km për të arritur fundin e projektit. A mundem ta di çfarë ka ndodhur me këtë projekt dhe me këtë rrugë, derisa kanë filluar punimet dhe kanë mbetur në gjysmë dhe tashmë nuk i kemi as në buxhet. Pra bëhet fjalë për rrugën stanët e Struzhës qaf Kushnini. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit Karanfil, fjalë për ju, Selman Sokoli.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Çështja e parë që do ta ngris ka të bëjë me përroin në fshatin Romaj. Edhe siç dihet neglizhenca, mosplanifikimi i duhur, përveç që shkakton dëme financiare shkakton edhe rreziqe të ndryshme të cilat gjenden qytetarët, si pasojë e paaftësisë së një institucioni të caktuar për me i kry detyrat e tyre. Në Romaj ka tri vite që ka filluar të ndërtohet një perockë, maksimum ka 300 m edhe ajo nuk është përfunduar ende. Për me bë gjendjen më shqetësuese, është rritja e ujit. Aty shkakton rrezik për shkak se gjenden shtyllat elektrike të tensionit të lartë edhe një trafo elektrike. Ju keni hapur aty punimet, keni prishur shtratin që ka qenë edhe erozioni ka rreziku edhe asfaltin tani. Drejtor, mundeni me shiku këtu në foto në çfarë rreziku jeni duke sjellë banorët e fshatit Romaj, dhe të gjithë kalimtarët aty, si pasojë e neglizhencës dhe mos planifikimit të duhur, për shkak se edhe auditori në raportin për vitin 2024 ka konstatuar që në një projekt që ka kushtuar 333.000 euro, ju keni ndarë vetëm 60.000 euro dhe më nuk keni ndarë mjete financiare dhe pasojat janë këto që po i përjetojnë banorët aty. Çështja e tjetër ka të bëjë me varrezat e qytetit. E di që komuna e Prizrenit është në proces të transferimit në varreza të reja, mirëpo gjendja aktuale në varrezat e qytetit Prizren është alarmante. Punëtorët, varrmisit aty janë të rrezikuar nga dy faktorë. E para nga familjarët për shkak të lokacionit, për shkak të problemeve me caktim të lokacionit të një familjari të afërm aty në rast vdekje dhe e dyta janë të rrezikuar në shëndet, për shkak të rrezikut të shfaqjes së ndonjë epidemie për shkak se qytetarët e komunës e Prizrenit, të cilët vdesin aty, po varrosin njërin mbi tjetrin. Edhe kjo situatë është shumë alarmuese dhe komuna e Prizrenit, si masë emergjente do të duhej të merrte dy veprime. E para drejtor, që të shkojë të lirojë pronat e uzurpuar. Aty është pronë publike, aty ka familje fatkeqësisht që i kanë rrethuar hapësirat edhe pretendojnë që aty do ti varrosin familjet e tyre, mirëpo kjo nuk është e lejuar dhe komuna mund ta bëjë një veprim të tillë. Dhe e dyta që punëtorët varmisit aty, të mos kenë probleme edhe personale me qytetarët, ju duhet të gjeni një mekanizëm të caktoni hapësirën, për shkak se kontrata e Ekoregjionit ka të bëjë vetëm me hapjen edhe mbylljen, ndërsa caktimin e lokacionit duhet t'ia bëni ju. Nëse i ndërmerri këto veprime edhe do t'i lehtësoni nga problemet eventuale, me të cilat ata përballen çdo ditë, në të njëjtën kohë, do të mundësoni hapësira shtesë, për shkak se në bazë të personave përgjegjës aty, nëse lirohen

hapësirat e uzurpuara, vende në varrezat e qytetit mund të krijohen edhe për një vit, derisa të transferohemi te varrezat ose në lokacionin e ri. Çështja tjetër ka të bëjë me mungesën e arsimtarëve në shkollat e Prizrenit, po me theks të veçantë po e cekim komplet rajonin e Hasit. Të gjitha shkollat, edhe të mesmet, edhe filloret në rajonin e Hasit kanë mungesa të theksuara të arsimtarëve. Nxënësit aty humbin orë të panumërta mësimore, vetëm një orë e humbur është dëm i madh, po paramendo, edhe me gjysëm vjetore ose me vitet të tëra humbin orë për shkak të neglizhencës së komunës ose paaftësisë së komunës në hapjen e konkurseve ose sjelljen e arsimtarëve aty. Drejtoresh nëse ke kontest mund të t'i sjell të gjithë me emra edhe sa orë kanë humbur, kush mungon, të gjitha. Kështu që në rregull jemi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mundësisht në fillim ju thashë ta respektojmë rregulloren, pesë minuta. Ju dini që dy minuta te pyetjet dhe përgjigjet, gjithçka u tejkalua.

Selman Sokolaj (LVV): Unë nuk e kam matjen përpara. Tash doli, okej. Nuk e pata deri tash. Kështu, e kam me përfunduar edhe çështje sekondash. Përveç mungesës së arsimtarëve, në shkollat e komunës e Prizrenit ka dhe mungesë të nxemjeve. Edhe nëse drejtoresha gjithmonë ka arsyetim, ju lutem kamera shikoni në komunën e Prizrenit shkollat tona qysh nxehen. Shikoni çfarë nxemje është. A je duke e pa? A je duke e pa drejtoreshë në një shkollë të komunës së Prizrenit në këtë vit shkollor me çka janë duke u nxeh fëmijët. Nëse jam duke shpifë...

Simir Krasniqi (Kryesues): Mundësisht thashë që 5 minuta kaluan.

Selman Sokolaj (LVV): Nëse unë jam duke shpifë... me më paditë edhe kur është bërë...

Simir Krasniqi (Kryesues): Pesë minuta kaluan. Llogarite po e shkelim rregulloren e punës.

Selman Sokolaj (LVV): Unë i kam dy fotografi që tregojnë që me çka nxehen fëmijët tanë, nxënësit tanë në shkollat e komunës së Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë pra me diskutuesin tjetër. Fjalën e ka Sevilay Hapci. Fjala është për ju zonja Sevilay.

Sevilay Igci Hapci (KDTP): Sayın Başkan, Belediye Başkan yardımcısı, Meclis Başkanı, Müdürlerimiz ve değerli meclis üyelerimiz hepinizi saygıyla selamlıyorum ve değerli Prizren halkının öncelikle Ramazan ayını kutlarım:

Hayırlı Ramazanlar

Urime Ramazanin

Sretan Ramazan

Ramazan'ı üç dilde kutladığımız bu güzel şehrimizde gönül isterdi ki Şadırvan Meydanı ve Sinan Paşa Camii çevresindeki Ramazan süslemelerinde de yazılar üç dilde yer alsın. Anayasal hakkımız olan Türkçe ve Boşnakça başta olmak üzere resmi dillerimizin kamusal alanlarda eşit şekilde yer alması bir rica değil, bir haktır. Bu konuda İslam Birliği'ne ilettiğimiz dilekçede talep ettiğimiz düzenlemelerin yapılmasını ve yazıların yeniden düzenlenmesini bekliyoruz.

Vatandaşlarımızın dile getirdiğini aktarmak istiyorum:

Öncelikle Belediyemiz tarafından düzenlenen Bağımsızlık Günü gibi özel günlerde programların Arnavut kültür ve sanat derneklerinin yanı sıra Türk, Boşnak ve diğer topluluk derneklerine de

katılım imkânı sağlanmasını ve program duyurularının yalnızca Arnavutça değil, belediyemizin resmi dilleri olan Türkçe, Boşnakça yayımlanmasını da talep ediyorum.

3. Noktada sorum Eğitim Müdürlüğüne Ortakol semti ve yakınlarındaki vatandaşlarımızın talepleri için eğitim müdürüne sorum olacak? Ortakol Mahallesi'nde 3-5 yaş grubu için açılması planlanan (Institucioni parashkollor...) Erken Çocukluk Eğitimi kurumuna ilişkin hazırlık sürecinin hangi aşamada olduğu hakkında bilgi verilmesi ve bu eğitim kurumunda Türk, Boşnak ve diğer topluluklara mensup çocukların da kendi anadillerinde eğitim alabilmeleri için herhangi bir planlama veya idari işlem yapıp yapılmadığının açıklanmasını talep ediyorum.

4. Noktada Kamu Hizmetleri, Müfettişlik Müdürlüğüne: lise önünde çöp kutusu bulunmamasına rağmen vatandaşlarımız poşetler halinde çöplerini sabah ve akşam saatlerinde yol kenarına bırakmaktadır. Bu durum hem çevre kirliliğine hem de kötü görüntüye sebep olmaktadır. Söz konusu noktaya çöp konteyneri yerleştirilmesi kamu hizmetlerinin ve gerekli denetimlerin yapılması hususunda (Inspektorati Komunal) denetim birimlerinin çalışma başlatmasını talep ediyorum.

5. Noktada Mezarlık çeşmelerinin onarılması, vatandaşlarımızdan gelen talepler doğrultusunda Prizren Belediyesi sınırları içerisinde bulunan mezarlıklarda yer alan bazı çeşmelerin arızalı olduğu, su akmadığı veya fiziki olarak zarar görmüş durumda oldukları vatandaşlarımız tarafından tarafıma iletilmiştir arızalı mezarlık çeşmelerinin tespit edilerek gerekli bakım ve onarım çalışmalarının yapılmasını arz ederim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, ke filluar nga pak mos me i pa se ke hyp pak më lart atje, s'po na sheh neve këtu, po herët është, hala më vonë duhet pak. Drejtor i shërbime publike, një kërkese që e kam bë shumë herë, është fjala për te Hib Petrolli te rruga që shkon për në Nashec. Kam bërë kërkese aty me u bë një rreth. Shumë është i nevojshëm, sepse tash ajo rrugë është ngarkuar dhe nga ndërtimet e larta që janë bërë aty, edhe është shumë vështirë me hy. Jo me shku më te Abi Qarshia me u kthy na, se ne tash kur të vijmë prej Nashecit, sikur unë me u çu ashtu, me shku rrotull ka kryesuesi me ardh prap me u kthy këtu me hy, e me dalë jashtë te dera. Qeshtu i bie! Ne duhet me shku, po mendoj te rruga ku hyn te Hib Petrolli, me shku te Abi Qarshia me marrë aty një shëndet për të mirë, me u kthy prap në atë vendin aty, 5 m është rruga me kalu. Aty ka nevojë me u bë një rreth. Janë bërë katër rrathë, të cilat sipas meje janë shumë të panevojshëm, që është bërë tjetri menjëherë, si ta kalonë Abi Qarshin. Tjetri kalon te Viva Fresh, rruga për te Kfori që shkon, edhe plus i katërti është atje te rruga që shkon për Tabakhanë edhe për Elkos. Aty ka nevojë tash drejtor. Është kaos! Jo që ma keni gërditur edhe qytetin, po edhe rrugën mos me ardh aty pari. Tash merre me mend jemi ka shkojmë nëpër Grazhdanik, në Kobaj, në Vlashnje edhe hyjmë në Prizren. Sidomos kur ka ditë feste ose gjatë pushimeve verore për shembull ose dimërore. Aty s'ka mundësi me kalu. Ka hapësirë për me u bë rrethi. Unë e di që keni ekspert të fort, po aty duhet patjetër me u bëni një rreth. Pastaj punimet të cilat kanë filluar, në fakt kanë qenë punimet tu zhvilluar nga drejtorja e shërbimeve publike në fshatin Nashec, kanë ngecur. Unë e di që veç edhe ka kaluar edhe tri vjet, tri vjet janë bërë. Tash punimet nuk janë të kryera. I ke ata që i kanë përcjellur ato projekte, i dinë aty se deri ku kanë ngecur. Po ashtu po e përsëris edhe unë një kërkese, që në fakt një çështje që e ngriti kolegu Petrit atje kogja e kanë marrë një tabiat kur flasim ne kolegët, unë shumë mirë ju dëgjoj të gjithëve. Është çështja rruga e Nashecit me kamiona të

mëdhenj të cilët po bartin dhe materiale të ndryshme, sidomos pastrimin e qytetit që po e bëni tu i prish fabrikat e tu i çel podrume krejt jeni tu i pru në Nashecit. A ka far inspektorati aty me ardh e me këqyrë çka është kah bëhet? Duhet me qenë një farë leje aty. Po ani de mirë, le ta shënon edhe kjo drejtoresha e inspektoratit. Edhe është mirë me qit një komision me pa se çfarë debakli ka pësuar rruga e Nashecit. Ajo është shkatërruar tërësisht. Edhe kërkoj me u marrë masa serioze aty. Drejtoria e turizmit, veç që je në ngjarje edhe ti, sa herë e kam ngritur atë çështjen e atij parkut të famshëm në Nashecit atje, ku ka ngelur, ai nuk është skry. E pashë që edhe në raportin e auditorit s'ish përfshirë fare aty, se di ku është avulluar ai far projekti! Du përgjigje me dhënë për të edhe me fillu punimet edhe me u kry ajo punë. Edhe çështjen e mirëmbajtjes së lapidarëve. Kush e ka? Cila drejtori e ka mirëmbajtjen e lapidarëve? Me u deklarë haptas, kjo drejtori mirret me mirëmbajtjen e lapidareve. Lapidarët janë në gjendje, mos të flas, të mjerueshme. I keni parë edhe vetë kur keni shkuar gjatë përvjetorëve se në çfarë gjendje janë. E kalova pak kryesues por edhe kolegët e mi e kaluan. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Xhengiz Salih.

Dzengiz Salih:

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Agim Muqaj.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesues. Ekzekutiv i nderuar, kolegë të nderuar, media, qytetarë të nderuar. Edhe pse në mungesë të kryetarit, unë zakonisht kolegë të nderuar e keni vërejtje se sidomos nëpër ditë të veçanta dhe seanca solemne ju kam drejtuar dhe kam dhënë vërejtje për kryetarin, ekzekutiv dhe për të gjithë ne që e përfaqësojmë shoqërinë publike këtu në Prizren, në komunën tonë. Kam thënë se nuk mjafton vetëm me 17 shkurt, 12 qershor dhe data festive që të shkojmë në Landovicë dhe të dalim në fotografi, gjoja se po i respektojmë kategoritë e luftës. Këtë vërejtje e kam në këtë seancë, pasi që kjo sezon dimrore kaloi, ne e dimë që kemi pasur një vendim këtu në Kuvendin Komunal për ndarjen e druve, do të thotë, për familjet dëshmorëve, invalidë të luftës dhe kësaj kategorie. Tri vite do të thotë janë ndarë, janë falenderues, mirëpo viti i fundit sigurisht se e dini se edhe pse kanë pasur kërkesë të hershme që mos të ketë vonesë, ajo le që vonesë po se po, po dhe nuk u ndanë hiç. Kështu që, kisha kërkuar edhe sot në këtë seancë, nga kryetari, së paku edhe nga drejtori i Mirëqenies, edhe pse e di që zotëri Fatmir nuk jeni në dijeni rreth këtij projekti të mandatit të kaluar, kisha kërkuar që së paku publikisht ta dinë kjo kategori, dimri i ardhshëm, a do të ketë ndarje të druve, do të thotë sikur që janë ndarë tri vite rreshtazi, apo jo? Sepse ne e dimë se kjo kategori ende me një pension aq të ulët, sigurisht se e dimë që kanë banat e veta për shërbimet e veta dhe nuk mjaftojnë, edhe pse ka qenë ndoshta një ndihmë e vogël, por mendoj se ka qenë bukur shtytje për familjen në këtë sezon dimnor. Kisha kërkuar që të di gjatë këtij mandati, a do të jetë projekt vazhdues i mandatit të kaluar. Besoj se duke llogaritur sepse kush udhëheq në komunën e Prizren, sepse PDK thirret në emër të asaj se përfaqëson idealin e vlerave të luftës. Mendoj se shoqëria duhet të jetë mirënjohëse ose mosmirënjohëse ndaj kësaj kategorie. Kryetar, ndoshta veçanërisht drejtor Fatmir, pasi që i përkisni kësaj drejtorie, në bashkëpunim me ekzekutivin, kisha kërkuar, qoftë sot, qoftë në seancën e radhës, që të kem një përgjigje publike, a do të jetë ky projekti i vazhdueshëm apo të ndahen mjete me ndonjë variant subvencion apo sidoqoftë. Edhe një minutë kryesues, por edhe kisha kërkuar nga kryetari edhe e gjithë ekzekutivi, që ne e dimë që qysh në vitin 2011 është aprovuar

me ligj për kategoritë e dola prej luftës në kategori të barabartë kur janë me fakultetet të barabarta apo me magistratura, që të përfilllet ligji në punësim në çdo dikaster, të cilit i përket dhe udhëheq komuna e Prizrenit. Kisha kërkuar nga çdo drejtori, enkas këtu pasi që më së shumti ka punë Drejtoria e Arsimit, e Shëndetësisë. Mendoj se në këto dy sektorë ballafaquni me shumë kërkesa, e di që kërkesat janë të mëdhaja. E di që çdo qytetar ka të drejtë për të kërkojë punësimin dhe me kriteret e barabarta. E nderuara Luljeta Berisha, i nderuar drejtori i Shëndetësisë, pasi që në këto dy drejtori prekën më së shumti në punësim, kisha kërkuar që të merrni, ta lexoni këtë ligj mirë, po edhe t'i drejtoj edhe zyrës së burimeve njerëzore, sepse ky ligj deri më sot nuk ka hasur në realizim ashtu siç e meriton. Kisha kërkuar që së paku kjo kategori të trajtohet, gjithmonë ata të cilët e meritojnë, të cilët janë të kualifikuar, mirëpo jo, jo të injorohen dhe të gjenden mënyrat dikush tjetër, nëpërmjet raporteve të ngushta apo rrethe të ngushta kalon dhe kjo kategori sikur që e thashë, nuk mjafton ne vetëm nëpër seanca soleme ta dëgjojmë zërin e tyre, por dhe ata njerëz të cilët meritojnë sepse baballarët e tyre dikush ka ra dëshmor, dikush ka mbetur invalid i luftës, dikush edhe nuk i ka mundësitë, ndoshta nga Unë mendoj se e gjithë shoqëria, e gjithë Kosova do të jetë mirënjohës ndaj jush si ekzekutiv, që të trajtohet kjo kategori në mënyrë ashtu siç e meriton. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Sevil Kazas.

Sevil Kazazi (Ythp): Sayın Belediye Başkanı, meclis başkanı, meclis başkan yardımcısı, değerli müdürlerimiz, meclis üyeleri, medya mensupları, bizleri izleyen halkımız hepinizi saygıyla selamlıyorum. Öncelikle tüm Müslüman âleminin mübarek ramazan ayını kutluyorum. Sağlık Müdürüne bir sorum olacak, kendisi burada yok ama siz iletirsiniz diye düşünüyorum. 2025 yılında sübvansiyon için başvuruda bulunan hasta vatandaşlarımızın bir kısmının ödemeleri henüz yapılmamış, bu ödemeler ne zaman yapılacak bunu sormak istiyorum. Müfettişlik Müdürüne bir sorum ve talebim olacak; restoran ve kafelerde iç mekânlarda aşırı sigara tüketiliyor, bu durumda bir çalışmanız var mı bunu sormak istiyorum. Eğitim Müdürüne sorum olacak ve bir talebim. Daha önce de bu konuda talepte bulunmuştuk birkaç kere, okullardaki güvenlikten öğrencilerimiz sorumlu değildir. Ancak ödemeleri öğrenciler yapmaktadır, bu ödemelerin biran önce kesilmesini ve güvenlik harcamalarının belediye tarafından karşılanmasını talep ediyorum. Diğer taraftan "Motrat Qiriazhi" ilköğretim okulunda yaklaşık 2-3 aydır Fizik-Kimya dersleri görülmemektedir. Öğrencilerimizin son derece mağdur olduğu bu durumda görevini donduran öğretmenin yerine ne zaman yeni bir öğretmen atanacak? Atama yapılana kadar başka bir çözüm bulunmasını talep ediyorum, bu konuda hızlı bir çalışma yapılması gerekiyor, çünkü öğrencilerimiz derslerden uzak kalıyor ve bu da başarılarını büyük bir ölçüde etkilemektedir. Son olarak belediye başkanına bir sorum olacak. 2025 yılında AZHR ile yapılan anlaşma gereği işletmelere hibe projesi gerçekleştirildi ancak kazananların listesi 2026 yılında yayınlandı ve işletmeler hala bu hibeden yararlanamadı. Ödemelerin ne zaman yapılacağını sormak istiyorum? Teşekkür ederim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Sevil, fjala për ju Eldis Abazi.

Eldis Abazi (Vakat):

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Ka disku diskutime tjera? Po ju zonja Nerimane.

Nerimane Pllana Gashi (LVV): Faleminderit zoti kryesues. Përshëndetje për të gjithë, të nderuar të pranishëm dhe ju qytetarë të Prizrenit. Kërkesa ka të bëjë me infrastrukturën e lagjes Dardania, të nderuar drejtor të drejtorisë së shërbimeve publike dhe drejtorisë së inspektoriatit. Fëmijët e lagjes sonë janë të rrezikuar çdo ditë, pasi shkojnë në shkollë duke kaluar në rrugë ku kemi puseta të hapura, punishte pa rrethim mbrojtës, ku kemi makineri të rënda të përdorura nga bizneset e ndërtimit që lëvizin pa asnjë kontroll apo përgjegjësi. Kjo ecje bëhet në rrugë sepse trotuar nuk ka. Kam bashkangjitur fotografi, dëshmi në kërkesën time të dorëzuar muaj më parë në drejtorinë e shërbimeve publike dhe drejtorinë e inspektoriatit, ku nga drejtorja e shërbimeve publike nuk kam marrë përgjigje. Dhe një kërkesë tjetër e cila po përsëritet shpesh, mirëmbajtja e ndriçimit publik, para katër ditësh ishim dëshmitar të një aksidenti para ITP-së në hyrje të qytetit, ku shkak ishte mungesa e ndriçimit dhe shënjestimit. Në të njëjtin vend çdo javë kemi aksidente. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju, Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit, kryesues. Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, koleg kuvendar, media, si dhe qytetar. Unë kam dy kërkesa në lidhje me shërbimet publike. Fjala është për tranzitin e ri që është ndërtuar. E kam ngritur si çështje edhe mandatin e kaluar, është fjala te sinjalizimet. Domethënë një rrugë e cila ka një standart ndërtimit me ishull në mes, me dy shirita, shirit për raste emergjente dhe me pasur një kufizim të shpejtësisë 50 km/orë, unë mendoj që është një kufizim shumë i vogël dhe aty ka shumë ankesa të qytetarëve sepse ka të shumtë që bien në radar për shkak të kufizimit të vogël të shpejtësisë. Aty nuk e mendoj që kanë bërë një analizë të mirë sa i përket kufizimit të shpejtësisë. Nuk ka rrugë në Prizren që ka një standart ndërtimit më të mirë, por shpejtësia e kufizuar është më e vogël se të gjitha rrugët tjera. Është rrugë që i plotëson standardet, minimumi them, bile të jetë 60 km/orë, për shkak që mos të marrin gjoba të kota qytetarët në lidhje me kufizimin e shpejtësisë. E dyta kërkesë është, në lidhje me shërbimet publike, është rruga prej te udha Hoçës deri te rrethi i Moni Baut. Domethënë ajo pjesë i takon komunës, kurse nën rrugën e Hoçës është që i takon Ministrisë. Kisha kërkuar nga ti që të gjelbërohet edhe ajo pjesë e ishullit në mes, domethënë prej te udha Hoçës deri te ky rrethi që është i ri këtu, për shkak që mos të mbetet veç ajo pjesë pa u gjelbëruar me dru dekorativ. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Alban. Ka diskutues të tjerë? Ilir Gashi fjalën e ka.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zoti kryesues. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Një pyetje dhe kërkesë drejtorisë së shërbimeve publike. Drejtor, gjatë mandatit të kaluar, ish-drejtori premtoi që do të bëhet dislokimi i Ekoregjonit nga lokacioni ku gjendet momentalisht, për shkak se ka shumë ankesa nga banorët e lagjes përreth, nga kundërmimi i kamionëve për grumbullim të mbeturinave. Aty janë përafërsisht rreth 60 ari hapësirë, që mund të kthehen në parking nëntokësor dhe sipër mund të jetë hapësirë rekreative dhe e gjelbëruar që mund të inkorporohet në këtë projektin e shtegut buzë Lumbardhit. A vazhdon ky plan për dislokim të Ekoregjonit dhe nëse po, kur mendoni me e bë? Pyetja tjetër ka të bëjë me projektin për rregullimin e rrugëve në lagjen e Nënkalasë. Çfarë po ndodh me këtë projekt? A po vazhdon? Rrugicat në lagjen Nënkala, konkretisht rrugicat në anën e majtë të shkollës së muzikës, që shpien në drejtim të Kalasë janë gati të pakalueshme dhe ka shumë edhe mbeturina të shtëpive të rrënuara edhe rrugë, rrugicat të dëmtuara që mezi kalohet nëpër to. Çështja tjetër ka të bëjë me varrezat e reja në Landovic. Gjatë mandatit të kaluar ish nënkryetari premtoi që më së voni deri në muajin tetor do të

funksionalizohen, por ja tani jemi në muajin shkurt, në fund të muajit shkurt dhe varrezat ende nuk janë vënë në shërbim të qytetarëve. Edhe aty çfarë pengesa ka, në çfarë faze është projekti dhe kur pritet që të funksionalizohen, sepse besoj edhe ju jeni të njoftuar për gjendjen në varrezat aktuale që nuk ka më hapësira për të varrosur. Një pyetje për drejtorinë e bujqësisë në lidhje me qentë endacak dhe për strehimoren e qenëve. Jeni drejtor i ri që tash e keni marrë mandatin, por strehimorja për qen, ka shumë vite që nuk po funksionalizohet, dhe çdo vjet ka buxhet që ndahet për to. A jeni në rrjedha, çka po ndodh? Është ndarë një buxhet tash për murin rrethues dhe ende nuk po funksionalizohet, si dhe duke pasur parasysh numrin e madh të qenëve endacak dhe rrezikun potencial që mund të paraqesin për qytetarët, besoj se nuk është mjaftueshëm angazhimi vetëm një operatori ekonomik për trajtimin e tyre, ka nevojë për më shumë operator ekonomik për trajtimin e qenëve endacak dhe për krejt procedurat tjera që kanë të bëjnë për largimin e këtij rreziku permanent për qytetarët. Besoj të keni parasysh këto. Faleminderit për dëgjim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. A ka diskutues të tjerë? Dafina Alishani e ka fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Të nderuar ekzekutiv, besoj që keni pasur kohë mjaftueshëm për përhapje e urime, për hirë të korrektësisë që ju kemi lënë kohë që të adaptoheni në punët e juaja, po nuk jeni pafundësi me këto përhapja. Besoj se duheni me ja nis me punu. Edhe ju kisha lut me fillu me punu edhe me i sanu problemet e qytetarëve. Për shembull, pyetja e parë është, a mund të na informoni në lidhje me zonën ekonomike, çështja e cila është bërë përrallë në çdo fushatë, ku keni mbërri për zonën ekonomike dhe cilat janë procedurat që janë në pritje për këtë zonë, edhe sa muaj duhet të presin bizneset e Prizrenit? Po ashtu kam një pyetje edhe për drejtoreshën e arsimit. A mund të na informoni sa qerdhe janë në Prizren, se kryetari pak na pat përzi gjashtë a shtatë patë thënë në fushatë. E më shumë nëse janë, sa i ke aktive? Edhe a është e vërtetë që vajza dajës e juj është angazhuar si sekretare në qerdhen në Ortakoll? Po ashtu çka po bëhet me thirrjet e shkollave që janë për ekskursionet e shkollave. A edhe këtë herë doni me ndërhy për familjarët e juj? A është boll më apo secilin mandat e secilin vit duheni me pas patjetër një familjar që merr shërbime tek ekskursionet e shkollave. Mendoj që edhe kjo duhet ta ketë një kufi më. Drejtorja e Shëndetësisë a mund të na informojë pse nuk janë paguar pagat e punëtorëve të cilët janë të angazhuar me kontratën për shërbim nga Kosova Met? Kam pranuar disa ankesa që nuk janë paguar disa muaj. A është informuar edhe kryetari edhe drejtori për këtë çështje. Objekti Kino-Evropa ka nevojë për renovim, sepse mungesa e mirëmbajtjes të këtij objekti ka sjellë shumë dëme në objekt dhe është e pamundur të shfrytëzohet. Nën menaxhimin e kujt është ky objekt edhe a janë të informuar drejtorja përkatëse? Çështja e stadiumit Përparim Thaçi, a është dhënë leje për renovimin e stadiumit? Nëse jo a mund të prioritizoni këtë lëndë, meqë është një investim kapital i madh dhe ka rëndësi. Si dhe ku ka mbetur procesi i shfrytëzimit të këtij stadiumi. Subvencionimi për nënat lehona, kur parashihet të hapet thirrja. Edhe çështja e fundit është për drejtorinë e inspektoriateve. Drejtoreshë, me 12 shkurt një qytetar ju ka bërë një kërkesë me dalë në terren edhe nuk ka pasur reagim deri me 25 shkurt. Kërkesën që e kam pranuar po ju lexoj. Po thotë: 'po ju drejtohem për të kërkuar ndihmën për ndërhyrjen tuaj lidhur me shqetësimin serioz që e kam lidhur me një ndërtime banesor që po bëhet ngjitur me shtëpinë dhe pronën time. Fillimisht gjatë punimeve kanë rrëzuar murin dhe pse i kam lajmëruar inspektoriatin, puna ka vazhduar dhe kanë gropuar thellë. Disa herë kam shkuar te inspektoriatin me i kërku planin se ku janë pikat, nuk mi kanë dhënë. Pastaj kanë ndërtime murin mbrojtës e nuk e dimë se është vendosur në pikë të duhur.

Inspektorat nuk na japin asnjë plan të projektit, as nuk ndërmarrin asgjë për me i bë matjet. Dje është rrënuar edhe një shtëpi pa leje, ngjit me shtëpinë time, ku kemi pronë të përbashkët dhe nuk janë lajmëruar. Edhe pse i lajmërova inspektorët, më thanë se nuk kishin kohë'. Allahile çfarë punë kanë inspektorët përveçse me dalë në terren? Prej datës 12 shkurt, qytetari me ardhë tri herë në inspektoriat dhe mos me reagu, është për të ardhur keq. Rruga e ka emrin Manush Berisha. Ju kisha lutur me urgjencë t'i thirrni inspektorët dhe të dalin në terren. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Përshëndetje kryetar, drejtorë dhe ju kolegë kuvendarë. Çështjen që do ta ngrisë ka të bëjë rreth drejtorisë së bujqësisë. Para do dite kemi pasur vërshime të jashtëzakonshme, sidomos pjesa e Përdrinisë është më së tepërmi e ka pësuar. Është formuar një komision nga kryetari për vlerësimin e dëmeve. Deshta me ditë komisioni deri ku ka arritur për vlerësimin e këtyre dëmeve dhe në atë vlerësim, a janë marrë parasysh ato prona të cilat janë dëmtuar nga vërshimet. Është kjo prona se shumë toka janë dëmtuar si pasojë e vërshimeve të mëdhaja. Përveç që janë dëmtuar amvisëritë e infrastruktura po edhe pronat bujqësore. Domethënë, a janë përfshirë ato prona bujqësore që janë dëmtuar në atë vlerësim? E di drejtor që kohët të fundit kenë dalë në terren, ju përgëzoj. Inshallah vazhdoni kështu, po kontaktoni me shumë fermerë. Fermerët kanë nevojë që të dilet më shumë në terren, të kontaktoni me ta, sepse tash jemi në fillim të stinës së pranverës, ata tani kanë nevojë më së shumti për përkrahje dhe ndihmën institucionale. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Qemal. A kemi diskutime të tjera nga kuvendarët? Që nuk kemi, atëherë fjala për ju drejtor. Kush do ta merr fjalën? Po, drejtoresha e arsimit e ka fjalën. Luljeta Veselaj Gutaj.

Luljeta Veselaj Gutaj (DKA): I nderuar kryetar, të nderuar kolegë drejtor, të nderuar kuvendarë, media, qytetarë të Prizrenit. E para, po du kështu me ju thënë që ky kuvend është rezultat i votës së lirë dhe shumicën nga pakica për me zhvilluar qytetin, po dhe arsimin në Prizren, na dallojnë veç numrat. Nëse pajtoheni edhe ju! Kurse mundësitë, hapësira, edhe kontributi është i barabartë dhe i obligueshëm për secilin. Pra, para se të bëhemi të rëndësishëm, të mendojmë të bëhemi të dobishëm. Tani po fillojmë me përgjigjet e kuvendarëve. Shqipe Shatri. Faleminderit për kontributin e vazhdueshëm që e jepni dhe interesimin në arsim. Sa i përket gjithëpërfshirjes, është objektiv kryesore e Drejtorisë së Arsimit edhe në planin zhvillimor për tri vitet e ardhshme dhe komisioni për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, veçse është reviduar vendimi, për shkak se është ndryshuar udhëzimi administrativ në fund të vitit 2024 dhe ka qenë dashur të ndryshohen edhe anëtarët, ekipa e vlerësimit dhe tani është duke u përgatitur, me siguri gjatë kësaj jave veçse kanë punuar ekipi dhe kanë përgatitur agjendën për të filluar vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Sa i përket pyetjes së Sevilait, në cilën fazë është institucioni, veçse ka filluar përgatitjet, përgatitjet e brendshme, është përgatitur stafi dhe jemi në fazën e regjistrimit të fëmijëve për t'u funksionalizuar kopshtin në Ortokoll, të gjitha përgatitjet janë në fazën finale. Xhengis Salih, një pyetje tepër e rëndësishme, një shqetësim që na përcjell në secilin vit, një shqetësim për të cilin është dashur të bëhet edhe kauzë qytetare, sepse fëmijët e komunitetit turk edhe boshnjak, po dhe shumë prej tyre edhe të komunitetit shqiptar edhe sot ende janë të pasubvencionuar padrejtësisht nga Ministria e Arsimit për mjetet të cilat ju takojnë me ligj. Andaj, unë në vazhdimësi, bazuar në

kërkesat e prindëve që mi kanë adresuar, i kam adresuar këto shqetësime në Ministrinë të Arsimit dhe asnjëherë nuk ka marrë një përgjigje se pse ndodh kjo gjë dhe pse nuk subvencionohet. Përkundër faktit që është obligim ligjor dhe si prind kanë të drejtë t'i ndjekin ose të ngrejnjë edhe padi ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Divizionit i cili nuk përgjigjet. Në qoftë se dhe një fëmijë mbet pa libra, atëherë është bërë një shkelje dhe një e padrejtë ndaj këtyre fëmijëve që ju garantohet edhe me ligj dhe me të drejta ndërkombëtare. Unë e mbështes dhe do ta përcjellë shqetësimin juaj përmes emailit tim zyrtar në Ministrinë e Arsimit. Sevil Kazaz, pagesat për sigurimin e kemi diskutuar për katër vite radhazi, sigurimet dhe nuk ka një udhëzim administrativ ose një ligj i cili përcakton që komuna me mjetet e veta, me mjetet e komunës duhet t'i mbulojë. Përkundrazi, gatishmëria, vullneti është i komunës, mirëpo mjetet buxhetore nuk ka për ta mbështetur. Prandaj bazuar në të drejtat e këshillit drejtues të shkollave, të cilët e vendosin në bazë të rrezikshmërisë, ku edhe prindërit janë brenda këtyre këshillave e vendosin se a duhet të kenë sigurime apo s'duhet të kenë. Kemi shkolla që vendosin në bazë nivelit rrezikshmërisë, këshilli drejtues se duhet të ketë dhe participojnë me mjete aq sa i vendosin këshillet drejtuese dhe vazhdojnë tutje. Kjo mbetet në domenin e këshillit drejtues brenda institucioneve arsimore. Selman Sokoli, dëgjo Selman, katër vjet ke shpif ke abuzu me këtë kuvend, të ka ardhur fundi më. Për mua të ka ardhur fundi. Për çdo fjalë që ti ke me shpif, unë ty kam me ndjekur penalisht dhe secilin. Ti që tash ke me u çu edhe me tregu në cilën shkollë janë që ata nxënës që i qite fotografitë. Hajde fol. Cilën shkollë janë nxënësit të cilët që po shpif në shkollat e komunës së Prizrenit nuk kanë nxemje? Cilat shkolla s'ka pasur nxemje? U kryt tash. Dhe ke me fol publikisht cila shkollë, cila klasë, në cilën kohë dhe me çfarë të drejte ti ke me abuzu fotografitë e fëmijëve brenda institucioneve. U kry. Ta shohim tash. Unë këtu prej kësaj foltore i ftoj organet e drejtësisë të merren me këtë çështje shumë serioze. Sepse nëse na lejojmë me abuzu me fëmijët në institucionet shkollore, me ja fut kapuçat në kokë, ku e di, në cilën shkollë ose në cilën klasë ose në cilën në cilin format e keni bërë këtë punë, atëherë duheni me dhënë përgjegjësi. Sepse po shpifni! Sa i përket normave mësimore, mësimdhënësve. E kam thënë me disa herë që në komunën e Prizrenit, janë specifikat e veçanta dhe janë udhëzimet e veçanta, të cilat Ministria e Arsimit nuk i ka pasur fare parasysh. Sepse janë udhëzimet e veçanta për komunitete, që nuk përcaktohet numri i nxënësve, po që normat përcaktohen në bazë numrit total të nxënësve në komunë. Dhe kjo është një specifikë që ne kemi nxënës nga komuniteti turk, komuniteti boshnjak, nga zonat e thella rurale, që është numër shumë i vogël dhe kur merret totali i normave dhe t'i marrim normat e njëjta si një klasë që i ka 30 nxënës, atëherë sigurisht që në çdo vit është zvogëluar numri i normave në total. Do të thotë Ministria s'ka pasur parasysh këtë konsideratë ndaj komuniteteve tona në qytetin që ne jetojmë. Sa i përket pyetjeve të Dafinës, Dafinë mund të vazhdoni me gjithë konsideratën që kam për ju, mund të vazhdoni të mirrni me interferimet e operatorëve ekonomik, për interesat e tyre personale, ja kam thënë dhe ja u them prapë, që udhëzimet administrative dhe aktet rregullative i përcaktojnë qartë se kush e merr përgjegjësinë, ku e merr përgjegjësinë dhe se si vepron. Asnjë interferim, e them me përgjegjësinë e plotë këtu para jush, para kuvendit, para qytetarëve. Nëse e gjejnë veç një person të brendshëm ose të jashtëm, që unë kam interferuar për një apo për tjetrin operator, unë do të jap përgjegjësi në çfarëdo forme, juridike, penale dhe morale. Atëherë, nuk është mirë të bëjmë politika të ulta këtu në këtë kuvend. Po të mendojmë barabartë, bashkë dhe të vazhdojmë. Dikujt mund t'i qeshet sepse nuk e njeh edhe natyrën e kuvendit. Dhe i din rrethanat me të cilat ka kaluar dhe kalon. Po nuk është për t'u qeshur këtu dhe duhet të merren seriozisht çështjet të cilat diskutohen. Dhe vajzat e

dajes për të cilat ju po flisni, katër dajë i kam. I kam nja gjashtë vajza të dajëve. Vajzat e dajëve të mi jetojnë në Arau, të Zvicrës. Kështu që ato s'kanë mundur me ardhur me hy në punë në Prizren. Kaq!

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit drejtoreshë. Po mbasi tu ka përmend emri, fjala për ju Selman. Mundësisht më shkurt vetëm.

Selman Sokolaj (LVV): Po dal këtu prej foltores, të nderuar kolegë kuvendar, siç duket domethënë kjo qeveri përveç që nuk ka vizion për të punuar, nuk ka edhe vesh për të dëgjuar. Jeni dëshmitarë, ju që keni qenë këtu, mediat, shoqëritë civile, të gjithë të pranishëm që katër vite, çdo çështje që e kam ngritur për drejtorinë, sidomos për drejtorinë e arsimit, kam marrë kësi kërcënime, fyerje. Tash drejtoresha e arsimit, kur i drejtohet një asamblisti në këtë formë, në këtë mënyrë kërcënuese, paramendon çka mund t'i bëjë një fëmijë, një prindi, ose një arsimtari, i cili ma ka sjell mua këtë dëshmi, që në shkollat e komunës e Prizrenit nxemja funksionon në këtë mënyrë. Domethënë, foto është autentike, është e bërë në janar të këtij viti. Edhe drejtoresha në vend se me marrë masa bashkë me kryetarin, bashkë me ekzekutivin, që me rregullu kalldajet, me marrë masa që fëmijët tanë, nxënësit tanë të kenë kushte të mira për zhvillim të procesit mësimor, drejtoresha fyen, kërcënon, linçon. Tash nëse unë e tregoj prindin, po them edhe njëherë, fëmijën ose arsimtarin ose profesorin, kushdo qoftë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Selman, mundësisht më shkurt.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, nëse unë e tregoj...

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjalët e njëjta po i përsërit dy-tre herë. Mundësisht se janë edhe e thamë në fillim kemi shumë pika.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, po më duket ju nuk keni çështje tjetër veçse me udhëheq seancën e Kuvendit Komunal. Sakt. Kështu që edhe njëherë po i bëj thirrje edhe kryetarit që t'ia tërheq vërejtjen drejtoreshës, për shkak të mënyrës qysh na është drejtuar neve kuvendarëve. Drejtoresha e Arsimit, edhe një çështje. Drejtoresha e Arsimit katër vite është mbuluar, është munduar me i mbuluar ngaçmimet...

Simir Krasniqi (Kryesues): Jemi në kuvend. Këtu duhet gjuha parlamentare. Ju lutem Selman, përfundoj gjithëçka? Vazhdojmë fjala për ju zoti Qemal.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, a bën me përfundu?

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Qemal Krasniqi. E përfundove, Selman, mos e tepro gjithëçka brenda kompetencave dhe rregullores që ta lejon kuvendi. E përfundove, gjithëçka brenda kompetencave të rregullores së kuvendit jemi. Vazhdojmë, Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Unë desha me u ndërlidhë me këtë rast. Kolegu Selman duhet me na treguar saktë ku është, cila shkollë është. Me na tregu cila shkollë është. Nuk ka nevojë me dalë në foltore dhe me fol. Derisa, veç pak, derisa nuk e tregon shkollën. Mund të ndodhë që në shkollën për nga vij unë, ka qenë një problem me nxemje. Mirëpo problemi nuk ka qenë te drejtoresha. Operatori ekonomik e ka marrë tenderin. Pse s'ka bërë punë të ndershme, nuk ka faj drejtorja, nuk po dua me i dalë në mbrojtje. Katër-pesë herë unë direkt kam biseduar me atë

zotninë. Vjen aty, nuk e bën punën, mirëpo në këtë gjendje nuk ka qenë. Ku është, cila shkollë është mirë me na kallëzu? Kaq kisha.

Selman Sokolaj (LVV): A bën me i tregu shkollën zotnisë?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, mundesh me ja tregu cila shkollë është.

Selman Sokolaj (LVV): Po më vjen keq për nivelin e përfaqësuesve të popullit apo nivelin e ekzekutivit këtu. Edhe me ligjet pozitive mbrohet burimi edhe nuk është e thënë domosdoshmërisht që të tregohet burimi. Paramendo çfarë i bën ju sinjalizuesit, sinjalizuesit brenda institucioneve që kanë për detyrë të lajmërojnë sinjalet e korrupsionit eventual. Çfarë i bëni ju atyre? Paramendon. Çfarë botëkuptimi keni për këtë sjellje? Ndërsa kryesues?

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë nuk kemi pse ta zgjasim. Po shpikë ti me këto fotografi mbasi nuk po e tregon emrin e shkollës se ku është. Vazhdoj me, ju ka përmendur emrin juve Dafinë, vazhdojmë me ju. Po, cila shkollë? Shumë mirë kuvendari e pat, trego se cili vend është dhe në cilën shkollë është?

Selman Sokolaj (LVV): Edhe.. përkrahu e qet përjashta atë personin. Ti personalisht. Idiot.

Simir Krasniqi (Kryesues): Urdhëro. Urdhëro, fole diçka?.

Selman Sokolaj (LVV): Ju personalisht shkojeni nxjerrni për krahi. Me këtë sjellje, me këtë qasje jo institucionale prej rrugaçësh, ju shkoni e nxirrni prej krahi atë person, atë fëmijë, atë prind ose atë arsimtar, cilido qoftë ai. A jeni duke e vërejtur veten në çfarë gjendje jeni?

Simir Krasniqi (Kryesues): Të lutna gjuhën. Selman, të lutna gjuhën parlamentare.

Selman Sokolaj (LVV): Doni me linçu një fëmijë, një nxënës, një prind, një arsimtar që e ka siguruar një fakt, që në shkollat e Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjalën e ka Adrit Krasniqi.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesues. Nuk dashta me u kyç te kjo tema, po kolegu kuvendar na shtiu të gjithëve me u kyç. Këtu po e përmend linçimin. Nëse është një person që i linçoi fëmijët, është ky kolegu këtu. Nëse është burrë, le të del, le të tregon për shkollën, le të tregon për rastin. Për momentin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po Dafina mbasi ta përmendi emrin.

Dafina Alishani (LVV): Emri po më përmendet, në diskutim jam.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdo, vazhdo.

Dafina Alishani (LVV): Emri po më përmendet, rrjedha e diskutimit po shkon sipas pyetjeve që i kemi edhe ju po jepni fjalë PDK-së. As ke, as se përmendi kërkush, a u kryen pyetjet përgjigjet? Është hera e parë edhe e fundit që ty të dikton ekzekutivi çka me bë. Ose bëhu kryesues i kuvendit, ose bëhu ekzekutiv. Po s'të bëjnë, se s'të kanë bë. Po ti duhesh me respektu kuvendin. Asnjë drejtor e drejtoreshë nuk guxon ty me dorë me ta bë, ndalja këtij, ndalja atij. Ti je kryesues i këtij kuvendit.

Kujna do që nuk i pëlqen pyetja, kritika, le ta liron sallën siç është po liron zotëriu. Mjaft më, mjaft.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina kështu. Pikë së pari ta përcjell.

Dafina Alishani (LVV): Jo, jo, derisa ta kryj.. nuk guxonim me e keqpërdor kështu pozitën e juaj kryesues. Kryesuesi i gjithë asambleistave je, nuk je kryesuesi i ekzekutivit. E thamë fillimi, toleruam, të kemi pasur kolegë, po jo bre me keqpërdor kaq tejmasë. Kush është drejtoresha me t'u kthy dhe me thënë ndalja fjalën? Kush është ai tjetri që në seancën e fundit tha ndalja fjalën? A keni ju pak konsideratë për kolegë? Nuk është normale drejtoritë me ju përcaktu juve kush flet, kush nuk flet, sa flet e sa jo. Kur të lavdohet qeverisja, nuk ja ndalni, edhe minutazhin e tejkaloni. Kur kritikohet qeverisja, po ju bjen mend që është Ramazan e po e zgjasim. Çka është kjo? Kjo është, kjo është jo normale. Drejtoreshë, sa herë ke thënë po shpif, të gjithë të ka dalë rrena në këtë kuvend. Ama gjithë! Sa herë na ke akuzuar që ne po shpifim, gjithmonë ka dalë e vërteta që është qashtu qysh ne i themi si asambleistë. Gjithmonë! Ju po folni për abuzim të fëmijëve. Ti ke tentuar me e mbulu rastin e ngacmimit në shkollë Lubizhdë, a e mban mend? Njeriu, njeriu që të ka sinjalizuar është larguar prej punës, e nderuar. Me ligj të sinjalizuesve ai duhet me u mbrojt. Ju i keni larguar. Drejtoresha e cila e ka mbuluar rastin është në shkollë ende, ju e keni lejuar. Nuk ka qenë kjo, leje organet e drejtësisë, ti ke përgjegjësi për secilin fëmijë në komunën e Prizrenit. Ti ke përgjegjësi dyfish se je gru. Nëse ka ngacmim seksual, ti duhesh dyfish me u marrë me këto raste, jo me i mbulu. Sa herë ke dalë në këtë foltore, e ke mohuar që ekskursionet nuk po ndahen ashtu qysh unë kam thënë, kanë dalë me emra, me mbiemra, me operator. Ju kot e keni që thuni, shkolla vendos, rregulloret e shkollës vendosin, po ata drejtorja i ke vendos ti aty. Ti ke thënë nuk ka trika në konkurse. Ne e kemi pas këtu inçizime që është përmendur emri jot. Ti ke anëtarë të komisionit triaxhi që e fut në secilin komision. Sa herë ke thënë shpifje, ke dal ti vetë ke gënjej këtu. Trikat t'i dimë drejtoreshë. Ato trikat që i keni bërë nëpër zgjedhje të drejtorëve, tash ju shërbejnë familjarëve të juaj. Këtë e dimë! Nuk ka kuptim neve tash me na quajt neve shpifsa, sa i përket për abuzim të fëmijëve. Abuzim do të ishte nëse Selman Sokoli do t'i vendoste fotot pa cenzurë. Një drejtori, epilogu është kështu, një drejtori që hakmerret për një sinjalizues, për ngacmim seksual, a e di ç'ka mundet me i bë fëmijëve, të cilët e kanë lajmëruar këtë hall edhe këtë çështje? Subjektin politik e ke tëndin, merru me subjektin tënd politik. Subjekti politik i jonë e di qysh e bën opozitën dhe nuk keni nevojë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafinë, unë pikë së pari e respektoj kuvendin edhe e respektoj rregulloren e punës së kuvendit. Ju si kuvendar duhet ta përdorni gjuhën parlamentare, mos dilni, kur të flas unë mundesh me dëgju ti. Kur të flas unë mundesh me dëgju se tash unë jam këtu. Unë e respektoj rregulloren e kuvendit, edhe ju ta respektoni rregulloren e kuvendit. Në fillim ju thashë, respektoni minutazhin, ajo kohë që ju takon, jo me përdorë fjalor, jo që i takon një kuvendari, se këtu duhet ta dimë të gjithë, që jemi para syve të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit. As shpifje, duhet ta tregoni të vërtetën dhe vetëm të vërtetën Selman. Fjala është për ju Karanfil.

Karanfil Haxhillari (LVV): Më në fund. Të akuzohet, të sulmohet një kuvendar që e ngre një çështje në interes të nxënësve dhe thotë po shpifni dhe keni me u ballafaqu me drejtësi. A të kujtohet që ma ke bërë një padi drejtoreshë edhe ku ka përfunduar padija, t'u ka kthy të turinjve! Dhe më fol një drejtoreshë e arsimit sot e cila drejtoreshë 2110 vota të vjedhura i ka. Në zgjedhjet

e fundit parlamentare, ti i ke vjedhur drejtoreshë, sot ma përfaqëson arsimin. Del më bën moral, kush? Një manipuluese e votës të qytetarit të Prizrenit. Kampione e katërta në Kosovë në renditje për manipulim të votave dhe del në foltore, mban moral, me shpifje, me gjëra të kota, jo! Për me kallëzu.. i pafytyri s'mundet me i kallëzu dikujt me pas fytyrë. Duhet paraprakisht vetë me pas fytyrë. E ke degraduar sistemin arsimor në Prizren. Ke përjashtuar nga puna drejtorë pa pikë, vetëm për hakmarrje. Ke përjashtuar mësimdhënës vetëm se kanë sinjalizuar ngacmime seksuale. Dhe sot me këtë formë, mos drejtoreshë, mos! Ai kryetari të ka bërë drejtoreshë. Se me u pas qenë ndonjë kryetar që ka parime e principe, ty kurrë e 1000 vjet drejtoreshë s'të kishte bërë.

Simir Krasniqi (Kryesues): A e përfundove, Karanfil? Fjalën e ka drejtoresha.

Luljeta Veseli Gutaj: Faleminderit shumë. Zoti Karanfil, për krejtë këto komente, sigurisht edhe për këtë pjesë do të jepni përgjegjësi. Po nëse e ke dëshmi ti më quajti mu hajneshë të vota. Por nëse e gjen, tash prap po ta them, edhe po të them edhe ty, nëse dikush është përgjegjës në këtë proces, është lëvizja Vetëvendosje dhe është KQZ-ja. Tash, nëse ti e gjen, po, ti po thu, ti je hajnesh. Po unë jam qenë brenda në kompjuter, kam shkruajt vota, apo? I kam kontrolluar votat. Dafina, je hajnesh ti që të kanë dalë nja 700-800 vota? Po nëse edhe një votë ka dalë më shumë ama pak ti ke të bëjsh me q'atë proces. Albin Kurti, a koka hajn që i kanë dalë, është i pari prej liderëve që ka më së shumti vota mangu? Mirë, mirë. Hajde tash dëshmoje ti qysh i pasna manipuluar qato vota. Thuajmë. Hajde. Thuaje. Na e presni vendimin e gjykatës dhe do të flasim. Për pjesën tjetër, ti zoti Karanfil, të kam bërë kallëzim penal edhe ka me vazhdu me të bë. Po, ty ka me të bë. E ke bërë në emër të lëvizjes, tu ka hedhur poshtë, apo? Të ka ra poshtë. Po ti e ke çuar në prokurori speciale kallëzimin penal për mua. Çfarë ka ndodhur? Të ka kapur siklet ë? Se s'ka pasur asnjë fakt, asnjë bazë. Për pjesën e shpifjes po të kallëzoj, s'ka me ja falë kërkujt asnjë sekond. Me secilin ka me u ballafaqu. Unë besoj në organet e drejtësisë. Dhe besoj që verdiktet finale kanë me dalë ndryshe. Po në momentin kur ka me dalë prokuroria edhe gjykata me vendim, çka duhesh me thënë ti Karanfil për këtë drejtim dhe adresim që ma bërë mua? A i ke marrë 2000 a 100 a 500 vota? Çfarë ke me bë? Çfarë duhesh me bë? Çfarë duhesh me bë? Jo po ka me dalë aty se fakti, a mund me luajt dikush me emrin tim? A mund me luaj? Prej fundit të pusit ku u kanë arsimi në Prizren, sot është i pari në Kosovë, me 86 pikë. 40 drejtorë i keni pasur ushtrues detyrë, ti thuaj çfarë të duash për drejtorë. Për 10 muaj 67 drejtorë dhe zëvendës drejtorë janë zgjedhur në proces të rregullt. Ne nuk kemi bërë emërimë, por ne kemi bërë zgjedhje. Kështu që grani i punës, puno për të mirën e qytetit, mos u merr me shpifje, se me shpifje shihemi atje ku je kanë. Njëherë ta ka fal, ta kam bërë një kallëzim penal për të cilin e kanë nxjerrë vendimin që është i revikueshëm në aspektin politik. Po, e ty aty u ka kthy? Prokurori speciale e ke qu. Prokurori speciale si subjekt politik më ke bërë. Po. Kallëzimi penal se je thirrur në emër që unë nuk jam personalisht, jam në emër të subjektit. Hajde.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtoreshë u kry.

Selman Sokolaj (LVV): Mirë, shkurt vetëm. Drejtoreshës së nderuar të arsimit e cila nuk ka nevojë të dalë prej taktit se është drejtoreshë e arsimit, po ia shtoj edhe një lëndë. Në komunën e Prizrenit, arsimtari që ka dalë në pension në tetor, ka notuar nxënësit në dhjetor. Ju lutem ma bëni edhe një padi. Arsimtari që ka dalë në pension edhe njëherë koleg të nderuar, hapni veshët, mos na i këqyrni fytyrët kush jemi se më vonë tani i ndryshoni qëndrimet. Edhe ju këtëj edhe ju andej.

Edhe njëherë po them, arsimtari që ka dalë në pension në tetor, ka notuar nxënësia në dhjetor. Edhe prandaj ata që s'kanë haber...

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Veç të ndërlidhim edhe t'i japim punë këtij debatit mundësisht që ka mundësi.

Dafina Alishani (LVV): Veç pak kryesues, veç pak. A po e respektoni rregulloren? A është përmendur Alban Bislimi dika? Pse po i jep replikë? Jo jo. Kujna ja përmend emrin, kujna i replikon në rregull. Kryesues, të lutem respektoje rregulloren ose për me marrë fjalën duhet me dalë në anën tjetër e me marrë fjalën. A u përmend Alban Bislimaj dika? Çka po replikon tash? Unë e mora vet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdo Dafinë. Alban fjala për ju është.

Alban Bislimaj (PDK): Atëherë veç duhet të ndërlidhemi me debatin që është krijuar, se këta veç me këto sende merren se nuk kanë ndonjë vizion se si duhet të punohet me komunën, por ideja është që u më erdhi turp kur ja pashë fotot që kuvendari i Vetëvendosjes i shpalosi domethënë në foltore, është e ulët, sinqerisht po them, niveli i ulët, një kuvendar me u marrë me këto gjëra të kota, duke e ditur se se si ka qenë koha e dimrit, domethënë ka pasur ftohtë, ka pasur mungesë të rrymës, e me marrë një nxehtësi të vogël edhe me qit kapuçat nxënësve dhe ky me mundu me manipuluar me ato foto, nuk është e mirë. Edhe imagjinoni nivelin e debatit qysh e zgjasin pa nevojë edhe qytetarët me u tallë me ne me këtë nivel të debatit. Kështu që është e kotë që merren sepse nuk ka të bëjë absolut me problemin e nxemjes në shkolla, por është manipulim i lëvizjes Vetëvendosje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Alban. Për ju fjala Dafin. Vazhdo.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, ju vetë u deklaruat që jeni për me respektu rregulloren. Unë e mora fjalën si shefe e grupit nën një edhe nën dy, secili asambleistë ka të drejtë me reagu nëse nuk respektohet rregullorja. Tash, a po filloni me standarde dyfishta si kryesues apo çka është problemi? Apo sa herë prap po them, sa herë që Albani do me e bë rolin e dikujt tjetër, këtu ja jepni fjalën. Ju jeni bre për me u përgjigjur këtu? Unë s'e di edhe pse kolegët e marrin këtë përgjegjësi. Unë e di që dojnë me dëshmu veten e që mundohen me dëshmu karshi kryetarit që janë më lojale, por nuk është puna e tyre. Edhe nuk është puna juaj me bë kësi standarde dyfishta. Kryesues, jemi në muajin e dytë si asamble, je duke e degraduar. Besom që nuk ka me pas as respektim tash e mbas, as të rregullores, as minutazhes, as kurrigjo. Unë nuk po e kuptoj pse e keni kaq me siklet këtë farë pune. Na jemi këtu opozitë, bre? Na duhet me ju treguar çka është keq. Pse po ju djeg qaq me ju tregu ku keni gabu? Ju zonjë mundeni me u mburr sa të doni me arsim. Po problemet janë evidente: Ju prapë po them, sa herë që neve na keni akuzuar që ne po shpifim, të gjitha kanë dalë të vërteta. Ju jeni ajo që keni larguar dhe edukatore për me rehatu rejën e kryetarit. Ma bre se këtu jetojmë ne. Jetojmë në Prizren edhe i dimë të gjitha punët që ju i bëni. Jo bre drejtoreshë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, gjithçka po del jashtë temës. Tash fillojmë me të gjithë këto gjëra. Ju lutem është kryer diskutimi, fillojmë me drejtorat, drejtorit Florent Ukaj e ka fjalën.

Florent Ukaj: E nderuar kuvendare, stadiumi i qytetit për momentin nuk ka leje. Kemi kërkuar disa plotësim të dokumenteve dhe jemi tani na kanë kthyer, na kanë plotësuar dokumentet dhe jemi në fazën e shqyrtimit dhe besoj se edhe kryetari edhe ne si drejtori kemi pasur dy takime me Ministrinë e Kulturës edhe jemi besoj se shumë shpejt nëse nuk ka ndonjë problem tjetër e lejojmë edhe punimet në stadium. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju është drejtori i shërbimeve publike, zotëri Islam Ukaj.

Islam Ukaj: Faleminderi kryesues. Unë do të mundohem pyetjet që janë parashtruar nga asambleistë, të përgjigjem ato ku i kam informatat. Ato informata ku nuk i kam do t'i kthej me email. Pyetjes së parë të drejtuar nga asamblisti Haziz Hodaj në lidhje me rrugën e Gjonaj, rruga kryesore për të asfaltuar. Unë do ta shoh si është mundësia dhe do të jap një përgjigje, do të konsultohen edhe me zyrtarët e mi aty në drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe do ta jap përgjigjen se çfarë mundësie kemi që të vazhdojmë të asfaltojmë atë rrugë. E di që disa herë dhe kur kam qenë këtu edhe si drejtor i Inspektoratit, e di që disa herë është bërë ajo kërkesë për rrugën Gjonaj, edhe pse shumë rrugë janë bërë në Gjonaj. Ka pasur edhe projekt të veçantë, e dini edhe ju, janë bërë shumë investime, por për këtë rrugë, e di që e keni ngre këtë shqetësim disa herë dhe besojmë që shumë shpejt do ta ta merrni përgjigje dhe çdo mundësi që do ta kemi do ta shtyjmë përpara. Konkrete kur ti shohësh asfaltin duke u shtruar është konkrete. Kjo është më konkrete. Petrit Hoxhaj i pyetjes përshtruar për në Vlajshne në lidhje me një shenjë në fshat brenda, për ndryshimin e shenjës me sa e kuptuam, unë do ta urdhëroj zyrtarin tim të komunikacionit që del në vend të ngjarjes, do t'ju kontaktoj juve në telefon dhe besoj që nga vendi ngjarjes e sheh çfarë mundësi kemi të ndryshojmë atë shenjë. Karanfilin s'qenka këtu, përgjigjen mund me ia dhënë në lidhje me lagjen 2 korriku, veç fillimet e punimet kanë filluar aty të punohen. Është e vërtetë që para vitit të ri janë bërë disa hapje të rrugëve dhe po për shkak të rreshjeve atmosferike dhe tash me përmirësimin e kohës, veç do të vazhdohet punimet aty, dhe çdo rrugë që është hapur do të përfundoj. Ka bërë dhe një pyetje në lidhje me ndriçimin publik në lagjet e qytetit, të unazës qytetit. Besoj që i keni parë kanë filluar veç duke punuar aty dhe besoj që shumë shpejt në ato pjesë ku mungon ndriçimi, ka qenë mungesë e ndriçimit, por shumë shpejt ato mungesa ku kanë qenë do të evitohen ato problematika dhe do të kenë ndriçim të gjitha lagjet e qytetit. Ndërsa për një kod që ka qenë te Stanes e Struzhës që është hequr prej buxhetit, nuk jam i informuar, do të informohem dhe do t'ia kthej përgjigjen kur do ta marr përgjigjen nga zyrtarët e mi në Drejtori e Shërbimeve Publike. Selman Sokoli lidhej me Prockën në Romaj. Vitin e kaluar ka filluar dhe... po dëgjo tash o burrë, dëgjo, leje tash se jam tu fol. S'ta kthej përgjigjen pra, u kry. Sevilaj Hapçi, ka bërë një kërkesë, unë në gjuhën shqipe po ta jap përgjigjen, besoj që e kupton. Lidhej me kontenerat që mungojnë përballë shkollave të mesme. Unë këtë problematikë do ta adresoj tek Ekoregjoni dhe besoj që shumë shpejt, ne veç e kemi iniciuar një procedurë për blerjen e këtyre kontenerave të rinj, po ajo na merr pak kohë, po unë këtë problematikë do ta adresoj tek Ekoregjoni dhe të gjitha mundësitë që janë, do t'i vënojmë aty edhe këto farë kontenerave përballë shkollave të mesme. Ndërsa sa i përket mungesës së ujit edhe disa problematika të qeshmeve që janë afër varrezave, edhe këtë problematikë do ta bisedojmë edhe me Hidroregjonin që çfarë mundësie kemi që ta evitojmë këtë problematikë që të ketë ujë në ato pjesë të varrezave. Shukri Quni lidhje me rrethin të Hibi, La Shuk do të konsultohet me zyrtarët e mi në drejtori lidhje me rrethin të Hibi. Unë e di

atë problematikë dhe jam ngjarje se edhe disa herë kalojmë ne andej. E dimë që gjatë stinës së verës ku të vijnë kurbetgjitë ka shumë komunikacion dhe do ta shohim çfarë mundësie të kemi që ta bëjmë një rreth se me të vërtetë ka mundësi që edhe e lehtëson komunikacionin për atë pjesën edhe shumë ndërtime të larta kanë filluar të ndërtohen dhe normal që është mbi ngarkuar trafikuaty. Dhe çfarëdo mundësie që do të kemi, do ta evitojmë ose do ta krijojmë një mundësi të krijojmë, ta bëjmë edhe një rreth aty afër Hibit. Ndërsa sa i përket për punimet në fshatin Nashec, nuk jam i informuar, të them të drejtën, do të informohen, do ta jap përgjigjen, ta shoh çfarë mundësie edhe për çfarë arsye janë ndërpre, se ti më the që janë ndërpre punimet në Nashec, ta shoh mundësinë qysh jam, qysh qëndron problematika në atë pjesë dhe çdo mundësi që kemi, si nga ana buxhetore, do të vazhdojmë, do t'i përfundojmë ato punime në qoftë se janë mbetur në gjysmë. Pyetjes tjetër, Eldis Abazi, rrëshitja e dheut në pjesët e Zhupës dhe në Lubinje. Eldis, për këtë çështje është mirë të adresohet tek Drejtoria Emergjente, edhe pse e kemi diskutuar edhe disa herë për këtë çështje dhe kemi intervenuar dhe ne si Drejtoria e Shërbimeve Publike. Mundësitë buxhetore janë të vogla për atë pjesë. Disa herë e kemi hapur atë pjesë, atë rrugë në Lubinje të rrëshitjes së dheut. Por si duket, sa herë po hapen, më duket qaq më shumë po rrëshqet dheu. Ne jemi në koordinim me drejtorinë emergjente, jemi duke bërë një raport edhe t'i dërgojmë edhe AME-së në Prishtinë që të shohim çfarë mundësi kemi që të intervenohet se duhet të kyçet edhe AME-ja, në këtë rast që është në kadër të Ministrisë të Punëve të Brendshme, që të shohim çfarë mundësi kemi të intervenimi, pasi që është një kosto shumë e madhe të asaj pjesë, ndërsa pjesët e vogla ku ka qenë rrëshqitja e dheut, ne kemi intervenuar si drejtoria emergjente, po ashtu edhe drejtoria e shërbimeve publike i ka dalë në ndihmë atyre pjesëve. Kemi biseduar disa herë dhe në telefon dhe çdo herë ku kanë mundësia ne kemi intervenuar. Zonja Nerimani, keni bërë një pyetje në lidhje me lagjen Dardania për infrastrukturës, për shkak kohës që ka qenë reshje të mëdha atmosferike, janë ndërprerë punimet, por tash veç kemi filluar dhe besoj që shumë shpejt do të përfundojnë edhe ajo pjesë ku kanë mbetur infrastrukturës së trotuarve. Ndërsa sa i përket ndriçimit publik dhe që më përmendet një aksident që ka qenë te ITP-ja, besoj që e keni parë që janë duke punuar në mesin e katër korsive. Jemi duke sanuar një kabull që ka qenë një kabëll e rrymës ka qenë e dëmtuar dhe a për atë arsye edhe në pjesën e rrugës për Gjakovë dhe në pjesën në drejtimin e rrugës të Suharekës katër korsitë, problemi ka qenë tek kabllat dhe tash besojmë që shumë shpejt ai ndriçim aty do të evitohet dhe kablla e re është duke montuar dhe në momentin që të montohet kablla, ndriçimi do të jetë në funksion në atë pjesën me katër korsitë dhe në lagjen Dardani. Pyetja mu ka bërë nga Albani në lidhje me tranzitin i ri për sinjalizimin. Njëjtë Alban, duhet të dalim me zyrtarët e di që shpesh edhe unë kaloj aty dhe disa herë kam marrë dhe gjoba, kam marrë gjoba aty, është e vërtetë që është kufizimi i shpejtësisë 50 km, por ta shohim çfarë mundësi kemi se dhe e keni parë ju dhe jeni dëshmitarë se shumë ndërtime janë kanë filluar të punohet edhe shumë objekte aty janë edhe biznese janë hapur. Ta shohim çfarë mundësi kemi dhe si lejon edhe ligji për rritjen e shpejtësisë me sa e kuptova. Çfarë mundësi kemi, do të dalim në vend të ngjarjes dhe do të thirrjmë edhe ty se edhe ti je ekspert i komunikacionit dhe me ty bashkarisht me gjithë zyrtarët e mi. Ndërsa sa i përket rrugës Hoçë, Moni Bau, ajo pjesa e kohës për mbjelljen e gjelbërimit dhe drunjëve, aty do të fillojmë si të përmirësohet koha veçse do të fillojmë aty t'i përfundojmë ato pjesë. Ilir Gashi, pyetja më është bërë në lidhje me disklokimin te Ekoregjioni. Unë e di që ajo procedurë ka nisur pak më herët, kur ka qenë ish-drejtori. Po edhe procedurat është bërë edhe një fizibilitet me sa e di të asaj pjese. Edhe procedurat e dokumentacionit janë kompletuar nga ana jonë dhe janë drejtuar në

ministri, sipas informacioneve që i kam jo zyrtare, po do të interesohem edhe një herë ta shoh, do ta jap një përgjigje, qoftë me email apo edhe në asamble. Është interesin edhe tonë që ajo pjesa të largohet nga aty se është e vërtetë që ndotë edhe ajrin dhe ka shumë ndërtesa që janë bërë për rreth aty. Do të mundohemi sa më shpejt që është e mundur që atë pjesë ta largojmë Ekoregjonin ta largojmë dhe veç është ndarë dhe vendi ku ka me shku. Ndërsa sa i përket që punimet të lagjes Nënkala, po është duke vazhduar projekti, do të vazhdojmë në atë pjesë, por tash për momentin jemi duke punuar tek Kej në pjesën e lartë, te ura e Kforit. Momenti që të përfundon ajo pjesë, do të vazhdohet edhe në rrugën Nënkala, mbi shkollën e muzikës. Do të vazhdohen edhe punimet, jemi të pajisur me leje dhe do të vazhdohen të përfundohen ato pjesë të rrugës Nënkala. Për varrezat në Landovic jemi në fazën përfundimtare të procedurave. Dhe besojmë që shumë shpejt do të fillohet aty të bëhen, të fillohet edhe varrimi, të hapen varrezat e reja, se e dimë shumë qartë se me varrezat ku jemi tash, ma ka bërë dikush një pyetje, po Selmani, po nuk ja dhashë përgjigjen në lidhje me varrezat. Po nuk ta dhash pyetjen se s'po le me u përgjigj. Për atë arsye s'ta dhash përgjigjen. Më fal. Po s'është arrogancë, ne të duruam këtu me disa orë këtu. Varrezat janë në fazën përfundimtare dhe besojmë që shumë shpejt do të fillojmë të varrimin në atë pjesë. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjala për ju, drejtoresha e inspektoriatit.

Semra Ilijazi (Drejtoresha e inspektoriatit): Do ti përcjellim përgjigjet përmes e-mailit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë. Fjalën e ka drejtori i turizmit zoti Adem Morina.

Adem Morina: Faleminderit kryesues, të nderuar kuvendar, kolegë, të nderuar qytetarë të Prizrenit. Më janë shtruar dy pyetje nga ana e dy kuvendarëve, ngazoti Shukri Quni në lidhje me parkun e Nashecit. Është një projekt i cili për arsye të motit apo kohës është ndërprerë punimet, kurse ai projekt do të vazhdoj, nuk do të ndërpritet. Në momentin që do të përmirësohet koha do dalim dhe operatori ekonomik do t'i kryej të gjitha punët që i ka në kontratë. Kurse sa i përket pyetjes së dytë të ushtruar nga kuvendarja Dafina Alishani, në lidhje me zonën ekonomike, është muaji i dytë që e kemi marrë këtë detyrë dhe normalisht jemi njoftuar me ku kanë mbetur procedurat në lidhje me funksionalizimin e parkut të biznesit apo zonës ekonomike. Të them të drejtën jemi duke pritur disa pëlqime nga linjat e ministrive të ndryshme dhe gjithsesi kemi mbajtur disa takime dhe jemi duke punuar fuqishëm që të kemi takime edhe në nivel nacional edhe në nivel lokal, që është një punë e cila duhet bëhet nga dy edhe niveli lokal edhe niveli qendror dhe po besoj fuqishëm që është njëra ndër prioritetet e kësaj drejtorie, që në një periudhë sa më të mundshme të shkurtër të funksionalizohet një zonë e cila është më si e rëndësishme për të gjitha bizneset në qytetin e Prizrenit. Janë pëlqime të cilat duhet të japin Ministrinë e Linjës, siç është Ministria e Kulturës, Ministria e Administratës, Ministria e Industrisë, domethënë janë linja të cilat nevojiten pëlqime për funksionalizimin e kësaj zone. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjalën e ka drejtori i Bujqësisë, Nderim Kadriaj.

Nderim Kadriaj: Faleminderit shumë kryesues. Përsëritje për të gjithë kuvendarët, qytetarët që po na ndjekin dhe mediat. Lidhur me pyetjen dhe interesimin për strehimoren e qenëve, unë me

ta marr detyrën, domethënë kam shku e kam vizituar për herë të parë, për me e pa nga afër se ku janë punimet. Tash jemi në fazën e tenderimit të pjesës tjetër të rrethojave dhe nevojave të tjera në oborrin e strehimores. Dhe unë po besoj që këtë vit ka me u mbyll çështja.. ka me përfundu puna e strehimore. Mandej, janë edhe gjëra teknike, pranimit teknik, edhe bartja e pronës në emër të kuvendit komunal. Lidhur me pyetjen e baci Qemal, baci Qemal ka me ju drejtu me email edhe do t'ia dërgoj të gjitha lëndët që lidhen me anën e tij. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjala për drejtorin e punës dhe mirëqenies sociale, zoti Fatmir Memaj.

Fatmir Memaj: Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Lidhje me pyetjen nga të parashuar nga kuvendari Agim Muçaj, se a do të jepen për dimrin e ardhshëm dru për familjet e dëshmorëve, familje të tjera dhe raste të tjera që janë në skemë sociale e tjera. Jam i informuar se vitin e kaluar domethënë 2025 nuk ka pasur mundësi buxhetore për me realizu këtë ndihmë. Për sivjet jemi të interesuar gjithsesi, mirëpo do të shohim mundësitë buxhetore se qysh janë, patjetër vullneti ekziston. Edhe në lidhje me pyetjen e zonjës, nga kuvendarja zonja Dafina Alishani se a do të hapet thirrja për subvencionim të nënave lehona, po ashtu edhe për vitin 2025 nënat lehona nuk janë kompensuar, nuk janë subvencionuar në fakt, edhe për vitin e tanishëm i kemi vështirësitë financiare, që i dini ju rreth rreth përmbauesve, problemi me përmbaues. Jemi të interesuar me gjithë forma, edhe në momentin që mundemi me gjete forma, po shpresojmë shumë në rishikimin e buxhetit në qershor. Paraprakisht njëherë ta shohim buxhetit qysh do të na vjen i miratuar nga parlamenti, por pastaj e kemi edhe një mundësi në rast se na lejohet rishikimi buxhetor nga ana e ministrisë. Edhe gjithsesi që kemi vullnet edhe dëshirë, por gjithnjë varet nga mundësitë buxhetore. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit drejtor. Fjala për ju drejtor i administratës, zoti Bexhat Bytyqi.

Bexhat Bytyqi: Po, faleminderit kryesues. Përshëndetje për kolegët drejtor, juve asambleisë, media, shoqërisë civile, qytetarë të nderuar të cilët dëgjojnë në këto momente. Dafina parashtoi një pyetje për lidhje me qendrën Evropa. Qendra Evropa është nën menaxhimin e drejtorisë së administratës. Unë personalisht kam qenë, e kam vizituar. Është mjaft e demoluar. Kam dërguar një ekip për vlerësim të demolimeve të cilat janë dhe shumë shpejt do të marrim një informatë prej atyre, do të marrim masa më tutje për renovimin e saj. E di që kosto është në pamjen vizuale që unë e kam bërë është kosto goxha e madhe. Po do të shohim mundësitë edhe do të veprojmë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjalën e ka Agim Muçaj, pak moshën po e respektoj Petrit.

Agim Muçaj (AAK): I nderuar drejtor Fatmir Memaj, respekt për ju. Sigurisht se një përgjigje të cilën e dhe tashmë në këtë fazë domethënë kemi dëshirë. Unë nuk mendoj se jemi këtu fontanë dëshirash, por kërkova një përgjigje si ekzekutiv, edhe pse e di se tash je veç dy muj ditë si drejtor, unë kërkova një përgjigje nga ekzekutivi që për këto katër vite, a do të jenë të përfshirë në buxhet rreth këtij projekti. Këtë e kërkova si përgjigje dhe këta qytetarë të cilët i përfitojnë këto benefite, së paku të jenë të njohur, çka i pret këtë dimër dhe dimrat e tjerë gjatë këtij ekzekutivi për katër

vjetë. Në qoftë se është e mundur ta kemi një përgjigje, sepse duhet të zotohen mjete për katër vite. Kjo është ajo çka e kërkoja. Në qoftë se keni mundësi të na jepni një përgjigje, s'është e thënë sot, por të projektohet si buxhet, a duhet të jetë e realizuar apo jo? Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Mund të drejtorit t'i përgjigjet? Urdhëro drejtor Fatmir.

Fatmir Memaj: Faleminderit zoti Agim. Nuk ishte ajo çështja e dëshirës. Unë thashë, ne, për shkak nga ana jonë, jo që s'kemi dëshirë dhe vullnet, gjithmonë do t'i kemi për këto kategori. Mirëpo, përgjigjet prerë, ashtu siç e kërkon ju, tash për tash, unë nuk mund me ju dhënë, për shkak të mundësive buxhetore. Nëse edhe një fakt është i njohur për ju, për çdo kuvendar besoj, se subvencionet ndahen nga, janë të përqëndruara tek zyra e kryetarit, që nga viti, mos gabofsha, 2020, kur ka pësuar ndryshim forma e subvencioneve. Mirëpo nëse duhet me i planifiku, duhet me i planifiku në kuadër të zyrës të fondit, për subvencionet që menaxhohet nga zyra e kryetarit, ne i kemi kërkesat. Tash në buxhetin që do ta përpilojmë në të ardhmen, sepse tash këtë buxhet ne veç e kemi gjetur të hartuar, kur e kemi marrë detyrën, për vite të tjera ne shpresojmë se do të na miratohen kërkesat. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Petriti e ka kërkuar njëherë fjalën. Fjala për ju.

Petrit Hoxha (Guxo): Faleminderit kryesues. Nëse nuk gaboj drejtori i bujqësisë e tha që shumë shpejt do të fillojë edhe procedura për qitjen e pronës në pronë komunale, nëse s'gaboj. Mirëpo në emër të kujt është ajo pronë që është ndërtuar strehimorja e qenëve endacak dhe qysh komuna ndërton me një parcelë që nuk është e veta?

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtori i administratës pra e ka fjalën, Bexhat Bytyqi.

Bexhat Bytyqi: Petrit, prona është e kuvendit komunal të Prizrenit edhe i kemi të gjitha lejet për ndërtimin e asaj. Strejmorja ka përfunduar është me standarde evropiane, është jashtëzakonisht e mirë. Vetëm është në fazën përfundimtare të rrethojave, të rregullimit të rrethojave, rrugëve, parkingjeve edhe kështu qysh është mundet me u dhënë shfrytëzim. Po shohim mundësitë. Mundet, është funksionale, domethënë mundet. Kështu që ndoshta drejtori ka desh me thënë që ka me u legalizu.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit drejtor. Fjala për ju Selman Sokoli.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Kështu po e marr fjalën në emër të grupit për sqarim, për shkak se ka të bëjë me rregullore. Zoti Memaj, nëse mund ta kem vëmendjen tuaj, një minutë, faleminderit. Rregullorja për grante dhe subvencione është amandamentuar në këtë kuvend me sa më kujtohet, në 27 dhjetor të vitit 2023, ndërsa në 2024 ka hyrë në fuqi. Ajo rregullore, ndër të tjerat, njeh dy forma të subvencioneve. Subvencione përmes thirrjeve edhe subvencione që qytetarëve, për shembull, personave të sëmurë me sëmundje të rënda, edhe nënave lehona, që janë përmes aplikimit. Ju jeni i ri në pozitë, mirëpo duhet t'i njiheni rregulloret. Kjo nuk ju amnistion. Edhe ajo rregullore thotë qartë, çdo fëmijë që lind në komunën e Prizrenit e ka një shumë të caktuar, varësisht në cilën renditje është. Nëse është fëmija i parë 250, fëmija i dytë 300 euro kompensim, minimalisht. Atëherë ka pas qenë për shkak të një konsensusi me kërkesën të LDK-së, minimalisht e kemi shtuar. Edhe fëmija i tretë e tutje 350 euro. Ju drejtor, unë nuk desha me

ngrit në fillim këtë çështje, mirëpo mbasi ju dhatë përgjigje jo të saktë për pozitën që e keni, si kuvendar që e kemi nxjerrë këtë rregullore besoj që më takon edhe në emër të Vetëvendosjes me ju sqaru, se ajo rregullore e njihet të drejtën e prindërve me apliku, jo përmes shpalljeve. Dy kërkesa i keni tashmë të protokolluara. Në kërkesën e dytë, zyrtarët e komunës kanë hezituuar me i pranuar, me insistimin tim i kanë pranuar. Kështu që, nëse ju të drejtave që i takojnë qytetarëve të komunës së Prizrenit në bazë të ligjit nuk i përgjigjeni, ata kanë me arrit përmes përmbauesit me e marrë ashtu siç po merr përmbauesi edhe shumë mjete të tjera financiare. Kështu që edhe njëherë po them i keni obligim që t'i njihni rregulloret dhe të zbatoni rregulloret, se rregulloret janë mbi vendimet e kryetarit. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju drejtor.

Fatmir Memaj: Faleminderit, zoti Selman. Unë nuk fola pa saktë sepse pyetja e zonjës Dafina ishte kur do të hapet thirrja. Në kuptim të pyetjes unë u përgjigja. Edhe ato klasifikimet, përshkallëzimet, për fëmijën e parë, e dytë, e tretë i kemi shfletuar dhe i kemi parë, mirëpo subvencioni është subvencion. Këto krejt varet nga mundësitë buxhetore, domethënë varet nga sa ke mundësi me pagu. Në qoftë se ata arrijnë me i marrë përmes përmbauesve është çështje tjetër, unë nuk e di këto a mundin ata me arrit me i marrë përmes përmbauesve, edhe është e vërtetë ajo që tha që nuk kemi nevojë ne me hap thirrje. Mirëpo unë përgjigjen e dhash sipas pyetjes së zonjës Dafina. Kështu që nuk do të duhej me më thënë që isha i pasaktë, sepse unë saktë ja dhashë përgjigjen nga ajo që kërkoj.

Selman Sokolaj (LVV): Nëse e ke marrë si ofendim po të kërkoj falje. Thash i pasaktë në bazë të rregullores, rregullorja thotë që nuk ka nevojë të hapet thirrje, subvencione me thirrje dhe subvencione që kur plotësohen kriteret ligjore qytetarët aplikojnë me vetë iniciativën.

Fatmir Memaj: U pajtova me këtë pjesë. Domethënë u pajtuva me këtë pjesë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Atëherë që nuk kemi përgjigje të tjera nga drejtorat, ata drejtor mund t'ia përcjellin edhe me shkrim pra pyetjet sikurse drejtoresha e inspektoriatit. A doni një pauzë? Atëherë sa kohë? 30 minuta? A po vazhdojmë? Atëherë 15 minuta pauzë dhe po vazhdojmë me pikat e radhës.

PAS PAUZE

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026;

Simir Krasniqi (Kryesues): Baca Haziz, mund të fillojmë. Atëherë fillojmë pra, pika e katër, rendi i ditës është shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026. E ftojme pra iniciuesin e kësaj pike nga prona që ta bëj prezantimin. Fjala për ju Zoti Gursel.

Gursel Skenderi (Zyrtar i Pronave): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithëve. Është obligim ligjor që komunat për çdo fundvitet të miratojnë listën e pronave komunale. Por për shkak të zgjedhjeve lokale afati për miratim nga asambleja komunale është shtyrë këtë vit sipas njoftimit të MAPL-së, dje e keni marrë të gjithë njoftimin çka u shty. Lista e pronave komunale është e njëjtë nga vitet e kaluara, domethënë prej vitit 2020 për çdo vit, me disa ndryshime dhe rifreskime që i kemi vërejtur e kemi plotësuar listën. Andaj për arsye se është obligim ligjor dhe kërkoj nga ju që kjo pikë e rendit ditës të aprovohet sot. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zotëri Gursel. Fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. I nderuari zotëri Gursel. A janë të përfshira të gjitha pronat e komunës në listën e përgjithshme?

Simir Krasniqi (Kryesues): Zoti Gursel, a po i merr të gjitha pyetjet mandej ju jep përgjigje apo një nga një? Qysh ta sheh të arsyeshme. Merri pyetjet më mirë edhe përmbledhjen në fund. Atëherë fjala për ju, Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Ishte pyetja e ngjashme me ato që tha parafolësi. Po deshta me shtu. Shumë prona unë që i di, që janë komunale, po janë të uzurpume. Apo merret dikush me qatë? Qysh ti duhesh me e qit në konkurse, qysh në këto procedura për me ja dhënë dikujt me qira, kur ajo prona është e nxënë. A i keni të evidentuar qato prona? Megjithëse e di që edhe ju i dini. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Agim Muqaj.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesues. Pasi që përfaqësuesi ligjor këtu na dha disa përgjigje por nga përvoja e në mandatin e kaluar pasi që kam qenë edhe vetë me një komision në ndarjen e disa pronave dhe përfituesve të tyre, në atë rregullore e kam vërejtur edhe vetë, si përbërës i atij komisioni sepse është keqpërdorur, domethënë shfrytëzimi i pronave, ku një palë, apo një person i caktuar, ka konkuruar mbi 30 prona, me emër dhe mbiemër sigurisht dhe e dinë edhe zyra ligjore se kush është dhe me çmime të ndryshme, unë mendoj se duhet të caktohen pak një rregullore më strikte, që të kenë mundësi që edhe shumë njerëz të përfitojnë, por jo një njeri të jetë përfituesi 20-30 prona apo 40 prona dhe pastaj të bën edhe pazare të ndryshme me individë të caktuar. Kisha dashur që në këtë pikë me të vërtetë zyra ligjore të përpilon kriteret të caktuara dhe të jenë më të rrepta, sepse është keqpërdorur dhe është manipuluar në ndarjen e prona, në mandatin e kaluar. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. A kemi fjala për ju, Karanfil Haxhillari?

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues. Neve e pamë që edhe një mori lokale, të cilat në këto prona komunale që kanë me u dhënë për shfrytëzim, kryesisht do të jenë lokalet e komunës Prizrenit që i ka në në posedim. Njëqoftëse nisemi nga përvojat e kaluar katër vjet më herët, e kemi parë procedurat qysh kanë shkuar dhe sot, kur po flasim, besoj që një numër i madh i këtyre lokaleve kanë mbetur të pashfrytëzuara, që e humb kuptimin e interesit të komunës së Prizrenit për të marrë të hyra dhe për të krijuar ashtu qysh po thuhet, për të krijuar vende të reja të punës, e ka humbur kuptimin, sepse nga një konkurrencë jo e mirëfilltë dhe jo fer, i kanë shkaktuar këto telashe. Tash, si pyetje konkrete do të jetë, sa lokale janë të pashfrytëzuar deri tash që nuk

shfrytëzohen nga bizneset? Një, edhe e dyta, po pajtohem me parafolësin Agimin, që është mirë që ajo rregullore të ndryshohet dhe të përmirësohet në mënyrë që një individ apo një biznes, në qoftë se investon në një lokal që është pronë e komunës dhe investon me mijëra euro dhe ai e ka kontratën vetëm një vjeçare, dhe në këtë rast, investimi i tij brenda një viti shtrohet një pikëpyetje shumë e madhe, a do të nxirret investimi i atij biznesmeni në këtë rast në atë lokal apo jo? Dhe aty është mirë që edhe në rregullore të parashihet që prioritet duhet të kenë shfrytëzuesit aktual, të cilët kanë qenë me pagesa të rregullta, që ju kanë përgjigjur komunës në pagesa, nuk janë borxhli të komunës dhe të krijohen kushte me të vërtetë që edhe komuna përfiton nga këto biznese, por edhe konkurrenca të jetë e mirëfilltë, jo sikur më herët që neve e kemi ngritur edhe si çështje edhe si raste këtu, që kemi pasur edhe nga këtu që i kanë përfituar nga pesë-gjashtë lokale dhe kanë përfunduar në një, kurse pesë të tjerat kanë mbetur bosh. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Selman Sokoli.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Nuk mundemi mos me konstatu mosprezencën e kryetarit Totaj në këtë pikë kaq të rëndësishme këtu në seancë. Siç duket Totaj edhe kryesisht PDK-ja, ka një farë problemi me çështjen e pronave, ju shkakton siklet, sinqerisht kishte qenë mirë me qenë kryetari këtu, për shkak se është çështje shumë serioze edhe çështje e ndjeshme, nuk është çështje me u zgërdhi. Zoti Gursel kam disa..

Simir Krasniqi (Kryesues): Selman vetëm një diçka. Unë nuk e di, fjalori yt mu zgërdhi, kush u zgërdhi. A është zyrtari i pronës, këqyre rregulloren mirë, të lutna, të lutna në fjalor, hera e parë edhe e fundit ti që përdor kësi fjalor. Vetëm vazhdon në temën, është përfaqësuesi i pronës, nuk ka nevojë kryetari, hera e parë ti që i ofendon këtë, hera e parë edhe e fundit që i ofendon.

Selman Sokolaj (LVV): Mos e ngrit zërin bre, mos e ngrit zërin se kërkush s'po të frikësohet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Urdhëro, urdhëro vetëm në pikën që ka.

Selman Sokolaj (LVV): Je kryesues i kuvendit komunal, mos e ngrit zërin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Unë jam kryesues që duhet ta respektoj rregulloren e punës edhe ta respektoj gjuhën parlamentare. Ta respektojmë gjuhën parlamentare.

Selman Sokolaj (LVV): Kohë pas kohe po e harron rregulloren.... vetes që gjithmonë duhet me zbatu rregulloren. Zoti Gursel, pronat komunale, këto lokalet edhe pronat që janë të shtrira gjithandej komunës së Prizrenit. Tash, nëse ne i plotësojmë kriteret ligjore që mi dhanë në shfrytëzim. Edhe e shpallim listën e veçanta e të përgjithshme të pronave. A kemi verifikim të ngarkesave eventuale të këtyre pronave? Për shkak se nëse nesër e japim në shfrytëzim një pronë, ajo pronë duhet me qenë pa ngarkesa. Në kemi pasur probleme të tilla këtu në komunën e Prizrenit. Kështu që a mundesh me na thënë statusin e secilës pronë? E jo vetëm me me hy' me i marrë të gatshme me na pru' këtu, për shkak se na qitni në lajthitje nëse si kuvendarë nuk e dimë se cila pronë çfarë statusi ka. Edhe e dyta, a je i sigurt që janë të gjitha lokalet e komunës së Prizrenit këtu në listë edhe që në të njëjtën kohë nuk kanë kontrata të rregullta shfrytëzimit. A kesh i qartë në pyetjen e dytë? Domethënë a jeni i sigurtë që komplet lokale që kanë me u dhënë në shfrytëzim, janë në këtë listë, po në të njëjtën kohë nuk kanë kontratë valide të shfrytëzimit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): Unë deshta me ndërhy pak më herët kryesues se domethënë jemi komplet jashtë rendit të ditës. Pikë e rendit të ditës është vendimi është vendimi paraprak i listës së përgjithshme. As nuk kemi tu dhënë shfrytëzim, as nuk kemi tu bë komision. Domethënë këtu po folet për një procedurë. Për qatë deshta me ndërhy me të thënë, jepja fjalën, le't'ju përgjigjet, le't'ju kallëzon cili është rendi i ditës se pak sot po' më duken jashtë sallës.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, sa herë që na drejtohen na duhet të na dhënë përgjigje. Listat të pronave të komunës Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nuk përmendi emër, nuk përmendi emër. Ju lutem. Fjala për ju Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesues. Unë e kam një pyetje të shkurtër për zotëri Gurselin. Unë kam qenë edhe kryetar i komisionit të lokaleve të pronave të komunës mandatin e kaluar. Veç një përgjigje ma jep, qysh është mundësia, këto lokale që i kanë marrë para pesë vite, që mos mos të ipen prap, mos të qiten në kuvend prap për me u marrë shfrytëzues të ardhshëm, po të vazhdojnë ata me qatë qira ose me qatë marrëveshje që e kanë marrë, sepse vërtetë ka që investojnë edhe mbas pesë viteve të ju merret lokali, kjo nuk është një gjë e mirë. Na trego anën ligjore, qysh mundin ata që ta mbajnë ose qysh mund ta kthejmë qet ligj, që mos t'ju mirret përveç se ka ndonjë strategji komuna, do me rritë qiranë, s'është dakord ai, e lëshon edhe normalisht mund ta merr ndonjë shfrytëzues tjetër. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit Alban. Atëherë fjalën e ka zyrtari i pronës zoti Gursel Skënderi.

Gursel Skenderi: Faleminderit prej të gjithëve edhe pse këto pyetje domethënë qysh tha Arianiti, domethënë jashta temës, po unë po ju përgjigjem. Bajram Kastrati, të gjitha pronat komunale, unë edhe në fillim thashë, çka për çdo vit prej 2019-ës kur e kemi përpiluar pronat, për çdo vit shtohen. Pse nuk mundemi me qenë të saktë? E kam thënë edhe dje në komitet për politikë, sepse emërtimet e pronave komunale janë shumë emërtime ka, edhe mundin me pasë lëshime, por ne për çdo vit me drejtori të tjera domethënë jemi duke e rifreskuar. Qemal Krasniqi pronat e uzurpuar. Qysh e tha Arianiti, mundet me pas e pronat e uzurpuara, po ato nuk është se sot po votohen edhe po zëmë shembull edhe ti po i zhvillon procedurat. Para çdo pronë e cila i bëhet në shfrytëzim, paraprakisht duhet me qenë e lirë edhe s'mundet me dhënë pronën e e uzurpuar. Agim Muçaj, e kjo korrespondon edhe kjo pyetje edhe me pyetjen e zoti Karamfilit. Rregulloren komunat nuk e përcaktojnë, e përcakton qeveria gjigjesisht Mapl. Ajo i përcakton! Ne nuk mundim me ndryshuar. Ne mundim me bë vetëm propozime, i kemi bë ato propozimet zoti Karanfili, çka ke thënë ata çka ka investuar me ja mundësu, por nuk ka, domethënë momentalisht me ligjin e ri, është ligji tjetër projektligji në procedim, janë do ndryshime ka me bë. Po me këtë ligj çka është në fuqi, shfrytëzuesit momental, nuk kanë, nuk kanë ndonjë përparësi. zoti Karafil, lokalet pa shfrytëzuar prej krejta lokaleve çka i kemi, domethënë listën e lokaleve për çdo vit e kemi, e keni në vebfaqe, domethënë emrin e mbiemrin, adresën, pagesën mujore, të gjitha të dhënat i keni. Momentalisht, momentalisht pa shfrytëzues, zoti Ilir ka qenë, domethënë dy-tre herë i ne i kemi qitur do lokale si si për shembull Siprintin. Ato kërkush s'po e merr se investimet. Investimet nuk po mundin, nuk

po mundin me i nxjerrë ai investitori, nuk po mundin me hy, ligji s'po e lejon me i barazu me qiranë. Domethënë të pashfrytëzuara janë gjashtë lokale, pesë lokale janë të ndërtesave këtu në Bazhdarhane. Edhe të Globalit, edhe një është Siprinti, gjashtë lokale momentalisht janë të pashfrytëzuara. Selman Sokoli ngarkesa, ndalesa eventuale. Tash kur, kjo lista kur votohet nuk kërkohet nga ministria ndonjë listë proceduese. Po nëse ndonjë komunë kërkon çka ta procedojë lëndën ndonjë pronë edhe ajo e kërkon listën proceduese Selman. Nëse në listë proceduese ka ndonjë ndalesë ose ndonjë formë tjetër, ajo nuk e jep, domethënë nuk e jep konfirmimin e ligjshmërisë. Paraprakisht ne s'duhet me shku në procedurë, por edhe nëse shkon, edhe nëse shkon, ne jemi të detyruar me dërguar listën proceduese të asaj prone. E në listë proceduese nëse shënohet ndonjë ndalesë edhe konfirmimi i ligjshmërisë nuk vjen. Kontrata të rregullta krejt kanë, domethënë ju thashë në web faqe krejt i keni, atyne krejt edhe me numër të kontratës i keni. Faleminderit kryesues. Faleminderit zoti Gursel. Fjalën e kërkon Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Zotëri Gursel, a ka mundësi me u kap veç pak më konkret? Cila është pengesa që s'mundeni me identifiku pronat e komunës? Ku është pengesa? Me ma dhënë një përgjigje pak më profesionale. S'kemi mundësi edhe kurrjë. Ku është pengesa? A është te kadastru apo ku është? Përderisa keni hartografinë, i keni të gjitha pronat, s'po e di ku është problemi.

Gursel Skenderi: Zoti Bajram, për çdo vit kjo pyetja po përsëritet? Nëse je në dijeni ne kuvendi paraprak, kuvendi paraprak ka marrë një vendim, një vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për bartjen e attributeve të titullarit, pronarit e pronave komunale dhe regjistrimin e tyre në shtik në emërtim ligjor, komuna e Prizrenit. Mirëpo nuk është konfirmuar ligjshmëria, se nuk e kanë dhënë pëlqimin Ministria e Infrastrukturës edhe agjencioni. Edhe që tash ne kemi pasuri, kemi shumë emërtime, pasuri shoqërore të kuvendit komunal, pasuri shoqërore rrugë, në të dy gjuhët janë, të mirat e fshatit, pasuri shoqërore rrugë, BVI për banim, bashkësi e banesa, e lloje-lloje të ndryshme. Për atë qëllim domethënë nuk mundet me na ik. Unë nuk po them çka janë, po nuk jemi të sigurtë çka janë të gjitha. Po për çdo vit prej 2019-ës kur e kemi bërë listën edhe e rifreskojmë për çdo vit aty ku kemi mundësi. E nëse kije ti ndonjë pronë, ne mundem çka na ka ik, mundem me e futë edhe atë pronën në listë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjalë e ka Agim Muçaj.

Agim Muçaj (AAK): Faleminderit kryesues. Zotëri Gursel, se di më së pari më kanë përzi mua njoh alfabetin ABC mirë, apo me të vërtetë shumë jam i pakjartë me ty. Unë nuk e di pse ky kuvend aprovon rregullore, emëron komisione edhe ne nuk pasmi të drejtë të marrim domethënë atëherë vendime të caktuara. Nëqoftëse ka diçka që varet nga ministria, atëherë ne s'kemi nevojë si kuvend këtu që të bëjmë emërime të komisioneve dhe emrat e të përveçëm e të marrin pjesë në këto komisione kur s'kanë autoritet asnjë troh. Në qoftë se janë ato pronat çka janë në kuadër të ministrisë, ne sigurisht se ne ku e kemi obligim këtu të kryejmë punët të ministrisë të cilat nuk ka mundësi që të zgjidhet deri në fund. Ne kërkojmë këtu, unë si kuvendar, nga përvoja e mandateve të kaluar, pasi që ka marrë vetë pjesë në një komision, dhe atëherë keni qenë shumë i paqartë në rregulloret e punës. Duhet të jenë të ndara përgjegjësitë të kuvendit komunal dhe ato të ministrisë. Dhe për ato gabime që janë bë gjatë rrugës dhe që kanë parë vetë, dhe të gjithë kuvendarët këtu dhe të gjithë qytetarët të komunës në Prizren ka pasur domethënë parregullsi të mëdha. Kështu që t'i ndajmë sendet çfarë i takojnë përgjegjësitë e kuvendit komunal nga ato ministrirore. Këtu kisha

dashur që t'i bëni këto prerje dhe të jeni më i qartë në rregullore që ne ta dimë se çfarë po marrim, çka po qojmë dorën, çfarë vendimi po marrim, sepse kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve. Faleminderit.

Gursel Skenderi: Rregulloret, nëse s'e kupton, s'kam çka me të bë. Rregulloret, ministria i bën. Po kuvendet komunale, neni 17 i rregullores, neni 17 i rregullores, thotë të formohen komisionet vlerësuese për çdo ankand. Më herët me vendimet e kaluara, me ligjet e kaluara ka qenë një komision vlerësues në katër vite, domethënë sa ka zgjatur afati i asamblesë, ka zgjatur edhe komisioni vlerësues. Tash me ligjin e ri prej 2020-ës është për çdo vendim, për çdo vendim formohet komisioni vlerësues edhe nuk po e di, a komisioni i ankesave çka vjen si pikë e rendit të ditës, është komision dyvjeçar. Domethënë brenda një mandati dy komisione. Nuk po di çka s'është e qartë këtu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Gyrsel. Fjalën e kërkoj më erët Petrit Hoçaj, në të përgatitet Dafina.

Petrit Hoxha (Guxo): Faleminderit kryesues, zakonisht për këtë emërtimin veç e morëm përgjigjen se pse nuk është bërë do thotë emërtimi që me shkruajtur krejt atë pronë komunale. Mirëpo është pyetja tjetër që nëse një shtëpi është e ndërtuar në pronë komunale, a ka obligim me paguar tatimin e shtëpisë nëse është në pronë komunale? Kaq.

Gursel Skenderi: Kompetencë e drejtorisë për ekonomi e financa tatimi mbi pronë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Kështu, sipas nenit 13 tek dhënia në shfrytëzim, domethënë tek pronat, është publikimi i listës së pronave të paluajshme të komunës. Edhe po e lexoj, po e lexoj këtë nenin. Thotë, "Komuna duhet të publikojë listën e përgjithshme të pronave të paluajshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues, datën e sqaruar, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës dhe paragrafi i dytë thotë kështu: Lista e pronave të paluajshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbajë këto të dhëna. Të dhënat katastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajshme të komunës. Pra ne këtu kemi një listë të përgjithësuar, e cila nuk i ka këto detajet ku ligji i parasheh, edhe duke marrë parasysh se çfarë qasje ka kjo qeverisje ndaj pronave komunale, duke e parë tash haptas që një zyre e cila është përgjegjëse për prona, nuk e ka haberin as ku janë të uzurpuara këto pronat, edhe duke parë parasysh çfarë qasje politike ka një zyrtar publik, edhe po bëheni nervoz, unë s'po kuptoj pse nuk e din zyra e pronave ku janë pronat e uzurpuara? Kur ju e keni obligim me ditë fatin e të gjitha pronave të komunës. Ju ndoshta nuk e keni kompetencë me i ndal uzurpatorët, po e keni kompetencë me informu inspektoriatin, edhe po të kishit pas mundësi me na informu këtu për shembull sa raste janë lajmëruar, sa raste janë ndërhyrë, atëherë ndryshe kishim vepruar edhe ne. Ne si Lëvizja Vetëvendosje, duke pasur parasysh se qasja juaj si qeverisje ndaj pronave nuk ka qenë në rregull, duke pasur parasysh që edhe nuk po respektohet ligji, sepse detajet e kërkuara sipas ligjit nuk i kemi në materiale, ne nuk duam të votojmë këtë listë e cila do t'ia hap mundësinë Shaqir Totës me bë bashkëpunime, pazare si qysh ka bërë në mandatin e kaluar edhe që qysh i ka rehatuar disa akterë politikë tash që i ka edhe në qeverisje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjalën e ka Selman Sokoli dhe të përgatitet Qemal Krasniqi.

Selman Sokolaj (LVV): Zoti Skenderi, ju jeni zyrtar në komunën e Prizrenit për çështje pronësore juridike, apo? Ju e luajtët zëdhënësin e shefit grupit kuvendarëve të PDK-së. Ju jeni shërbyes civil, ky është përfaqësues politik legjislativ. Në fjalën tuaj tanë kohën i referohesh siç tha ai, siç tha ai, s'po ja përmendi emrin. E sqaroj kolegja pyetjen që e bëra. Edhe më fal, hiç nuk jeni në opozitë, në bazë të asaj të parregullsive të mëdha, një mal me shkelje që ndodh në komunën Prizrenit, hiç nuk jeni në opozitë me na tregu neve edhe me na dhënë mësim qysh na bëjmë pyetje. Pak më herët një koleg kuvendar ju drejtua një drejtorit, në çfarë prone po ndërton? Ju i merrni pronat kopje paste edhe na i bini këtu. Është edhe kërkesë ligjore. Nuk jemi këtu në gjykatë me citu nene saktësi. Është kërkesë ligjore që ju ta dini fatin e një prone në komunën e Prizrenit. Kolegu, Petrit Hoxhaj më herët ju pyeti pikërisht për temën që jam duke pyetur. Ju thatë, 'taksat janë nuk janë detyrim i drejtorisë tonë'. Mirëpo ai pyeti për pronën e uzurpueme, në pronë të komunës. Domethënë gjithmonë shikoni me ik përgjigjeve. Duni me na u përgjigj në pyetjet tona edhe mos me na dhënë neve mësim çka pyesim. Ju thjesht përgjigjeni edhe nuk keni nevojë me bë hiç komente. Komentet bëjnë drejtorët politikë edhe asambleistët politikë. Pronat e komunës e Prizrenit, zotëri, a ke dalë ndonjëherë me i vizitu cilat janë pronat? Se nesër me këtë listë ti e shpall pronën për me dhënë shfrytëzim. Edhe shkon aty, është një pallat 15 katësh. Edhe ti habitesh që tërë jetën tu punu në drejtori të pronave. Në qesi situatë mos me ardhë, janë pyetjet tona edhe ka të tilla plot, këto nuk kemi me i përcaktu ato, mirëpo sektori juve është i obliguar me na u përgjigj neve edhe në të njëjtën kohë me siguru pronat e komunës së Prizrenit, ku janë, çfarë gjendje janë. Në këtë kontekst kjo pyetje. Përndryshe, kotë votojmë, ka me u bartë kjo vazhdimisht vit pas viti, vit pas viti, dekadë pas dekadë edhe në fund përfundojmë. Disa i jep Shaqir Totaj ku ka interes politik edhe disa mbesin të uzurpura përgjithmonë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë. Qemal a don me marrë fjalën?

Qemal Krasniqi (LDK): Zoti Gursel, kjo nuk varet krejt nga tij. Sektori i pronës moti është kështu, moti i ka neglizhuar sendet. Nuk ka që ka bërë ndonjëfarë pune, por nuk është as faji tash, as në kohën e Mytaherit, po as në kohën e Ramadanit, as në kohën e Eqës. Domethënë sektori i pronës karshi komunave të tjera që unë kam pasur rast, për një zgjidhje të problemi të një pronës komunale, brenda dy ditë janë në gjendje me ta krye. Këtu në Prizren s'jan në gjendje këtë punë me kry. Konkretisht ju. Jo ju si Gursel, po sektori i pronës në përgjithësi. A ka nevojë komuna e Prizrenit, urgjentisht të merret me këtë çështje? Shumë ka nevojë. Ka nevojë se dikush është duke përfutuar në korriz të pronave komunale. As nuk paguan qira, që 20-30 vjet e shfrytëzon pronën. Tjetra që dojsa me u kyç, janë disa prona që para luftës kanë ekzistuar si prona komunale, mirëpo mbas luftës ato prona kanë kaluar në bashkësi të ujërave. Qysh është problemi i këtyre pronave? A keni kontaktuar ju si sektor i pronës me bashkësinë e ujërave. Se ato kanë dalë në letër pronë e bashkësisë së ujërave, faktikisht deri vonë kanë qenë pronat e juaja, domethënë pronat jo të juajat por të kuvendit komunal. Në këtë drejtim a është biseduar ndonjëherë qysh qëndron çështja? Faleminderit.

Gursel Skenderi: Për këtë çështje, prej pronës komunale në bashkësi të ujërave nuk ka, po mbas listës proceduese ne kur e shohim bashkësinë e ujërave dhe ne nuk kemi të drejtë me vepru domethënë, nuk kemi të drejtë me vepru. Ato pronat çka shkruajnë bashkësia e ujërave është

kompetente Ministria e Mjedisit të Planifikimit Hapësiror, Departamenti i Ujërave. E kanë dal domethënë aty në drejtori për kadastër, domethënë se drejtori për kadastër, aty i bartën pronat ndërrohen pronarët a me trashëgimi a me shit blerje, a me falje, aty janë të dhënat atyre. Te ne kurr një çfarë të dhënë, nuk kemi dhënë, domethënë qysh ndërrohen.

Qemal Krasniqi (LDK): Po që këtu është problemi që s'është ka punon ky sektor, se komunat tjera nuk ja kanë lënë bashkësisë ujrave, se ka shumë prona brenda komunës së Prizrenit, që kanë qenë prona private, kanë kaluar në pronat shoqërore dhe tash janë prona të bashkësisë së ujrave. Njerëzit janë duke vrapu me i nxjerrë pronat e veta, nuk po munden, sepse falë neglizhimit, domethënë ju e keni neglizhuar këtë çështje si sektor i pronës dhe ato kanë mbetur prona të bashkësisë. Në komuna të tjera nuk është e njëjta gjendje. Në komunat të tjera nuk është e njëjta gjendje, ata zotnitë i kanë marrë pronat. Bile, bile me i këqyr mirë, të bashkësisë ujrave ata dhe nuk i dinë që i kanë pronat e veta.

Gursel Skenderi: Nuk e di unë, në qoftë se ke ndonjë udhëzim më të trego veç, vjet ka qenë, ka qenë domethënë nëpër komuna dhe nëpër agjencion, auditori. Komuna e Prizrenit, domethënë pronat vetëm pesë vërejtje i kemi pasur edhe tre vërejtje janë kanë.... Vetëm pesë vërejtje. Komuna e Prishtinës 29, komuna e Gjilanit 40 vërejtje. Unë nuk po e di, a e di qysh mundin me qenë komuna të tjera më të suksesshme. Vetëm 5 vërejtje prej auditorit i kemi.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit zoti Gursel. Fjalën e ka Shukri Quni edhe e hedhim votim këtë pikë.

Shukri Quni (BDP): Edhe prit se nuk keni me hedh hala. Gursel, jo rastësisht është djeg kjo bash sektori i pronave. Se aty janë lujt ato dallaverat më të mëdha. Shumë herë nuk po dua edhe me hy me diskutu në disa tema kur po dalin jashtë. Po ju si ekzekutiv... Unë nuk u inkuadrova edhe më herët, se kur është gjendja tensionuar është mirë, kush mundet me qetësu e jo me qit barutë në prush. Po ju si ekzekutiv, keni bë luftë për me marrë ato pozita që jeni aty. Me na i kthy përgjigjet neve edhe me na i kthy përgjigjet në mënyrën më të mirë edhe ne nëse ndonjëherë normal që dalim edhe ne prej lëkurës tonë, kur ju na detyroni me dalë. Unë dje ta bëra edhe në komitet për politikë e financa të njëjtën pyetje që ta bënë edhe kolegët këtu. Pra janë të gjitha pronat, pyeta dje, a janë të regjistruara në këtë dokument? Përgjigja domethënë u dha. Pastaj, e kërkoj një koleg këtu, pse nuk janë emrat edhe mbiemrat, e ruga, e lokaleve që i kanë? Thatë janë në vebfaqe. Po kur ka arrit me marrë kopje-past qeto far pronat edhe sa është sipërfaqja e lokalit dhe numri kadastral, a s'ka mund me i marrë edhe emrat mbiemrat? Se ne shumë mirë i dimë këto gjëra, kur janë ndarë këto. Kogja disa kanë prekur edhe në konflikt interes, që kanë qenë do të thotë, e kanë votuar vetë këtu, edhe ju kanë ndarë prona. Mirë e tha edhe kolegu këtu, po ne nuk po shkojmë me emra, po që doni hyjmë edhe me atë se s'e kemi atë farë dert. Edhe një vërejtje e keni për ekzekutivin, qy ç'a po ju them? Mos mendoni që ju jeni më të fortë si ne. Ju jeni të emëruar të gjithë. Këtë e kam përdorur edhe Mytaher Haskukës, edhe juve po ja përmendi. Juve ju shkarkon Shaqir Totaj, veç me gisht e bën. Po këtë e ka pas, këtë e ka pas, që duhet të për lavdatë me përmend Eqrem Kryeziu, 14 drejtor i ka shkarkuar. Po, tash unë nuk po shkoj në parti në cilën ka qenë ai, po po tregoj që ai i ka shkarkuar dhe i ka thënë në 3:30 me ardh. 15:00 në 4 edhe i thojke zotëri je lodh, shko pusho pak, edhe më ai kurrë këtu s'ka hyrë. Jo me shku nalt, pas atje se ka lënë te dera me shku. Merrni punën seriozisht. Mos na nënçmoni. Po përgjigjet që kemi me ja u bë ne, keni me

i kthy. Ose nuk jeni të gatshëm, jeni lodh, mundeni me shku nëpër shtëpia. Kërkush mëzor nuk ju ka pru. Ne jemi për qatë këtu. Na... jo jo, jeni lodhur fort shpejt ju. Ju kanë lodh meshkujt juve, se keni rënë në dy gjunjë më duket tash...

Simir Krasniqi (Kryesues): La Shukë vazhdojmë.

Shukri Quni (BDP): Unë shqip jam ka flas. Qe mbi 20 vjet janë duke bë këtu që jemi. Për çdo ditë jeni duke e ndi veten si diktator me qenë. Sikur mos me pasë këtu pozitë edhe opozitë. Po Eqremi, s'ka më Eqrem këtu, nuk vjen se ty të parin të kish hekë more Qemal! Me pas qenë Eqrem Kryeziu ty me gjithë disa, për veshi ju kish qit edhe ju kish gjujtë në rrugë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë pra, a kemi diskutime të tjera që nuk kemi?

Dafina Alishani (LVV): Më fal, më fal zoti Gursel mundësisht më ka. Neni 13 e kërkon këtë. Lista e pronave të paluajshme për dhënie në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna. Po s'po përgjigjesh?

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina njëherë e ke bërë pyetjen, dëgjoje përgjigjen.

Gursel Skenderi: Dafina shumë mirë e lexova pajtohem me juve, mirëpo a e ke lexuar edhe vendimin tonë për miratim paraprak të listës së përgjigjshme dhe të veçantë kjo kjo Dafina prej 2019-ës, qeky është vendimi. Domethënë mos t'i cekim me me kë e kemi bë atë, prej 2019-ës 20-ës. Domethënë edhe s'keni reaguuar në 2019-ën, në 2020-ën. Prej 2019-20-ës është. Arsyetimet çka thatë ju, janë katër arsyetimet.

Dafina Alishani (LVV): Sa herë ke dalë këtu në foltore na ke përshtjellë krejt punët qysh ke ditë vetë. Të vetmit kemi qenë kur edhe pozitë edhe opozitë kemi reaguuar për listën e pronave. Se ne mendojmë që pronat janë të shenjta. Nuk mendojmë që duhet me bë pazare me prona. Ti këtu kot del fol, e na pështjell secilën seancë sa herë vjen. Sa herë të kemi pyetur kurrë nuk na ke përgjigjur qysh duhet. Na përgjigjesh në mënyrë politike. Ti je zyrtar. Unë po të them pse nuk po respektohet ligji, pse nuk janë detajet e publikimit, njoftimit për periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim. A e di ju çfarë po doni me bë? Qorras ne me votu listën edhe ju...

Gursel Skenderi: Janë katër Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Cilat janë katër?

Gursel Skenderi: Në propozim vendim.

Dafina Alishani (LVV): Nuk e kemi.

Gursel Skenderi: Jo jo, duhet me pas. Qysh se keni, në propozim vendimin e kryetarit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Zoti Gursel, vetëm diçka, qeky vendim Dafinë e dimë që shkon në MAPL. Nëqoftëse është i paligjshëm, le të na kthen mosligjshmërinë e këtij edhe mos të diskutojmë. Çdo vendim kthehet ligjshmëria në qoftë se këta e përcjellin. Atëherë vazhdojmë këtë pikë e hedhim në votim. 36 janë prezent, kemi kuorum që ta hedhim këtë pikë në votim. Pra propozimi dhe miratimi i propozim vendimit paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Kush

është për? 23 janë për. Kundër? 11 kundër. Abstenim. Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikat e radhës.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit të Ankesave;

Simir Krasniqi (Kryesues): Zoti Gursel, fjala për ju.

Gursel Skenderi: Po, faleminderit. Po ashtu edhe formimi i komisionit të ankesave është obligim i çdo komunave. Përbërja nga propozimi ju mundni me pas, përbërja e këtij komisioni duhet të jetë pres anëtarëshe, domethënë dy anëtarë nga kuvendar, dy ekzekutivët dhe një anëtar nga OJQ-et. Afati i këtij komisioni është dyvjeçar, domethënë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit zoti Gursel. Atëherë i marrim propozimet nga partitë politike. Fillojmë nga Partia Demokratike e Kosovës, pra shefi i grupit të Arjanit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): Propozimi ynë për këtë komision është kuvendari Dea Gavazaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Arianit, duhet ta dini këtu që janë dy anëtarë, dy janë të propozuar nga kryetari dhe një është i shoqërisë civile. Propozimi i dytë pra nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Dafina Alishani (LVV): Po veç pak, kadale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Propozimi i dytë pra nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Çelësi për këtë komision qysh është kryesues, a mundeni me na informu?

Simir Krasniqi (Kryesues): Në këtë edhe pse e kemi zyrtarin e pronës, po po të informoj edhe unë. Këtu janë pesë anëtarë, dy nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe dy janë nga kuvendi komunal i Prizrenit. Ky është çelësi që është.

Dafina Alishani (LVV): Domethënë a mundemi me pasë çelësin kështu një nga pozita dhe një nga opozita në mënyrë që të kemi monitorim më të duhur edhe të kemi gjithë përfshirje të gjithë kuvendarëve, mendoj edhe propozoj që për hir të korrektësisë edhe për hir të laramanisë që është në kuvend, është dashtë me pas përfaqësim edhe pozita edhe opozita në komisionet të cilat janë mbikëqyrës. Ashtu ashtu ne rolin e kemi për mbikëqyrje. Edhe ju lus edhe kuvendarëve që t'i jepet mundësia edhe opozitës që ta kenë rolin mbikëqyrës në secilin komision që propozohet në kuvend.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, kund nuk shkruan që një pozitës dhe një opozitës, ata të cilët do të votohet këtu, ata të cilët marrin numrin e votave shkojnë pra në këtë komision, pra dy anëtarë se cilët janë. E drejta juaj është mundeni me propozu kandidatin, hidhet në votim edhe ai që ka vota më tepër, ai shkon këto dy kandidatë pra nga kuvendi komunal.

Dafina Alishani (LVV): Shiko kryesues, në demokraci ka pozitë edhe opozitë. Edhe në në secilin komision edhe parlamentar, se dje u tentua edhe me u banalizua me thënë që nivel qendror ka pasur. Edhe niveli qendror, komisionet parlamentare ka pozitë edhe opozitë. Kjo çka po tentoni me bë, sepse në mandatin e kaluar, pavarësisht që nuk ka shkruaj a i takon pozitës apo opozitës,

përfaqësimi ka qenë ashtu. Është korrekte, edhe në demokraci duhet bre me pasur edhe opozitë aty. Një anëtar, unë s'e di pse e keni hezitimin me pas një anëtar në komision kur me numra, prapë edhe në komision ju keni me pas shumicën. Po, nuk është në rregull me komplet me e mbytë demokracinë brenda kuvendit. Leni pak laramani se edhe juve ka me ju shërby për të mirë. Edhe më falni a mundeni secili asambleistë, kushdo që ka guxim me repliku, le ta dhezë mikrofonin edhe le të flet. Kësi lloj fjalë pa mikrofon, e me lëshu fjalë, nuk ka kuptim. Nëse keni guxim, dhezni mikrofonet. Mos hezitoni, jemi këtu për ballafaqim, po jo me lëshu fjalë si qysh s'ju ka hije.

Simir Krasniqi (Kryesues): E drejta juaj është me propozu kandidatin, e hedhim në votim, ai që merr vota më tepër edhe shkojnë këta dy kandidatë pra prej kuvendit. Fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Kryesues, në bazë të statutit të komunës që bazohet në ligjin për vetëqeverisje lokale, përbërja e komisioneve, komitetet duhet të reflektojë edhe përbërjen e kuvendit. Nëse ju anashkaloni opozitën, atëherë ju po keqmenaxhoni me pushtetin. Na e dimë, kena pa prej përvojës se si me pronën publike, me pronën komunale është sjellë ekzekutivi i kaluar. I dimë edhe hesapet, tash mundohuni edhe komision vlerësues, edhe ankesave me pas njerëzit e juaj, por për hirë të demokracisë, për hirë të transparencës duhet një anëtar gjithmonë të jetë edhe i opozitës, që të ketë edhe kontroll edhe balancë mes legjislativit edhe ekzekutivit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Ilir, po ne po veprojmë brenda ligjit. Në qoftë se është jashtë ligjore, na kthehet mosligjshmëria e këtij vendimi edhe s'kemi çka të diskutojmë këtu. Po e dini që ka shumë pika. Vetëm mundësisht brenda pikës rendi i ditës që jemi. Fjala për ju.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues gjithmonë brenda rendit ditës, po besoj, nëse e keni koncentrimin e duhur. Ka ligje, dmth në demokraci, po ka edhe shumicë edhe pakicë. Tash, nëse shumica ka synim transparencën dhe llogaridhënien, do t'ia jepte mundësinë edhe pakicës, opozitës, që me pasë një kandidat. Kështu që kërkush nuk po e konteston fuqinë që jo me i qu, se ndërvoja të tradhtoi, menjëherë dole te LDK-ja, prej PDK-së, te LDK-ja, se dy persona kanë me u zgjedh, njëri i PDK-së, njëri i LDK-së. Po shpresoj që arrini se kryesues se ne jemi në kuvend edhe folen edhe shqetësimet jashtë që kanë të bëjnë me këtë çështje. Keni filluar me u kap mes veti. Dikush e u uzurpon pronën, ja lëshon tani atij tjetrit me qira, mbas disa viteve ai e merr vesh që ky realisht e paska uzurpuar. Kjo po ndodh mes koalicionit juve këtu në Prizren. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Kryesues. Nëse zgjidhen dy kandidatë të pozitës apo mazhorancës. Unë nuk di opozita çfarë funksioni ka këtu atëherë? Kush ju kontrollon juve? Edhe nuk e di se ne pse thirrëmi atëherë në emër të 41 kuvendarëve këtu ose në emër të demokracisë. Në sistemin monist ka qenë një parti. Edhe kanë vendosur ata që kanë qenë në pushtet. Ne këtë kuvend e përbëjmë prej disa partive. Ju jeni në pushtet edhe keni koalicion, po e drejta e opozitës është që edhe kjo t'i ketë nëpër komisione, se nuk janë këto kush e di çfarë funksioni kanë këto. Po për me i kontrollu ato duhet të jetë edhe një anëtar i i opozitës në ato komisione. Nuk e di pse po e merr ti kryesues këtë kaq? Ka do gjëra që duhet me i diskutu ne. Çka e keni kapur këtë punë kaq egër ju? Nëse ju

ka rrok ramazani, unë kam qenë që me shkurtu dje. Dje të kam thënë, merri nja gjashtë-shtatë pika edhe krye vazhdojmë ditë tjetër. E kështu që respekto demokracinë se qështu e lyp demokracia.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë i marrim propozimet. Nga Lëvizja Vetëvendosje, a kemi kandidat?

Dafina Alishani (LVV): Ne propozojmë nëse kemi çelës pozitë-opozitë, a kemi?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo. Merren propozimet në qoftë se keni kandidat nga ju, e hedhim në votim, ai që merr votën.

Dafina Alishani (LVV): Domethënë po doni me pas qasje të tillë si kryesues i kuvendit i 41 asamblistëve, po doni me pas qasjen qysh e ka ekzekutivi, a e kuptova mirë?

Simir Krasniqi (Kryesues): Këtu u vendos shumica unë nuk bëj shkelje të ligjit është vota ajo e cila determinon se kush shkon. A keni kandidat nga Lëvizja?

Dafina Alishani (LVV): Po propozimi ynë është Karanfil Haxhillari.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Lidhja Demokratike e Kosovës.

Qemal Krasniqi (LDK): Lidhja demokratike propozon Bajram Kastratin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit në nga Bashkimi Demokratik. S'kemi propozim ju. Nga AAK-ja? Keni propozim? Jo, s'ka propozim. Nga KDTP-ja?

Sevilaj Igci Hapci (KDTP): Sevilaj Hapci.

Simir Krasniqi (Kryesues): Këtu shkojmë pra edhe pse me grupet parlamentare ata të cilët kanë mbi tre kuvendar këtu. Edhe i lexoj emrat, një nga një, ata që marrin numrin më të madh të votave, ata shkojnë dy kandidatë pra. Filloj me të parin Dea Gavazaj. Kush është për që Dea Gavazaj të jetë në këtë komision? Një për një shkon. 23 janë për. Vazhdojmë me kandidatin e dytë.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, veç një sqarim për me këtu. Sa kandidatë shkojnë? Dy kandidatë. Sa kandidatë janë ngarë? Tash për të katër kandidatë kemi të drejtë për kundër? Jo jo. Vetëm për dy kandidatë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë me kandidatin e dytë. Karanfil Haxhillarin nga Lëvizja Vetëvendosje. Sa jeni për? 15 për. Vazhdojmë nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Kandidati Bajram Kastrati. Sa jeni për që Bajram Kastrati të jetë pjesë..

Dafina Alishani (LVV): Kryesues ka asamblesistë që votojnë tri herë për tre kandidatë. Nuk bën ashtu. Ka asambleistë cilët kanë votuar për tre kandidatë. Ju zyrtarë aty që jeni të tre. A po i shihni, a ne duhet me ju me ju tregu? Ani e bëjmë me votim të fshehtë. Nuk ka mundësi kryesues. Nuk mundesh me votu për tre kandidatë asambleist i njëjtë. Për tre kandidatë është votuar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Sa jeni për që Bajram Kastrati? i ka ndaluar edhe te kandidati juaj me bërë.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, kjo është shkelje, kryesues. Kryesues nuk guxon me votu për tre emra, tre herë kandidatë, asamblastë të njëjtë. Ju lutem, kjo është shkelje, nuk jeni tu vepru qysh duhet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Në qoftë se është shkelje, na kthehet ligjshmëria. Atëherë, konstatojmë që Deja Gavazaj ka 23 vota, Bajram Kastrati ka 20 vota, Karanfili ka 15 vota.

Dafina Alishani (LVV): Po i numëroni votat e njëjta edhe për Bajramin edhe për Karanfilin, edhe për Deën. Një anëtar një assembleistë ka një votë, apo jo? Voton për dy kandidatë, nuk ka votë për tre.

Simir Krasniqi (Kryesues): Votimi është i hapur. Kanë mund edhe për Karanfilin dy me votu tash 23 ose 24. Kishte shkuar Karanfili edhe Dea.

Dafina Alishani (LVV): Kur ka më shumë se dy kandidatë, votohet për secilin kandidat ndaras dhe pastaj secili assembleistë ka të drejtë me votu nga njëherë. Nëse kishim votuar pako dy, pastaj kishim votuar qysh ju po thuni. Zyrtari ligjor ju lutem na informoni.

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Përshëndetje. Unë mendoj që votimi ke në rregull, duhet të votohet secili propozim. Janë ndare procese. Pastaj kumulotavisht votohen të dytë përnjëherë. Po veç e veç eliminohen me votim të përgjithshëm të secilit deputet tri herë, katër herë, sa herë ta qet kryesuesi në votim. Se është vendim i veçantë secili veç e veç. Nëse ajo e komunitetit turk për shembull u kandiduar ajo i ka dy vota, atëherë s'ka kuptim, se dihet. 100 vjet t'i voton, këta e kanë shumicën gjithë. Domethënë votohet secili, sa herë thotë kryesuesi, sa kandidatë janë.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, a bëni sqarim prej zyrtarit ligjor? Kryesues, një sqarim prej zyrtarit ligjor. Jo s'e mora sqarimin.

Simir Krasniqi (Kryesues): E more sqarimin shumë në rregull.

Selman Sokolaj (LVV): Se nëse janë 110 kandidatë, po e marrim një analogji. Edhe 10 kandidatë ke të drejtë me i votuar se 10 shkojnë. Qysh ke të drejtë? Jo, nuk mundesh me ec, ec... a e thirre zyrtarin ligjor, a mos i dëgjo këta çfarë thojnë? Zyrtari ligjor na sqaron. Po kjo është naivitet more, a s'po ju vjen marre, qet send mos me dit, shumë e thjeshtë kjo. Dy persona shkojnë, munden me kandidu 20, vetëm dy vota i konsumoni i nderuar. Hipotetikisht jurist i shkëlqyer, nëse ne votojmë njëjtë për të gjithë, çka ndodh? Për dy kandidatë ki drejt me votu. Për dy kandidatë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mbasi ishte edhe një propozim

Selman Sokolaj (LVV): Se dy kandidatë po shkojnë, nëse shkojnë tre ki drejt për tre. Edhe shumë, shumë e thjeshtë është kjo.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pasi ishte edhe një propozim, mundem me edhe propozimin e katërt, kush është për Sevilain?

Dafina Alishani (LVV): Kush ka grup parlamentar propozon, apo jo? Tash? Sa anëtarë janë ata? Edhe? A a formojnë grup parlamentar? A duhet me ju tregu juve rregullat bazike çka do të thotë një grup parlamentar i nderuari kryesues. Po a është grup parlamentar? Me rregullore e ke tre e tutje, apo? Pse s'po respekton rregulloren?

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë me propozimin e Sevilait. Kush është për?

Selman Sokolaj (LVV): Kush ka të drejtë me propozu?

Simir Krasniqi (Kryesues): Unë jam këtu që e udhëheqi seancën, mundesh me dëgju.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues ti duhesh me na sqaru. Duhesh me na sqaru. Kush ka të drejtë, kush ka të drejtë me propozu? A ka të drejtë grupi i kuvendarëve apo?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po është fjala për ju, Sevilaj. Atëherë Sevilai tërhiqet. I hedhim në votim pra Dea Gavazaj edhe Bajram Kastrati. Kush është për që këta të jenë në këtë komision? 36 janë në sallë, kemi kuorum. 24 janë për. Kundër? 8 janë kundër. Abstenim, nuk ka abstenim. Atëherë pra Dea Gavazaj, Bajram Kastrati. Nga ekzekutivi Senxhar Karamuço, Flornet Ukaj dhe nga shoqëria civile Linda Simitçiu nga shoqëria civile. Këta janë të votuarit, në kuvend dy edhe dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Miratohet kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e radhës. Urdhëro, veç shkurt.

Karanfil Haxhillari (LVV): Të nderuar, po ju referohem qytetarëve të komunës Prizren. Janë mbi 57 lokale, të cilët kanë me u dhënë në shfrytëzim. Dhe siç e patë në këtë kuvend, edhe pse pesë anëtarë të komisionit i kanë takuar ekzekutivit dhe vetëm dy nga kuvendi, këta aq demokratë janë që hezitojnë së paku një anëtar ta ketë opozita. Vetëm një anëtar. Kur në atë komision të mbytin me votë opozita në këtë rast, si nga ekzekutivi. Dhe çka bjen, ku unë mos me mendu tash, cila është arsyeja mos me mendu unë, që tash këto lokale kanë me shku për dosta, kanë me shku për militantët dhe për interesa të ngushta të ekzekutivit. Por që, mbajeni mend do të hyni në llupën e opozitës për secilin lokal dhe për secilin metrazh të dhënë me qera. Sot ju tregut që jeni me të vërtetë, keni mentalitet diktatorial që nuk i lini hapësirë as edhe vetëm një anëtar të komisionit kjo legjislaturë dhe thirreni në fuqinë e votave. Kjo është arrogancë, e cila arrogancë do t'ju kushtojë shumë shpejt.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë pra me pikën e gjashtë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për zgjedhjen dhe delegimin e përfaqësuesve nga ekzekutivi dhe kuvendi i komunës në asociacionin e komunave të Kosovës.

Simir Krasniqi (Kryesues): E këtu e keni marrë materialin të gjithë materialin e keni para vetes. Këtu pra shkojnë katër anëtarë nga kuvendi dhe kryetari i komunës. Pra këtu i takojnë, nuk e kemi bërë këtë ndarje ne, po e ka bërë asociacioni. Këtu i takojnë dy Partisë Demokratike, një nga Lëvizja Vetëvendosje dhe një nga LDK-ja. Ju kisha lut këtu që ta respektojmë kuotën gjinore, atëherë shkojmë me propozimet, së pari, nga Partia Demokratike.

Arianit Berisha (PDK): Propozimet të Partisë Demokratike

Simir Krasniqi (Kryesues): Vetëm Arianit t'ia jap përgjigjen. Këtë renditje...

Arianit Berisha (PDK): Po ja kemi dhënë dje prej kryesues në komitet se nuk është që nuk e dinë, krejt përgjigjet i dinë. Janë duke bërë filma për kamerën, po mendojnë që janë hala në fushatë. Të vazhdojmë ne me pikat e rendit ditës se komplet është jashtë rendit ditës. Kur flasim brenda rendit ditës, hajde po i durojmë ato torturat që tha Baci Haziz, mirëpo janë tu na torturuar me të vërtetë,

shumica e fjalëve janë jashtë rendit i ditës. Tu kisha lutur kryesues, tu kisha lutur. Që jashtë rendit të ditës mos tolero. Kështu që ma dhaje fjalën po vazhdoj. Propozimet e Partisë Demokratike janë Tefik Tarashaj dhe Trëndelina Kastrati. Faleminderit.

Shukri Quni (BDP): Përderisa nuk shtjerret pika e renndit të ditës, nuk ka propozime kryesues! Çdo pikë e rendit i ditës duhet me u diskutu këtu. Dëgjo. Unë dje shumë mirë e diskutuam edhe në komitet për politikë e financa edhe shumë mirë i kuptuam. Po këto që e thae ti, që këto e ka vendosur Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e jo unë, apo bjen tash në kundërshtim me qatë që ti e vendose, pesë anëtarë me shku prej pozitës, e asnjë me shku prej opozitës. A janë në kundërshtim?

Simir Krasniqi (Kryesues): Kështu është. Nuk e ka vendosur Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, por asociacioni i komunave të Kosovës. Këtë ndarje, ai ka shkuar në bazë të përfaqësimit në kuvend komunal. E ka përdorur çelësin dhe PDK-së në këtë rast i kanë takuar dy, Lëvizjes Vetëvendosje një dhe LDK-së një. Atëherë, e marrim propozimin nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Edhe unë pajtohem me zotëri Shukri Quni, pa pasur diskutim të pikave nuk bën me vendosur emra ose propozime. Ne jemi këtu për me diskutu, pavarësisht që juve ju duket torturë, mundeni me liruallë sallën kujna nuk i pëlqen qasja jonë, po ne këtu e kemi obligim me diskutu secilin pikë me secilin detaj. Sipas materialit që e keni dërguar, asociacioni thotë kështu, përveç kryetarit të komunës, komunat i delegojnë për çdo 10 anëtarë të kuvendit komunal, një përfaqësues në kuvendin e AKK-së. Kërkohej edhe përfaqësimi i partive politike, edhe përfaqësimit gjinor. Ju ndoshta nuk po na shihni si parti politike, po secili këtu është parti politike dhe përfaqësimin mundemi me bë. Plus asaj, shtojë që brenda pesë vetave, PDK-ja përfaqësohet edhe prej kryetarit. Ju lutem, ta kemi pak një laramani sepse asociacioni është me rëndësi edhe duhet me pas përfaqësim nga partitë politike. Ashtu e thotë edhe materiali.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, çelsi që na ka ardhur prej asociacionit, kryetari, Partia Demokratike, dy anëtarë nga kuvendi komunal, Lëvizja Vetëvendosje një, edhe Lidhja Demokratike një anëtar. Ky është çelsi. Po, Agim Muçaj.

Agim Muçaj (AAK): Kryesues, sinqerisht, jam duke ballafaqu me shumë pakënaqësi dhe mospajtime. Veçse edhe ti në këtë rast mi qove malltet e Gurselit, që sa herë që e flet, është i pakapshëm edhe na përziën jo nalt, jo poshtë, ne jemi komuna. Me të vërtetë nuk kam pasur çast dhe nuk jam informuar bash saktësisht si të tjerët, po duhet të vlerësohen edhe mendimet kritike edhe analizat. Aty ku vendos kuvendi i komunës, qoftë Shaqir Totaj, qoftë kryesuesi, duhet të mirren përgjegjësi se ne kemi vendosur. Mos të hudhen përgjegjësitë, jo ministria, jo ne, se ne e dimë që çdo gjë çka vendoset këtu, vendos komuna e Prizrenit. Kështu që kam qef me qenë më i qartë. Mos na e përzi punët si Gurseli, se di a kemi punë me Bullgari a me Shqipëri.

Simir Krasniqi (Kryesues): Agim është kështu, kuvendi komunal në çdo vendim që merret këtu, përcaktohet në ligshmërinë e tij, se çdo vendim nënshkruhet edhe i përcillet me MAPL-së. Në qoftë se ne shkojmë me dëshirat e kuvendit komunal, se qysh na teket neve, asnjë vendim nuk do të na vjen ligjshmëria e tij nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Dhe ne veprojmë në

bazë të ligjit edhe në bazë të rregulloreve që na takojnë. Atëherë i marrim propozimet. Vazhdojmë me lëvizjen. Po Karanfil po e kot se po më duket se e tepërt këto debatet.

Karanfil Haxhillari (LVV): Veç veç një pyetje. A e ke të e ke të shkruar nga asociacioni i saktë për këto që i përmende dy PDK-ja? Ne në material nuk i kemi. Nëqoftëse i referohemi kësaj, thotë për çdo 10 anëtarë të KK-së një shkon. Ky kuvendi ka 41 anëtar. A i takojnë tash pyetja është, a i takojnë pesë, a i takojnë katër? Një, sepse po e kalon numrin 41. Dhe tjetra, këtu bre i ke katër grupe parlamentare jemi. Me të vërtetë, pse nuk duhet me shku ka një prej secilit subjekt? Prap bre dy i ke, kryetari shkon me automatizëm.

Simir Krasniqi (Kryesues): E kemi që na është drejtuar pra kryetarit të komunës dhe mua kryesuesit nga Asociacioni i Komunave, Safete Beqiri është dhe këtu e ka dhënë çelësin, përveç materialit që është përcjellë ju. Thotë, Partia Demokratike i ka dy anëtarë, Lëvizja Vetëvendosje një, edhe Lidhja Demokratike një. Mundësisht që të respektohet kuota gjinore, tash propozimet i morëm nga Partia Demokratike, e marrim propozimin nga Lëvizja Vetëvendosje dhe nga Lidhja Demokratike. Mua po më duket vetëm të bëjmë debat ndoshta para mediave që po flas diçka e po them diçka, asnjë troh në temë që po e kërkojmë. Vazhdojmë pra me Lëvizjen Vetëvendosje.

Selman Sokolaj(LVV): Kryesues sa për informacion në mandatin e kaluar ka qenë zotëri Ilir Gashi, Vetëvendosja ka qenë subjekti më i madh parlamentar. Domethënë për vetëm Ilir Gashi ka qenë përfaqësues. Edhe njëri prej çelësave aty thotë të përfaqësohen subjektet politike mundësisht. Ju po ja mohoni subjekteve politike me u përfaqësu. Edhe kryesues, është hera e tretë që po e ngrit tonin. Sinqerisht po të drejtohem nuk ke nevojë me e ngrit. Nuk ke nevojë me ngrit se kurrkush nuk fiksohet për asgjë. Nuk ke nevojë me ngrit tonin. Ky tregon çka me fol. Mungesa ABC-së, demokracisë është mospranimi i mendimit tjetrit. Ju keni qaq aftësi sa që edhe përmbajtjen e mendimit neve na përcaktoni. Se le më formën, se e ndërron sa herë që ke nevojë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pikë së pari, duhet me u pajtu me realitetin që numrat janë ata të cilët e përcaktojnë kuvendin. Prej në 8 a në 7 sa jeni, unë nuk e kam problemin, se qysh po shihet keni me mbet edhe në 5, mbas dy-tre seancave. Atëherë vazhdojmë pra me propozimin nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Edhe 1 me mbet, qetu nuk kemi me të lënë me e keqpërdorë detyrën. Edhe një person me mbet, nuk kemi me të leju ty me e keqpërdorë pozitën që e ke. Mos harro, kush i ka dhënë shkep andej, shumë shpejt i ka përfunduar keq. Qoftë me ekzekutiv, qoftë me asamble. Ju lutem ta mbani qetësinë, ju jeni këtu, bashkë me neve kolegë, mos u bëni arrogant siç e keni ekzekutivin. Leni, përgjigjen e keni edhe ju edhe me numra edhe me përqindje edhe me krejt i keni pa. Të lutna, ruaje qetësinë se je kryesues i të gjithë kuvendarëve. Nuk je.. kuvendi bre të ka votu ty? Nuk je bre këtu qekaq arrogant me u sillë me secilin prej neve?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po të duket Dafinë.

Dafina Alishani (LVV): I paskem hy' në hak Antigones, se lule dritë koka kanë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nuk mundem me shkel ligjin dhe rregulloren, me shku me jua plotësu dëshirat e juaja të opozitës.

Dafina Alishani (LVV): Ne kemi pas 12 asamblistë, e kemi pas vetëm një përfaqësues. Tash koka bë formulë e re, rregull jemi, ju tregoni qysh ka mundësi një grup parlamentar me 9 veta e ka një përfaqësues, edhe një grup parlamentar me 6 veta i takon një përfaqësues. Edhe këtu Chat GPT-në, le ta vetë ky personi që na referoj. Sa i përket komisioneve, prapë po them, jeni duke e mbyturë demokracinë brenda kuvendit. Jeni çu peshë, nuk ka me ju dalë mirë, sepse, sepse jeni duke e mbyturë demokracinë brenda kuvendit edhe kjo qasja juaj nuk është në rregull aspak. Edhe drejtoreshë, ruaje qetësinë amani të qoftë, i ke plot kurdisje që po të presin, ruaje qetësinë, i duhesh ti këtij vendi. Të lutna, mos jep preferime te kryesuesi, ju jeni ekzekutiv, jeni këshilltar këtu të kryetarit, të lutna ruaje qetësinë, ruaje se na duhesh, na duhesh për trika, na duhesh për shumë tenderë, të lutna, të lutna!

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, do të ishte mirë kryesuesi që t'jua plotësoj dëshirën e juaj të opozitës, po është sovrani ai që ka vendosur, nuk kemi vendosur ne, është numri i anëtarëve në kuvend edhe këtu vazhdoj me propozimin nga Lëvizja Vetëvendosje.

Karanfil Haxhillari (LVV): Lëvizja Vetëvendosje e propozojmë Dafina Alishani.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Qemal Krasniqi (LDK): LDK propozon Agnesa Sinanaj Gavazaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë, këto janë emrat, kryetari i komunës pra zoti Shaqir Totaj, Tefik Tarashaj, Trëndëlina Kastrati, nga Partia Demokratike, nga Lëvizja Vetëvendosje Dafina Alishani dhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës Agnesa Sinanaj. E hedhim në votim. 34 është numri, kemi kuorum, e hedhim në votim. Sa jemi për? 29 jemi për. A kemi kundër? 1 kundër. Abstenim. Atëherë miratohet pika e rendit të ditës, 29 për dhe 1 kundër që këta kandidatë janë pjesë e asociacioni. Kalojmë në pikën e radhës.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Simir Krasniqi (Kryesues): Për këtë pikë pra, kuvendi ka formuar grupin punues për hartimin e planit të punës. Kemi mbajtur një punëtori të përbashkët, grupi punues, drejtorët komunalë, të ekzekutivit dhe udhëheqësit e zyrave komunale, për të hartuar hartimin e planit të punës. Po ashtu, kemi mbajtur edhe një takim të përbashkët me grupin punues për të formalizuar draftin final para dërgimit në kuvend. Materialin e keni marrë me kohë dhe besoj që i keni lexuar pikat që janë propozuar në këtë plan të punës, për vitin 2026. Atëherë, e hapim diskutimin. Po fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. Kam një propozim me fut këtu në plan të punës së kuvendit. Propozoj të formohet komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në komunën e Prizrenit edhe ata në muajin mars.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Bajram. Kemi dikush tjetër që do me marrë fjalën? Dafina për ju fjala.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Ndër temat këtu që më së pari kritika e parë për ekzekutivin është shumë pak rregullore ka të parapara në plan të punës. Nuk e di a është mungesa e interesimit të drejtorëve, a nuk ja keni haberin çka me bë me drejtoritë e juaja. Domethënë numri

i paktë i rregulloreve tregon shumë për ekzekutivin që e kemi. Është për keqardhje, nuk i keni kryer, ka shumë probleme të cilat duhet me pas rregullore edhe duhet me ja lehtësu qytetarëve jetën në Prizren. Sidoqë të jetë rekomandimet e mia janë kështu, bordi i menaxhimit të objekteve kulturore dhe sportive duhet të vijë dhe të raportojë në kuvend. Domethënë propozim si pikë, muajin mundeni kurdo që është më e lirë agjenda. Raportimi i hidroregjionit për gjendjen e ujit në komunë, kryesisht gjatë periudhës të verës po kemi probleme, kështu që mirë është me i ftu edhe ata me pasur një raportim. Edhe po ashtu e kam edhe propozimin domethënë këto drejtoritë të cilët çdo gjashtë muaj ndoshta mirë do të ishte me ardhë me raportime, sidomos ku ka thirrje të subvencioneve, me na informu së paku sa prej tyne paguan edhe sa nuk janë paguar, sepse domethënë secila drejtori po i ka thirrjet, po i kryen të gjitha procedurat, po informimi po na mbetet shumë i mangët në raport me punët që po bëhen brenda komunës. Mendoj që edhe këtu do të ishte mirë secila drejtori që ka subvencione, të raportojë së paku dy herë në vit. Edhe jo dhe kaq se hidroregjionin e kam thënë. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit fjala për ju Shukri Quni. Ta marr pyetjen që mirë atëherë kemi diskutues të tjerë jo. Po është aty. Atëherë me propozimin e Dafinës dhe Bajramit e hedhim në votim kush është për? 25 janë të pranishëm. Unanimisht votohet plani i punës së kuvendit për vitin 2026. Vazhdojmë me pikën e radhës.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale KRM “Eko Regjioni” Sh.A. Prizren;

Simir Krasniqi (Kryesues): E ftojme iniciuesin e pikës, pra drejtorin e shërbimeve publike që ta merr fjalën.

Islam Ukaj: Faleminderit, kryesues. Po, unë e kam cekur edhe në Komitetin Politik dhe Financa, se në momentin që përfundon mandati i asamblesë komunale, i përfundon edhe mandati i aksionarëve që janë të emëruar nga kryetari dhe nga kuvendi komunal. Andaj e kam iniciuar këtë pikë që tash të emërohen aksionarë të rinj nga kuvendi komunal i Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Ka diskutime të tjera? Atëherë që nuk ka diskutime, marrin propozimet nga partitë politike, nga Partia Demokratike e Kosovës.

Arjanit Berisha (PDK): Propozimi ynë është kuvendari Endrit Zogaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Për hir të korrektësisë edhe për hir të prapë po themi monitorimit dhe mbikëqyrjes, mendojmë që opozita duhet të jetë pjesë e secilit komision që emërohet nga kuvendi edhe propozojmë kolegun nga BD-ja Sefidin Islamaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga Lëvizja Vetëvendosje propozohet kuvendari i Bashkimit Demokratik pra Sefidin Islamaj. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Haziz Hodaj (LDK): A është fjala për Ekoregjion apo? Lidhja e Demokratike propozon Astrit Temën.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit baca Haziz. Atëherë i kemi tre propozime. Fillojmë pra me e njëjta çelsi këtu është dy nga kuvendi dhe një nga ekzekutivi. Mundësisht për shkak të procesverbalit publikisht ta tërhiqni. Jo, propozuesja e pikës së Vetëvendosjes ajo e ka propozuar dhe mund ta tërheq?

Dafina Alishani (LVV): Propozuesja e pikës bashkëndjen dëshpërimin me zotëri Shukri Quni dhe ju thotë merrni krejt komisionet i bëfshit me shëndet po keni me pas monitorimin shumë më të ashpër edhe opozitën shumë më të ashpër për secilin vendim që e bëni në atë komision. Suksese, inshallah po kënaqeni diku.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit.

Arianit Berisha (PDK): Atëherë Kryesues, dëshpërimin e bashkëndjej edhe unë me kolegët e opozitës.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, a po ja nisim tash me u gjujt me fjalë apo po ndërhyne.. Edhe unë bashkëndjej me ty në çfarë partie të lodhtë je. Se veç mendoni që mundeni me i kap çdo send që mundeni dhe ju ka rrok arroganca e tepërt e pushtetit, po ke me pa që keq ka me ju dal.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë, atëherë erdhëm në votim. Këta janë kandidatë nga Partia Demokratike është Endrit Zogaj, nga Lidhja Demokratike Astrit Temaj. Sa jemi për? 24 për. Kundër 11. Abstenim 1. Atëherë miratohet pra pika e rendit të ditës, që aksionarët nga kuvendi në Ekoregjion të jenë Endrit Zogaj dhe Astrit Temaj. Kalojmë me pikën e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prizren;

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe këtu për ju fjala drejtor i shërbimeve publike zoti Islam Ukaj.

Islam Ukaj: Faleminderit kryesues, e njëjta vlen edhe për të stacionin i autobusave me përfundimin e mandatit të asambleës, faktikisht i përfundon mandati edhe aksionarëve që kanë qenë të emëruar, andaj tash duhet të emërohen aksionarët e rinj nga kuvendi komunal. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, marrim propozimet pra, nga Partia Demokratike Kosovës, shefi i grupit.

Arjanjt Berisha (PDK): Propozimi ynë është kuvendari Tefik Tarashaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Nuk kemi propozim, ju dëshirojmë suksese në kapjen e secilit ndërmarrje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës?

Qemal Krasniqi (LDK): Që zëdhënësi jonë, po ta jep përgjigjen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë. Nga Bashkimi Demokratik?

Shukri Quni (BDP): Nuk po e di kryesues për çka po kërkon prej neve tash. Jo jo prit kush tha që s'kam kandidat.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po fjala për ju Qemal Krasniqi.

Shukri Quni (BDP): Kryesues, unë e pata fjalën. O unë kesh tu fol, o Qemal. Se i ka humb busulla krejt kryesuesit. Kryesues mua ma dha fjalën. Na tha me propozu, edhe u çuan ndërhyjnë të tjerët. Mbaje rendin, se këtë punë e ke me bë. Dikuj me ja dhënë fjalën, mos të shkojmë tash me tejkalu çdo pikë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Petrit mos ndërhyj Petrit. LDK-ja propozon jemi marrë vesh që kësaj radhe të jepet mundësi Albulena Balaj Halimaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga Bashkimi Demokratik? Atëherë nuk ka kandidat. E hedhim në votim pra, janë dy kandidatë. Është Tefik Taraj dhe Albulena Balaj Halimaj. 31 janë të pranishëm. Sa jemi për? 20 për. Kundër? 8 janë kundër. Abstenim? Nuk ka abstenim. Atëherë me 20 për, Tefik Taraj dhe Albulena Balaj Halimaj votohen dhe miratohet kjo pikë që të jenë aksionar nga kuvendi komunal në stacionin e autobusëve shoqëria aksionare në Prizren. Vazhdojmë me pikën e radhës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe inicimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të tij;

Simir Krasniqi (Kryesues): Kjo pikë pra, duhet ta dimë të gjithë që edhe dje në Komitet për Politikë dhe Financa e diskutuam, kuvendit i mbetet që t'ia hap rrugën që të shpallet ftesa publike dhe pas ftesës publike zgjedhet një komision dhe caktohen kushtet dhe kriteret për aplikimin e kandidatëve, pra të cilët do të jenë pjesë e Këshillit për trashëgiminë kulturore të qendrës historike këtu në Prizren. E hapim diskutimin që ka dikush për të shtuar apo Atëherë nuk kemi diskutime e hedhim në votim. 32 janë të pranishëm. Kush është për? 29 për. Kundër? 1 kundër. Abstenim. Nuk ka. Atëherë, miratohet pra kjo pikë që të hapet ftesa publike për Këshillin për trashëgiminë historike të Qendrës së Prizrenit. Vazhdojmë me pikën e radhës.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad hoc për organizimin e procesit të zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të Këshillit të Fshatit Zym i Hasit;

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe në këtë pikë pra, kemi mbajtur takime me shefat e grupeve dhe nga të gjitha partitë politike që janë të përfaqësuar pra, nga tre e më tepër, të kenë nga një kandidat dhe një kandidat shkon nga partitë e komunitetit. Në këtë rast partia me numër më të madh të votave. A vazhdoj me propozime apo?

Dafina Alishani (LVV): Në pikën paraprake, a është dashur edhe emra me propozu?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo, jo, vetëm vetëm për ftesë publike.

Dafina Alishani (LVV): Vetëm për ftesë publike. Sepse këtu është edhe propozim vendimi për emra.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pasi të kryhet ftesa publike, atëherë caktohet një komision. Atëherë vazhdojmë me propozime. Urdhëro Dafinë..

Dafina Alishani (LVV): Për hir të korrektësisë edhe informimit me asambleistët të tjerë të cilët nuk kanë qenë në takimin ku kemi pasur shefat e grupeve. Çështja e pagesës të këtyre anëtarëve, ne kemi kërkuar që përmes zyrës ligjore me na dhënë një sqarim para votimit, në mënyrë që pastaj edhe t'i bëjmë thirrje profesionistëve dhe atyre të cilët kanë interesim të jenë pjesë e këtyre komisioneve, se a do të ketë pagesë apo jo. Ju shumë mirë e dini që mungesa e pagesës në këto komisione e ka zbeh rolin e këtyre dhe rrjedhimisht pastaj nuk i ka ndihmuar as kuvendit edhe nuk ka pasur aktivitet të duhur, qysh ka qenë më herët kur ka pasur pagesë. Ju kisha lutur që para votimit të na informoni çështjen e pagesës për këto. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina. Këtu pas ftesës publike kur të aplikojnë, caktohet edhe një nen aty që pagesa do të kryhet brenda të dispozitave ligjore, pra që ja jep ligji për pagesë të këtyre anëtarëve që do të zgjidhen. Vazhdojmë te pika ku mbetëm. Thamë që këtu janë pesë anëtarë, fillojmë me Partinë Demokratike.

Arjanit Berisha (PDK): Propozimi ynë është kolegu Adrit Krasniqi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Nga Lëvizja Vetëvendosje propozojmë Shqipe Shatri.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Qemal Krasniqi (LDK): LDK propozon Bajram Kastrati.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga Bashkimi Demokratik.

Liridona Veçgishti (BDP): Nga Bashkimi Demokratik Sefedin Islamaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Sefedin Islamaj. Faleminderit. Edhe një nga Edhe një pra nga komunitetet në këtë rast pra partia më e madhe KDTP-ja me numër më të madh të votave.

Sevilaj Igc Hapci (KDTP): Sevilaj Hpaci.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë me këto propozime e hedhim në votim. 33 janë të pranishëm. Kush është për? 32 për. A kemi kundër? Jo. Abstenim? Jo. Atëherë miratohet kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e radhës.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, a bën me ndalë këtu më seancën edhe me vazhdu nesër këto pikat e mbetura?

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë që mendoni ose hedhim votim ose vazhdojmë. Në fillim thashë që është seanca e ngarkuar me 17 pika. Që mendoni që nesër e vazhdojmë në ora 10:00 seancën. Atëherë vazhdojmë nesër pra vazhdimin e seancës në ora 10:00. Njoftoheni edhe me shkrim.

VAZHDIMI I SEANCËS – 27 SHKURT 2026

Simir Krasniqi (Kryesues): Përshëndetje për të gjithë pra. Jemi 26 në seancë dhe kemi korum që mund ta fillojmë këtë mbledhje. Përshëndetje të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar drejtorë, përfaqësues të mediave, shoqëri civile dhe ju të pranishëm. Kjo është vazhdimi i seancës së djeshme dhe kemi mbetur në pikën e 12 dhe fillojmë pra me pikën e 12, shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të veprimit për transparencë 2026-2030. E ftojme iniciuesin e pikës pra që ta propozoj pikën këtu dhe ta sqaron në përgjithësi.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të veprimit për transparencë 2026-2030

Ymer Berisha (Zyrtar për Komunikim me publikun): Përshëndetje, nënkuptohet për të gjithë që janë të pranishëm në sallë, edhe qytetarët e komunës së Prizrenit. Dokumentin e keni në mbajtje. Besoj që është profesionalisht i përgatitur, i shkruar mirë. Qëllimi i këtij dokumenti është rritja e besimit të qytetarëve, rritja e llogaridhënies para qytetarëve të komunës së Prizrenit, të promovojmë qeverisje të hapur, akses në informacion, pjesëmarrje sa më të madhe të qytetarëve në proceset vendimmarrje të komunës së Prizrenit. Objektivat, sigurimi i aksesit të drejtpërdrejtë dhe të jemi kompatibil me kërkesat dhe mënyrën e të jetuarit të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Komuna e Prizrenit përmes këtij dokumenti e hap mundësinë jo vetëm për kryetarin e komunës, jo vetëm për këtë institucion çfarë është kuvendi, e hap mundësinë për të gjithë të punësuarit në administratën e komunës së Prizrenit që të jenë llogaridhënës para përgjegjësive edhe nënshkrimin të kontratave të tyre. Po e bi një theks që jemi munduar me e bartur. Dokumenti evidenton dy organe kryesore, një që është më shumë sesa një person që është kuvendi me 41 në këtë rast tani dhe institucioni më i lartë administrativ që është pozita e kryetarit të komunës. E gjithë vendimmarrja e këtyre dy organeve edhe këtij me 41 edhe këtij me një person me një emër përveçem, është e obliguar që të jetë e zbardhur për të gjitha audiencat ose për të gjithë qytetarët e komunës e Prizrenit dhe më gjerë. Për arsye se viti 2026, viti 2030 e jep komunën e Prizrenit para qytetarëve të saj se është në lartësinë e përgjegjësisë ligjore, në lartësinë e përgjegjësive organizative dhe në lartësinë e praktikave më të mira të mundshme të politikbërjes dhe të vendimmarrjes si proces. E kaluara na thotë se nuk kemi pasur probleme të mëdha administrative dhe ligjore për arsye se nuk kemi të hapur as edhe një rast të vetëm, domethënë të kësaj natyre. Mirëpo, a ka vend për të përmirësuar gjatë proceseve vendimmarrëse, absolutisht jemi koshientë se po, mund të bëjmë edhe më mirë gjatë viteve në vijim. Dhe ky është premtim publik yni. Kryetari i komunës, zotëri Shaqir Totaj, ka kërkuar nga ne që absolutisht të gjithë ne jemi të qytetarëve, ta bëjmë jetën institucionale fillimisht si qytetarë të komunës së Prizrenit, të barabartë

me të gjithë të tjerët. Pastaj, meqë kemi marrë mandat nga qytetarët për të qeverisur mandate politike, atëherë të bëjmë më të mirën tonë për llogari të dokumenteve, për llogari të vendimmarrjeve të caktuara, të cilat i realizojmë nga një ditë në ditën tjetër. Normalisht, plani i veprimit për transparencë e ka dhe synimin të mbledhja e parave publike të komunës e Prizrenit dhe ato para të kthehen në vendimmarrje edhe në fatura. E gjithë paraja prej 75 milionë euro që është e shifër e rrumbullaksuar e vitit 2026, kur kthehet në vendimmarrje duhet të jetë e hapur për të gjithë qytetarët, për kuvendarët edhe të gjithë ata të cilët mund të shprehen interes edhe nga komuna të tjera, madje edhe nga shtetet tjera. Paraja e komunës së Prizrenit procedohet me një vendim, vendimi është publik për të gjithë dhe është i qasshëm në secilën ditë të javës ose në secilën ditë të vitit. Raportimet dhe prezantimet çfarë e kam edhe sot, do të ketë sa herë që kuvendi ka me e pa të arsyeshme, të drejtë, të nevojshme që të dalim, të raportojmë, do të jemi të gatshëm dhe e mbajmë këtë përgjegjësi sot edhe kurdo që ju e vlerësoni. Komuniteti turk sot filloi t'i kërkoj pak falje për arsye se dokumenti nuk është përkthyer në gjuhën turke dhe nuk është ofruar dhe ne tash e shihni se si mund të komunikohet edhe kur bëhet, meqë atje kemi dy zonja, të cilat gjatë trajtimit në kompjuteret e tyre, të paktën kështu unë e kam informacionin, kanë thënë që ka një shkarje ose ju ka ikur. Jemi detyruar që edhe njëherë me e përsëritur në drejtim të departamentit të përkthimeve, por ligjërisht i zëjmë afatet me votimin sot dhe normalisht përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës së Prizrenit, meqë niveli i Republikës së Kosovës e kemi gjuhën shqipe dhe gjuhën serbokroate si gjuhë zyrtare. Kemi probleme me gjuhën zyrtare të përkthimit boshnjak, nëse janë përfaqësues nga komuniteti boshnjak, për arsye se kemi vetëm një përkthyes, edhe ajo është zonjë, nëse eventualisht natyra e angazhimeve të femrave, ju jeni kushentë se cila është dhe ka raste kur për gjendje shëndetësore ose aktivitete të tjera, ajo mund të mos jetë fizikisht në komunë dhe çfarë të bëjmë pastaj? Do të duheshte alternativa të ofrojnë. Zyra që udhëheq unë e ka bërë fillimin, iniciimin e hapjes së politikës së tenderit për të kontraktuar një kompani, e cila bën përkthimin. Tash e kemi shtuar si kërkesë edhe përkthimin simultan eventual, derisa zyra e burimeve njerëzore në komunën e Prizrenit ta rekrutojë edhe një zyrtar të gjuhës boshnjake dhe t'i bëjmë dy në gjuhën turke, dy në gjuhën boshnjake dhe në këtë mënyrë ta përgjithësojmë vendimmarrjen. Aspekti tjetër është se ne jemi duke i dhënë referenca edhe për qeverinë e Republikës së Kosovës, meqënëse unë pak angazhohem edhe në atë forumin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Atje kemi një drejtor për digjitalizimin e shërbimeve dhe tash jemi tu i punuar, mirëpo kemi pak telashe me legjislacionin. Për shembull, inteligjenca artificiale me ligj nuk është e përligjur në territorin e Republikës së Kosovës dhe ky është vullnet tash i yni, sa mund ta shfrytëzoj, po nuk guxoj me e shti në plan të veprimit se ka akses edhe kjo tendencë e shfrytëzimit të dijes botërore për nevojat e komunës e Prizrenit, por sidoqë të jetë, jemi duke i zhvilluar disa softvere, kur qeveria e Republikës së Kosovës është e gatshme që t'i lëshojë këto platforma, do të digjitalizohet për shembull politika e subvencioneve. Nuk ka nevojë më me emër dhe mbiemër që atje të adresohet kërkesa. Online bëhet. Pastaj edhe në politikat e rekrutimit jemi duke e zhvilluar këtë që mos të jetë me emër, mbiemër personit që kandidon, thjesht të digjitalizohen këto shërbime, por po them, komuna e Prizrenit është duke dhënë impaktin e vet, përvojën e vet. Normalisht me lejen e kryetarit të komunës, se gjithçka shkon nën patronatin edhe kujdesin e tij. Por po them që jemi në konkurrencë me komuna të tjera relativisht mirë. Tani disa arritje që mund t'i kemi ne, e kemi pak problem me i shti në këtë planin e veprimit për transparencë për arsye se një pjesë e komunave të Kosovës, ndoshta për shkak të mundësive të tyre

administrative, nuk kanë mundur me e zhvilluar këtë digaster. A në anën tjetër? E ardhmja, viti 2030, thashë, i ka dy elemente. Qytetarët me ligj kanë të drejtë secilën vendimmarrje që e prodhon komuna, kushdo që prodhohet, ta kenë në me e pa edhe ta shfrytëzojnë bashkë si të duan ata, domethënë kërkesë ligjore, llogaridhënia duhet të jetë 24 në shtatë dhe ne të gjithë i shërbejmë që kësaj vendimmarrje ose kësaj atmosfere politike, e cila do të na prezantojë gjatë viteve në vijim. Dokumenti i shkruar është me kujdes maksimal, po them kemi mundur na me i shti edhe disa elemente si Prizren, por duke mos dashur me bë atë diferencën me komuna të tjera, jemi detyruar që ta rumbullaksojnë në nivel Kosovë. Kërkesa është edhe e Ministrisë që të jetë e tillë dhe unë jam dakorduar se nëse i bën mirë ky dokument disa komunave të tjera, atëherë mos të shtijmë në elemente të cilat mund t'i çojmë përpara. Duke e ditur edhe specifikën që në Prizren kemi edhe media lokale, të cilat i falenderoj shumë që këtë mesazhin tonë e mbartin te qytetarët pa pasur nevojë ne me shkuar atje. Mirëpo ka komuna të Kosovës të cilat nuk e kanë këtë mundësi dhe për atë arsye jemi kujdesur që dokumenti të jetë në harmoni të plotë me ligjin, deri vonë nga rregullorja për transparencë dhe t'i përmbush edhe detyrimet edhe kërkesat prej kryetarit të komunës, prej kuvendit dhe të gjithë zyrtarëve të cilët janë në komunën e Prizrenit dhe për këtë me të thënë të drejtën unë jam pak i kënaqur për arsye se jemi duke i marrë mendime edhe nga shoqëria civile në këtë grupin punues edhe nga bota jashtë komunës. Kështu që, në fund fare për mos me zgjatë mbetet hapësira e pyetjeve dhe përgjigjeve jam këtu gati. Në fund fare një kërkesë është gjithmonë valide edhe për opozitën, edhe për këtë, se kuvendi nuk e njih këtë normë as dhe ky plani për veprim të transparencës nuk e njih pozitën dhe opozitën, e njih kuvendin. Një kuvendar 41. A janë ata të cilët duan të aplikojnë politikën e transparencës ose jo? Mund ta mbani qëndrimin cili do që të jetë ai atje. Unë s'e kam atë atë problem. Por po them në aspektin intelektual edhe profesional, por edhe të vlerësimit në këtë rast të punës time dhe të komisionit që e kemi shkruar, këtë dokument do të doja vota të jetë sa më e madhe, mundësisht domethënë unanime. Por nëse nuk është e tillë le të jetë në funksion. Po prapë po them ne kur ballafaqohemi ose dalim me kërkesa me oponentët e tjerë të jemi si kuvend që jemi korrekt edhe të mirën kushdo që e sjell në kuvendin e komunës së Prizrenit ka hapësirë për t'u besuar, ka hapësirë për t'u votuar, ka hapësirë për të shkuar përpara të gjithë ne. Nëse isha i gjatë ndjesë edhe jam i gatshëm për pyetje eventuale. Faleminderit Haziz. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Ymer. Mund të ulësh këtu. Atëherë e hapim diskutimin. Karanfil Haxhillari e ka fjalën.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë kuvendar, sa i përket transparencës së Komunës së Prizrenit në vitin e kaluar pothuajse tërë vitin në webfaqen e komunës nuk i kemi pasur të publikuara pothuajse asnjë projekt, asnjë tender, asnjë konkurs të viteve paraprake. Ka qenë thjesht një lloj formatizimi i webfaqes së komunës. Çfarë defekti ka qenë nuk e di. Por zoti Ymer fole për transparencë, me pjesmarrje të qytetarëve, ku qytetarët e kanë të drejtën, por fillimi i vitit, i këtij viti 2026 u pa drejtë se kjo qeverisje çfarë transparence do të jetë u pa dje. Ku 16 kuvendarë, të cilët janë përfaqësues të qytetarëve dhe që ngërthen në vete mbi 12.000 vota të qytetarëve të komunës së Prizrenit, ju dje i përjashtut nga proceset mbikqyrëse dhe nuk po të them ty personalisht, por po flas për këtë qeverisje që tregon qartë se çfarë transparence do të ketë në vitet e ardhshme kjo qeverisje. Pra pa pjesëmarrje të opozitës, të cilët kuvendarët përfaqësojnë qytetarët, po e cek edhe njëherë mbi 12.000 dhe çfarë të flasim më tepër për

transparencë dhe përfshirje të qytetarëve sidomos komisionet të ndërmarrjeve publike, komisionet të cilët lidhen direkt me interesat të qytetarëve, komisionet të pronës dhe të cilët direkt implikojnë edhe interesat e qytetarëve. Dje tregoi kjo qeverisje se me çfarë transparence do të punon në këtë mandat qeverisës. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Karanfil. Mund të përgjigjesh zoti Ymer.

Ymer Berisha: Unë në mënyrë telegrafike dhe nëse do të ka s'është problem. Karanfil, unë jam idhtar i komunikimit sa më lejohet. Me është kërkuar nga kryetari i komunës edhe nga ligji që të hartohet një dokument sa më profesional dhe sa më përmbajtësor dhe kjo ka ndodhur. Tani se si do të mundemi me e zbatuar këtë, varet shumë nga secili veprim që ne e bëjmë. Por kërkush nuk na ndal, ne me nxjerrë më të mirën tonë në secilin kuvend, sa i përket publikimit të disa tenderve, po them kjo është lajm, në qoftë se është për arsye se dhe në KRPP duhet të publikohet. Nëse nuk janë publikuar, po ju bëj ftesë edhe sot, çdo gjë që vëreni që nuk është i publikuar e duhet është mirë në email, në SMS unë i kam krejt platformat. Domethënë nëse e ka komunikuar unë po njoftohem tash. Përndryshe unë s'po them që e kisha bërë publikimin. Po që isha marrë me këtë çështje po. Edhe kisha pasur një përgjigje adekuate ose adapte sot. Ka raste kur këto web faqet e komunave të Kosovës por edhe të qeverisë janë me një softver. Besoni që mund të keni përfaqësues edhe në qeveri atje, bisedoni me ata. Unë thashë jam tash i angazhuar part time në ministrinë që bashkëpunoj shkëlqyeshëm me ministrat e qeverisë së Republikës së Kosovës për llogari të digjitalizimit të shërbimeve në krejt Kosovën, jo veç komunën e Prizrenit. Po nëse veb-faqja nuk punon. Po ju bie edhe një akses sot. Sot ma bëri vlerësimin kryetari i komunës, kur shkuam me i thënë ruaje atje, preke sa të duash, nuk e ruan. Veç sillet edhe tash çfarë kemi me të bërë. Nëse na jepet një mjet që nuk është në funksion të asaj që bëjmë ne, detyra e jonë njerëzore është kjo. Ne ta kryejmë detyrën tonë me etikë dhe profesionalizëm, çfarë bën makineria duhet me e pa pak më vonë edhe me e pa. Përndryshe vlerësoj lart kontributin Karanfil.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Petrit Hoxha.

Petrit Hoxha (Guxo): Faleminderit kryesues. Përhëndetje i nderuar kryetar të pranishëm. Kolegu Karanfil pak më herët e cekti edhe tek çështja e rrjeteve sociale. Nëse hyjmë në platformën Facebook, i vërejmë katër faqe të komunës që janë në rrjetet sociale. Ka shumë qytetarë të cilët shënojnë, do thotë, edhe në faqet e komunës, sidomos në rrjetet Facebook dhe nuk ju përgjigjet askush. A kishte pasë mundësi që këto rrjete të cilat nuk janë aktive të mbyllen dhe të jetë veç një faqe që është faqe transparente për të gjithë qytetarët. Tjetra është që pse vetëm drejtorja e inspektoriatit ka faqe të Facebook-it, ndërsa dhe drejtori të tjera nuk kanë ose nuk ju lejohet. Ku është problemi do të thotë në këtë? Dhe mirë kishte me qenë që të jetë vetëm njëra faqe e Facebook-it zyrtare, të jetë e komunës së Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju.

Ymer Berisha: Petrit e çmoj gjetjen tënde, nëse është kështu, tash dëgjo. Komuna e Prizrenit ka një web faqe zyrtare, asaj edhe menaxhojnë do kjo domethënë edhe një zonjë edhe një zotni i lartë këtu, web faqet po rrjetet sociale thashë në mungesë të ligjit në Kosovë, edhe me fotografinë tuaj edhe timën dikush mund ta hapë një account në web faqe dhe pastaj e dimë çfarë mund të përdorë atje. Domethënë, por po them zyrtarisht web faqe, komuna e Prizrenit ka një web faqe.

Inspektorati, nëse e ka web faqen e Facebook-ut edhe drejtori të tjera, ato nuk mund t'i ndalojmë se prapë nuk kemi ligj me të cilët mund të thirremi për ndalim ose për urdhër që të hapni web faqe të tilla, por ideja është te komunikimi. Nëse drejtoritë kanë ndërtuar kapacitetin brenda tyre që e kanë një, që ka njohje të IT-së, pse mos me e hap në mënyrë që ju ofrojnë ndoshta që këto realizimin e projekteve që e bëjnë, e promovojnë punën e drejtorisë së tyre. Dhe ne si organ mbikëqyrës i kësaj situatë jemi pro. Domethënë deri kur nuk shkon te keqpërdorimi. Por unë thashë atje, problemi i vetëm është që ne nuk mundemi thënë hapeni web faqe se s'kemi ku bazojmë këtë kërkesë edhe mbyllemi web faqe se po ashtu nuk kemi ku e bëjmë. E këtë kujdesin me katër web faqe, unë inshallah jam duke na dëgjuar edhe në katin e dytë. Edhe duhet me hy' tash me verifikuar edhe duhet me i bërë report për arsye se aktivitet tjetër nuk kemi domethënë, po që mund të hapin ilegalisht web faqe, e dini ju rjetet sociale sot çfarë po bëjnë. Kështu që të falenderoj për idetë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po.

Petrit Hoxha (Guxo): Edhe tjetra është kam edhe një një pyetje për nënkryetarin e komuniteteve. Tash prapë po e lidhim me web faqen e Facebookit. A është rregull për shembull që kryetari i komuniteteve që në aktivitetet e veta publike që ka të bëjë që e përfaqëson komunën që në aktivitetet e veta publike të postoj shkrimin edhe në komunitetin boshnjak. Sepse unë e kam vërejtur që shumë raste ka veçanërisht në komunitetin turk, mirëpo jo edhe atë në komunitetin boshnjak. Që tash nuk e di qysh është e rregulluar me ligj, por thjesht më ka penguar një rast që përderisa është nënkryetar i komuniteteve, kishte me qenë mirë që të jetë edhe shkrimi në komunitetin boshnjak. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit këtu.

Ymer Berisha: Furkan nëse e di ligjin okej, nëse mendon që s'e di ligjin e jap unë përgjigjen?

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë fjala për nënkryetarin për komunitete, zotëri Furkan Bytyç.

Furkan Bytyçi (Nënkryetar për komunitete):

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit nënkryetar. A ka diskutues tjerë? Fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BPD): Faleminderit, kryesues, përshëndetje kryetar, përshëndetje kuvendar. Për transparencë, zotëri Ymer, edhe ju jeni shumë transparent, po kur flasim për transparencë, të cilën dje ne e pamë, se këtu secili i bën ato pyetjet e veta dhe s'janë të ngjashme, aty nuk kemi.. secili ka mendimet e veta. Foli për kuvendin, ajo më preki më tepër, kur tha se të gjithë këtu janë të barabartë 41 kuvendar. 40 se njëri ka më shumë atje e drejta, më shumë se ne. Që tha transparencë, fare nuk ka. Në letër po! Bile nuk e di, unë tash po lexoj pak më tepër se edhe kam filluar me u plak, po i shoh që në letër ka. Bile ngopesh me transparencë. Në praktik nuk ka këtu. Sepse dje u pa ajo se si u shkel opozita. Pastaj i përmenda disa komuna të tjera. Prizreni nuk krahasohet bre me disa komuna të tjera. Ata duhet me marrë shembull te ne. Ne kemi shumë raste e kam pa kur është marrë kopje paste prej komunave të cilat mos tash mos flas cilat janë ato, po ne s'mundemi me marrë prej disa komunave. Ata prej neve po. Munden me marrë shembull, se ne jemi për shembull Prizreni. E përmende inteligjencën artificiale. A ka mundësi me ditë a përdorin këto inteligjencën artificiale punëtorët e ju? A janë të varur prej saj a jo? Se tash edhe nxënësat kanë

filluar me u varur krejt prej saj. Kështu po më intereson që a punojnë apo vetëm i marrin të gatshme. Edhe për transparencë është edhe zyra e auditimit, po mendoj zyra kombëtare auditimit që kogja ka gjetur gabime, ka gjetur keqpërdorime, ajo ka dhënë atë vlerësimin më shumë. Po flas për ne si komunë. Kjo është për fillim.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit.

Ymer Berisha: Shukri, ti një jetë të tërë e ke burr kontribut në komunë edhe e ke nga themelimi i komunës edhe deri sot. Ne jemi bashkë vite edhe po provojmë me pru përvojën tonë, po gjithmonë në kontestin më pozitiv të mundshëm se edhe brenda familjes ka situata kur s'na pëlqejnë, brenda vetes tonë. Kaniher as qysh flas nuk më pëlqen. Le mo te të tjerët. Por ideja është kështu, ne kemi një hapësirë veç ligjore. Kryetari i komunës, zotëri Shaqir Totaj, po e bie edhe njëherë këtu. Kërkesën publike e ka. Ligji, zbatimi i praktikave më të mira të mundshme. Tani unë me grupin kam thënë, e kam pyetë veten, a mundem me shkruar vetë këtë dokument? Ka dalë jo. E kemi bërë një grup më të madh dhe ka mendime nga Ojq dhe nga të tjerët. Pastaj ky dokument ka shkuar në nivel qeverie. Për arsye se rastësisht kam qëlluar unë atje që jap pak kontribute, jo për ndonjë diçka tjetër. Edhe më kanë thënë a mund me e inkorporuar për krejt Kosovën. Okej, le të ndodhë. Edhe kjo tash është shpërndarë si draft. Secila komunë tani merr çfarë i përgjigjet asaj ose këtij. Inteligjencën artificiale unë po. Personalisht jam goxha idhtar i asaj. Për arsye se edhe në praktikë ta lehtëson mënyrën e të menduarit nganjëherë, se leje më të shkruarit, mirëpo nuk kemi të drejtë me i kërkuar zyrtarëve të tjerë se ligj nuk ka të aprovuar në nivel republike. Duhet me e pritë ligjshmërinë, pastaj ne me vepruar si institucion. Por unë po i bi disa prej praktikave që Prizreni, megjithatë, kur kjo e folura sot e jona, ky kontribut sot, ka me shkuar në qeveri të Kosovës dhe ka me thënë, "A e votuan këtë dokument a jo?" Nëse po, unë në mbledhjen e ardhshme kam me thënë, "Qekjo është sjellja e kuvendarëve të komunës së Prizrenit". Edhe hajde të shohim sjellje të këtillë, nëse është për shembull, nëse është nën nivelin e pritjeve që unë, realitetit nuk guxoj me ik. Por po du me thënë, secili e jetojmë të mirën e të keqen, a dokumenti bën thirrje, kuvendari është përfaqësues edhe i familjes time, Dafina Alishani sot përfaqëson edhe fëmijët e mi, aty. Sikurse zonja Ymrane Fusha, të barabarta. Edhe ne nëse sillemi që kështu në këtë frymë, besoj që unë e ti Shukri e kemi mshelur mandatin se u bën vite që jemi në komunë. Përndryshe të falenderoj shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Ymer. Mundësisht ma shkurt përgjigjet, Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Zotëri Ymer, ose komuna që ju po na shpjegoni, nuk është ajo komunë ku ne po jetojmë, ose kryetari që ju po na tregoni që ju ka kërkuar transparencë nuk është ai që ne po ballafaqohemi, ose jemi dy botëkuptime komplet të ndryshme edhe nuk po e di cila është reale e cila jo. Tash po dal, po flas pak si ju, qysh keni qejf. Singërisht për transparencë ne, qysh e tha dhe parafolësi, dokumente mund të prodhojmë sa të doni, mund të votojmë sa të doni. Po kur vjen puna në praktikë, ne po çalojmë si komunë e Prizrenit. Unë vetë personalisht bëj shpesh kërkesë për çasje në dokumente, jeni të informuar. Kur ju konvenon, na dërgoni dokumentet e plotësuar komplet. Po kam pasur raste që kam pasur edhe dokumente gjysmake. Tash zyra juaj arsyetohet që drejtoritë po na japin aq informata dhe ne vetëm jemi një farë urë lidhëse mes juve kërkuësve edhe drejtorive. Transparencë këtë komunë nuk ka. Ju prapë po them mund të bëni sa të doni dokumente, po qasja më së pari e kryetarit Totaj nuk është transparente aspak. Ju mund të thoni që edhe unë ju përfaqësoj edhe fëmijët e juaj, po qasja e

kryetarit i cili ka kërkuar me bë një dokument të tillë, nuk është e barabartë me asnjë kuvendar këtu. Në fushat na përshëndet gjithë opozitën, fushatë tregohet që ka bashkëpunim me opozitën dhe kur vjen puna as komisione monitoruese mbikëqyrëse nuk i jep hapësirë. Transparencë po flet me një kuvend ku asambleistët ngrisin pyetje dhe drejtorët nuk përgjigjen. Çfarë transparencë është kjo? Transparencë nuk është kur një kritik bëhet këtu për një drejtor edhe çohet edhe të thotë ki kujdes e të padis. Nëse është e pavërtetë në rregull, po sa herë që ne këtu kemi ngritur shqetësime, ne jemi akuzuar ose në personale ose jemi akuzuar si shpifsa. Edhe e fundit për rrjetet sociale tregomë çfarë transparence është kur kryetari i komunës apo ekipi i kryetarit të komunës, secilit kritikues në rrjetet sociale ja fut bllok vetëm e vetëm mos me pas komente të këqija. A ka të drejtë qytetari me e shpreh pakënaqësinë? A ka të drejtë asambleisti me e kritikuar edhe në rrjetet sociale që s'është e vërtetë çka postohet? Apo duhet me pas fake account për me pas monitorim zotëriun atje, menaxherin e performancës, i cili nuk e duron as kritikën. Edhe kallëzom, a është transparencë allahile kur kritikohet kryetari me u çu edhe me lëshu sallën sa herë që ka në kritikë. A po thuni që jemi të barabartë? A po thuni që 41 anëtarë këtu përfaqësojnë qytetarët? Bile me pas sabrin këtu me na dëgju. Nuk mundet ndoshta me të pëlqy po me na dëgju duhet me na dëgju. E këto për këto dokumente farse të cilat vetëm janë letër e nuk janë në praktikë ne nuk kemi votë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Për ju fjala zotëri Ymer.

Ymer Berisha: Tani unë veç në këtë pjesën e fjalimit nuk po hyjë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ymer, Kryetari e ka një takim që mundet përgjigjet më të shkurta që në të vazhdojmë me pikën e radhës.

Ymer Berisha: Dakord atëherë unë mund...

Simir Krasniqi (Kryesues): Mundesh përgjigju por më shkurt.

Ymer Berisha: Rrjetet sociale thamë nuk i trajton ligji dhe nuk mund të bëjmë asnjë veprim, janë praktikë në diskrecion të secilit individ. Por unë prapë po them, kryetari i komunës unë publikisht e kam dëgjuar që është kryetari i të gjithë qytetarëve të komunës përfshirë edhe 41 kuvendarët këtu. Kështu që nuk kam ndonjë përgjigje tjetër. Detyra ime ka qenë shkrimi i dokumentit edhe dokumentit të jetë konkurues ose të jetë funksional, për se si do të zbatohet, se si do të jetësohet në komunën e Prizrenit, të gjithë ne nga pak e dimë cila punë po e bëjmë për mirë apo jo për mirë. Përndryshe Dafinë edhe me ju unë ndaj shumë aspekte pozitive. Faleminderit për kontributin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, atëherë sa jemi që nuk kemi diskutues të tjerë, e hedhim në votim. 26 jemi në sallë, kemi kuorum. Sa jemi për që kjo pikë të kalojë? 18 për. Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet pika e rendit të ditës. Faleminderit zoti Ymer. Vazhdojmë me pikën e radhës.

Raporti i punës së kryetarit të komunës janar-dhjetor 2025.

Simir Krasniqi (Kryesues): Për ju fjala kryetar.

Shaqir Totaj (Kryetarë): Të nderuar asamblistë, të nderuar drejtorë, i nderuari kryesues, nënkryetari për komunitetet, mediat, edhe të gjithë të pranishmit, të gjithë prezentët që janë këtu. Du me ju falenderu secilit për kontributin që e jepni në një mënyrë ose tjetër. E kemi një raport të shkurtuar për vitin 2025, për shkak se raporti i përgjithshëm është shumë i gjatë, por ju e keni marrë atë raport edhe secilit prej juve, kuj do që t'i intereson diçka më tepër, mundet me gjetur në raport. Përndryshe, këtu e kam një version të shkurtuar, për mos me humb shumë kohë. Viti 2025, në përgjithësi, ka qenë një vit i suksesshëm. Ne e dimë që perfeksionizëm nuk ka, mirëpo përmirësimi gradual është synimi ynë edhe qëllimi ynë edhe konsiderojmë se në bazë të rezultateve të matshme, indikatorëve të matshme të performancës ka qenë një vit i suksesshëm. Ky raport përmbledh punën institucionale të komunës së Prizrenit gjatë vitit dhe synon të pasqyrojë jo vetëm aktivitetet dhe statistikën e realizuara, por mbi të gjitha drejtimin, prioritetet dhe ndikimin konkret të punës komunale në jetën e qytetarëve. Ka qenë një vit i punës intensive, konsolidimit institucional dhe vazhdimësi të projekteve strategjike, aq sa mund të jenë strategjike projektet në nivel komunal, një realitet me sfida të vazhdueshme ekonomike, sociale dhe infrastrukturore. Komuna ka ruajtur funksionalitetin, stabilitetin dhe orientimin drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Ky raport i shkurtuar është ndërtuar për t'u lexuar publikisht dhe për të reflektuar thelbin e punës institucionale duke ruajtur besnikërinë e plotë ndaj raportit të detajuar vjetor. Gjatë vitit 2025 komuna e Prizrenit ka funksionuar mbi parimin e koordinimit të mbrendshëm institucional dhe të përgjegjësi kolektive por edhe individuale. Drejtoritë komunale dhe njësitë varëse kanë vepruar si një trup i vetëm administrativ duke zbatuar politikën komunale dhe vendimet të organeve përkatëse. Një vëmendje e veçantë është kushtuar koordinimit ndërmjet drejtorive dhe respektimit të procedurave ligjore, transparencës në vendimmarrje, si dhe komunikimit me qytetarët dhe institucionet partnerë. Kur jemi te transparenca, ja vlen me theksuar se agjencionet e pavarura e vlerësojnë transparençën e komunës, në bazë të indikatorëve dhe kritereve të cilët ata paraprakisht i përcaktojnë. Gjatë vitit janë forcuar partneritet me institucionet qendrore, aty ku ka pasur mundësi, organizata ndërkombëtare dhe donatorë duke krijuar hapësirë për mbështetje financiare dhe teknike në projektet zhvillimore. Mesazhi kryesor i vitit 2025 ka qenë komuna duhet të funksionojë si institucion i besueshëm, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm ndaj kërkesave të qytetarëve. Financat dhe stabiliteti buxhetor. Menaxhimi financiar gjatë vitit 2025 është karakterizuar me një kujdes dhe një transparençë buxhetore. Të hyrat veterake komunale janë realizuar mbi nivelin e planifikuar. Janë tejkaluar diku 10.7 milionë euro, ndërsa shpenzimet janë menaxhuar në mënyrë të kontrolluar. Edhe pse kemi pasur shpenzime të cilat s'kemi mundur as me i menaxhuar as me i kontrolluar, ajo ka qenë intervenimi i përmbaruesit që e ka marrë komunën diku rreth 13-14 milionë euro veç për një vit. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-nëntor 2025 kanë arritur mbi 65.5 milionë euro. Në fokus kryesor kanë qenë pagat dhe shërbimet bazë, investimet kapitale, subvencionet dhe mbështetjet sociale. Ky menaxhim ka mundësuar vazhdimin e projekteve kapitale dhe garantimin e stabilitetit financiar të komunës. Qasja e ndjekur ka qenë e qartë. Paratë publike duhet të shërbejnë për interes publik dhe të menaxhohen me përgjegjësi dhe

me llogaridhënie. Gjatë vitit 2025 janë realizuar investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe objekte publike. Fokusi i veçantë i është dhënë shëndetësisë, objekteve arsimore, objekteve kulturore dhe sportive dhe rrjetit të shërbimeve publike. Kur jemi te çështja e sportit ne e dimë se kemi pasur një sukses që kisha me quajtë të veçantë sepse jemi shpallur qyteti evropian i sportit për vitin 2026. Por kjo ka ndodhur jo për shkak të vitit 2026, por për shkak të punës që është bërë gjatë vitit 2025 edhe më herët. Janë avancuar projekte kapitale në ndërtim dhe renovim të qendrave shëndetësore, objekteve kulturore, infrastrukturës sportive dhe hapësirave publike. Këto investime kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe funksionimit urban. Qasja ndjekur ka qenë më pak projekte në letër dhe më shumë projekte që qytetarët i shohin dhe i përdorin. Administrata komunale gjatë vitit 2025 ka përballuar një vulum shumë të madh kërkesash administrative, vetëm në sektor kyç janë ofruar mbi 80.000 çertifikata të gjendjes civile, mijëra shërbime administrative dhe teknike dhe është bërë një përmirësim gradual i proceseve përmes digjitalizimit. Njësia për burime njerëzore ka trajtuar mbi 2.700 kërkesa dhe ka zhvilluar 10 procedura rekrutimi në sektor jetik si shëndetësia dhe arsimi. Administrata ka qenë dhe mbetet mjeti kryesor për realizimin e politikave komunale, me synim që qytetari të marrë shërbim korrekt në kohë dhe me respekt. Siguria publike ka qenë prioritet i vazhdueshëm gjatë vitit 2025. Brigada zjarrfikse ka realizuar 740 intervenime, janë zgjeruar dhe mirëmbajtur kamerat e sigurisë. Është forcuar reagimi institucional në raste emergjente. Drejtoria e inspektorateve po ashtu ka realizuar qindra inspektime në treg, ndërtim, mjedis dhe rend urban, duke kontribuar në mbrojtjen e interesit publik dhe zbatimin e ligjit. Mesazhi institucional ka qenë i qartë. Siguria nuk negociohet, dhe ligji zbatohet për të gjithë. Shëndetësia komunale gjatë vitit 2025 ka ofruar mbi 840.000 shërbime shëndetësore për qytetarët. Janë realizuar investime në ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, furnizim me pajisje mjekësore, përmirësimin e kushteve të punës për stafin shëndetësor, njëkohësisht komuna ka ofruar mbështetje financiare për qytetarët në nevojë përmes subvencioneve dhe ndihmave sociale. Qasja ka qenë e qartë, shëndetësia dhe mirëqenia nuk janë shpenzim, por investim në dinjitetin e qytetarëve. Prizreni gjatë vitit 2025 ka ruajtur identitetin e tij si qendër kulturore, por edhe sportive. Janë realizuar investime në objekte kulturore dhe sportive, mbështetje financiare për OJQ-të dhe individët, organizimi i festivaleve dhe ngjarje kulturore sportive. Këto aktivitete kanë kontribuar në gjallërinë e qytetit, përfshirjen e rinisë dhe promovimin e vlerave kulturore dhe sportive, ku kultura dhe sporti janë trajtuar si shtylla të identitetit dhe kohëzimit shoqëror. Këtu vlen të përmendet se disa organizatave edhe pse ju janë ndarë subvencionet, akoma nuk i kanë marrë mjetet dhe kjo ka ndodhur për shkak të faktit se me përmbarues janë marrë diku rreth 13-14.000.000 euro dhe kjo ka shkaktuar një çrregullim të planifikimit buxhetor e pasojat ndër të tjerash që janë këto. Komuna e Prizrenit ka vazhduar për angazhim, për gjithëpërfshirje, barazi dhe respekt për diversitetin. Janë mbështetur komunitetet jo shumicë, është forcuar roli i zyrës për komunitete dhe është avancuar bashkëpunimi ndërkulturor. Integrimet evropiane dhe bashkëpunimi ndërkombëtar kanë qenë pjesë e vazhdueshme e agjendës komunale. Prandaj edhe kemi pasur shumë vizita nga shumë përfaqësues edhe të institucioneve edhe të ambasadave edhe të agjencive ndërkombëtare me fokus në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin me standarde evropiane. Mesazhi ka qenë që Prizreni është qytet për të gjithë qytetarët e tij. Viti 2025 për komunën e Prizrenit ka qenë vit i punës serioze, përgjegjësie, institucionale dhe rezultateve konkrete. Ky raport i shkurtuar pasqyron një pjesë të rëndësishme të kësaj pune, ndërsa raporti i detajuar mbetet dokument zyrtar i plotë. Komuna e

Prizrenit do të vazhdojë të punojë me përkushtim për zhvillim të qëndrueshëm, shërbimet cilësore dhe mirëqenie për qytetarët. Falenderimi i veçantë i drejtuar stafit komunal dhe qytetarëve për bashkëpunimin dhe besimin jo vetëm gjatë vitit 2025. Ju falenderoj për vëmendjen. Sikur që e thashë kjo është një variant e shkurtuar, përndryshe raportin e plotë e keni të gjithë edhe keni mundësi me lexu. Po dua me theksu se vitin e kaluar e kemi pas diku katër parë zgjedhje edhe ajo natyrisht që e ka afektuar pak edhe punën e komunës. Si e dini që kemi pas zgjedhjen shkurt në tetor, në nëntor, në dhjetor edhe domosdoshmërisht ka ndikuar, por megjithatë e kemi mbajtur një trend pozitiv, një fokus. Jo vetëm tek kualiteti, por edhe tek kvantiteti, edhe në rrethanat ekzistuese, me resurset që kemi në dispozicion, konsideroj që kemi pasur një performancë e cila mund të konsiderohet solide edhe serioze. Ju falenderoj për vëmendjen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit kryetar. Kemi ndonjë pyetje prej kuvendarëve? Ju thashë që kryetari ka një takim mundësisht. Urdhëro.

Karanfil Haxhillari (LVV): Tash normal kur lexohet një raport ka komente dhe ka edhe do të ketë edhe kritikë. Kuptohet. Në qoftë se i marrim raportin gjashtë mujor, kush e ka lexuar kuptohet. Edhe këtë raport 80% e këtyre dy raporteve është copy paste. Kështu që e keni pasur të lehtë. Ata të cilët e kanë lexuar raportin gjashtë mujor edhe këtë raport e kanë pasur shumë të lehtë, sepse veç 20% kanë mundur me pa dallueshmëri nga raporti i gjashtëmujorit të parë. Ky raport është një dokument voluminoz me 90 faqe raport vjetor, i cili në pamje të parë duket mbresëlënëse për nga numri i aktiviteteve, fotografive dhe statistikave. Por kjo nuk na impresionon nga sasia e faqeve apo nga numri i fotografive. Detyra jonë është ta analizojmë përmbajtjen, efektin real dhe përgjegjësinë institucionale të këtij raporti. Dhe po e them qartë se ky raport është më shumë një broshurë promovuese sesa një raport serioz llogaridhnie. Po nisim t'i kapim, vetëm t'i diskutojmë disa pjesë të këtij raporti. Prokurimi për shembull, shumë procedura, por edhe shumë ankesa. Thotë, gjatë vitit 2025 janë iniciuar 146 procedura prokurimi dhe janë nënshkruar 157 kontrata. Kurse në të njëjtën kohë janë paraqitur 138 kërkesa për rishqyrtim edhe 80 ankesa. Kjo është alarmante. Kur kemi kaq shumë ankesa dhe kontestime, kjo nuk është shenjë suksesi, është tregues i problemeve serioze në proceset tenderuese. Ku është analiza, pse kemi kaq shumë ankesa? Në raport u është dashtë të kemi edhe masa për përmirësime, pastaj edhe përgjegjësi administrative. Në raport nuk ka asnjë reflektim kritik, vetëm statistika sa i përket prokurimit. Buxheti, thotë ekzekutimi i lartë, por a ka efekt? Thotë shpenzimet buxhetore kanë arritur mbi 65 milionë euro me një realizim prej rreth 88%. Të hyrat vetanake janë realizuar mbi 100%. Këto janë shifra të cilët duken shumë mirë në letër dhe në këtë raport. Por pyetja thelbësore është, a po e ndinë qytetarët këtë sukses financiar? Sepse rrugët vazhdojnë të dëmtohen për çdo rreshje. Kanalizimet vazhdojnë të jenë problem në lagje të tëra. Një rreshje atmosferike, të gjithë qytetarëve i mbushen podrumet. Ndërtimet pa leje vazhdojnë të jenë realitet. Ekzekutimi i buxhetit nuk është sukses në vetvete. Sukses është ndikimi. Kalojmë te shëndetësia ku e përmendi kryetari thotë 840.000 shërbime shëndetësore gjatë vitit 2025. Mirë. Por sa ankesa i kemi pasur për shëndetësi? A kemi mungesë të barnave? A kemi mungesë mjekësh specialistë? Nuk mjafton të thuash 840.000 shërbime, kur një kohë të gjatë nuk kemi pasur edhe anestezion për dhëmbë në shumë qendra të mjekësisë familjare për qytetarët. Te inspektoriatet, gjopa dhe aksione por problemi vazhdon. Me mijëra gjopa, por realiteti në terren është tjetër. Prapë, hapësira publike të uzurpua, ndërtime pa leje, kaos urbanistik, zhurmë dhe ndotje sa dush. Nëse kemi kaq shumë kontrole, pse këto

probleme po vazhdojnë? A kemi mungesë të vullnetit politik? Po. A kemi ndërhyrje selektive? Po. Raporti nuk i prek këto çështje. Urbanizmi flitet për planin zhvillimor komunal dhe plane rregulluese, por qyteti vazhdon të ndërtohet pa vizion të qartë dhe funksional. Legalizimet dhe ankesat janë të shumta. Ndërtimet shpesh bëhen më shpejt sesa reagon inspektoriati. Strategjitë në letër nuk mjaftojnë. Shtoja këta që ky premtim për funksionalizimin e zonës ekonomike ende mbetet vetëm një premtim dhe asgjë konkrete në realitet. Pra ky raport është një raport pa vetë kritik. Ky është problemi më i madh i këtij raporti. Nuk tregojnë as për dështime, as për vonesa, as për projekte të papërfunduara, kontratat e zgjatura me anekse, probleme administrative, një raport i shëndetshëm përmban edhe vetëkritik. Ky dokument është pothuajse vetë lavdërim. Qeverisja me fotografi, jo me matje. Raporti përmban shumë fotografi nga takime, aktivitete, vizita, por qytetarët nuk jetojnë nga fotografitë. Qytetarët jetojnë nga ujë i pijshëm, nga rrugë funksionale, me transport publik, shërbime cilësore, administratë efikase. Ne nuk kemi dhe qytetarët nuk kanë nevojë për marketing institucional. Ky raport jep shumë numra, jep shumë aktivitete, por jep pak analizë të ndikimit dhe pothuajse zero vetëkritikë. Kjo nuk është llogaridhënie e plotë. Dhe në fund Prizreni meriton transparencë. Mënyra se si paraqitet raporti është selektive dhe e njëanshme. Prizreni meriton transparencë reale, analizë të sinqertë, pranim të gabimeve, përmirësim sistematik, jo propagandë institucionale. Nëse duam ta respektojmë qytetarin, me sinqeritet institucional.

Shaqir Totaj (Kryetar): E falenderoj Karanfilin, po disa kështu disa komente po du me dhënë, jo përgjegje. E para tha, raporti nuk na ka impresionuar. Nuk është qëllimi i këtij raporti me impresionuar askënd, po me paraqit gjendjen faktike ashtu që është. Edhe u përmend fjala vetëkritik. Fjala raport edhe vetëkritik janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Raporti i paraqet të dhënat, statistikat të punëve që janë kryer. Është raport i punës. Raporti i punës nuk i paraqet punë që nuk janë kry, po i paraqet punë që janë kry. Prandaj edhe quhet raporti i punës. Kurse analiza e ndikimit të punëve tona në kualitet të jetës të qytetarëve e ka dhënë votuesi vitin e kaluar. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit kryetar. Fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit. Përshëndetje kryetar, ju drejtorë që jeni këtu prezent, të buzëqeshur, të hareshëm. Përshëndetje për anëtarët e kuvendit, median. Unë.

Shaqir Totaj (Kryetar): Edhe ti qenke në disponim.

Haziz Hodaj (LDK): Po, është e vërtetë. Se e kam lexuar një raport shumë pozitiv, andaj. Unë edhe në debatin për hartimin apo promovimin e miratimin e buxhetit, e kam dhënë një vërejtje, por po e përsëris. Çështja e këtyre pagesave nëpërmes përmbaruesve, që realisht lënë pasoja edhe për vitet e ardhshme, edhe për këtë vit, sigurisht që do të kemi pasojë nga ajo pagesa me përmbarues e e vitit të kaluar që është me shuma jo shumë të preferueshme. Dhe nuk arsyetohet pagesa me përmbarues për operatorët që kryejnë punë, që kanë një kontratë, që kanë një dinamikë të kryerjes punimeve, që kanë një afat edhe për pagesa. Sigurisht që është arsyetim pagesa nëpërmes përmbaruesit të këto kontratat kolektive që realisht do duhemi mi parapa si pozicion buxhetor edhe ato, për mos me pas pasoja në vitin e ardhshëm pastaj për pagesat, sepse pagesat nëpërmes përmbaruesve sigurisht që e çrregullojnë çdo gjë, çdo transaksion financiar në buxhetin e komunës.

Andaj, përveçse me parapa një pozicion buxhetor për kontratat kolektive, që ato janë ato janë reale edhe ato ndodhin, po kjo pagesa e operatorëve që kryen punët këto që kryen shërbimet, kjo nuk mund të arsyetohet pagesa nëpërmes të përbaruesve sepse mandej kushton edhe më shtrenjtë, por edhe çrregullon çdo gjë në vitin e ardhshëm. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Haziz. Vazhdojmë.

Shaqir Totaj (Kryetar): Veç një informacion Hazizit. Ministria e Financave nuk na jep pozicion, nuk na jep kod për me mund me i planifiku shpenzimet të cilat lindin si rezultat i aktiviteteve përmbare. S'mundem me i planifiku se nuk na lejohen. E planifikon po s'ki pozicion në buxhet s'ke ku me qit se ministria nuk ta pranon.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit kryetar. Fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zoti kryesues. Të nderuar të pranishëm, të nderuar kryetar, ekzekutiv, koleg kuvendarë. Së pari dëshiroj të rikujtoj se ligji për vetqeverisjen lokale nuk parasheh raportime vjetore. Por raportime gjashtë mujore. Në korrik të vitit të kaluar është paraqitur raporti për pjesën e parë të vitit, ndërsa sot para nesh do të duhej të ishte vetëm raporti për gjashtëmujorin e dytë të vitit të kaluar. Mirëpo, duket se angazhimi juaj kryetar në fushatën zgjedhore. E pse po ikni kryetar?

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju thashë kryetari ka takim me UNICEF-in për atë që në ora 11:00.

Ilir Gashi (LVV): Nuk e di, ndoshta është një shenjë e mirësjelljes minimale që me marrë leje prej anëtarëve të kuvendit që kanë ardhur enkas për me dëgjuar raportin e tij. Qysh kishte me bë një njeri me një edukatë modeste, minimale, a kupton? Me kërkuar leje, qysh e kemi një traditë me marrë izën edhe me shku. Ose me na lajmëruar paraprakisht që kryetari sot nuk është gjendje me dëgjuar asambleistët në lidhje me raportin e punës së vet. Edhe ne e kishim shty për të hanën, për shembull, takimin tonë, është shumë normale. Tërë këta njerëz kanë ardhur këtu për kryetarin. Edhe ai, pa marrë leje, pa paralajmëruar, çohet edhe shkon, ik. Edhe atij duhet me ja ndërruar emrin, me bë Shaqik Tutaj. Edhe ik, edhe tutet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Tham që ka takim edhe nuk është që e bëni prezantimin e raportit të punës pra për 2025.

Ilir Gashi (LVV): Nuk ka pasur nevojë me bë prezantim se e kemi pasur letër, e kemi lexuar të gjithë, jemi përgatitur.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Kjo tregon qasjen e kësaj qeverisje, nëse ju vazhdoni kështu, atëherë dhe ne lirojmë sallën, ju vazhdoni pa kourum, ne e ftojme kryetarin këtu, raportimi nuk është veç me lexu një tekst aty edhe me tregu gjëra të pavërteta, raportimi ka shumë shumë çështje për me u diskutua, njëherë duhet me ardhë këtu, dy herë në vit vjen, edhe kjo arrogancë, ky lëshimi sallës, e tregon në një kulturën e tij, e tregon qasjen e tij edhe tregon ky pushtet çfarë halli ka. Domethënë nuk është në gjendje me diskutu as qato gënjeshtër që i ka shkruar në raport edhe me u ballafaqu me ato. Lehtë e keni ju me liruar salla po qytetari po ju sheh, edhe Lëvizja Vetëvendosje e liron sallën edhe ju vazhdoni me këtë arrogancë se shumë mirë ka me ju dalë.

Simir Krasniqi (Kryesues): 10 minuta pauzë edhe kthehem. Ja 10 minuta pauzë edhe kthehem.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Pra, fillojmë me pikën e rendit të ditës. Kemi kuorumin e mjaftueshëm për ta filluar pikën e rendit të ditës. Jemi me 21 kuvendar pra në sallë. Pika e rendit të ditës është kjo, pika e 14.

Raporti financiar vjetor janar-dhjetor 2025.

Simir Krasniqi (Kryesues): E ftojme iniciuesin e pikës, drejtorin e ekonomisë dhe financave që të raportoj.

Levent Bus: Përshëndetje të gjithëve, përshëndetje kryesues, koleg, drejtor, anëtar, media. Raporti financiar janar-dhjetor 2025 të hyrja të përgjithshme të buxhetit komunal është si e dini buxheti miratuar 2025 është 70.852.476 euro. Buxheti me ndryshimet 75 milion 127.895 euro. Planifikimi të hyrave vetanake gjatë vitit 2025 është 10.600.777 euro. Realizimi janar-dhjetor është 2025 është 11.559.588 euro. Shpenzimet të buxhetit komunal për janar-dhjetor 2025 është 72.999.420 euro, domethënë që vjen 97.09%. Pagesat e kryera sipas vendimit gjyqësor, si e dini, mallrat dhe shërbime i kemi 4.052.091 euro, shpenzimet kapitale i kemi 17.843.992 euro. Që doni edhe për shpenzimet sipas kategorive të drejtorëve? Po shkoj kështu planifikim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtor, që pajtohen kuvendarët materialin e kanë marrë me kohë.

Levent Bus: Që e keni ndonjë pyetje e kemi edhe ekspertin këtu, mundet me dhënë përgjigje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Ka diskutime rreth kësaj pike? Atëherë që s'ka diskutime kalojmë pikën e radhës.

Diskutimi rreth raportit të zyrës kombëtare të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2024 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024.

Simir Krasniqi (Kryesues): E hapim diskutimin këtu. Po shefi i grupit të PDK-së, Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): Përshëndetje të nderuar kolegë. Veç një thirrje për të gjitha drejtoritë edhe për kryetarin, ato vërejtje të auditorit, e di që tash është ekzekutiv i ri edhe normal që i ka gjetur gjetjet të auditorit, nuk janë punët e tyre, mirëpo të fokusohen te gjetjet e tyre në mënyrë që të evitohen këto, ndoshta nuk janë të natyrës shumë serioze, mirëpo qëllimi është që të kemi performancë sa më të mirë edhe të punojmë drejt asaj që gjithmonë të ofrojmë shërbime më të mira ndaj qytetarëve, duke i evituar gjetjet që janë bërë në raportin e auditorit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Ariamit. Ka diskutues të tjerë? Atëherë që nuk ka, vazhdojmë me pikën e radhës së rendit të ditës. Pikën e 16.

Informatë rreth raportit për planin e integritetit për vitin 2025.

Simir Krasniqi (Kryesues): E ftojme iniciuesin e pikës. Një prezantim të shkurtë që ne ta dimë kush jeni dhe që e bëni prezantimin e planit të integritetit për vitin 2025.

Emine Gashi (Zyrtare): Përshëndetjetë gjithëve. Jam Emine Gashi, zyrtare ligjore e Drejtorisë së Administratës. Në kuadër të zbatimit të planit të integritetit, sot para jush informoj raportin e planit të integritetit për vitin 2025. Plani i integritetit nuk është vetëm një obligim formal, por një mekanizëm konkret që ndihmojnë në identifikimin e rreziqeve dhe përcaktimin e masave parandaluese. Ky plan është një dokument kyç për formimin e transparencës, llogaridhënies dhe etikës profesionale. Plani i integritetit ka bazë ligjore në ligjin e agjencisë për parandalimin e korrupsionit. Raporti në agjenci është obligim institucional dhe realizohet çdo gjashtë muaj. Në plan janë paraparë gjithsej 50 fusha të rrezikut. Nga këtu, 21 fusha të rrezikut janë realizuar plotësisht, duke përfshirë zbatimin e masave të parapara dhe përmbushjen e objekteve të përcaktuara. 27 fusha të rrezikut janë realizuar pjesërisht, ku masat janë në proces dhe kërkojnë angazhim në vitin pasues, dy fushat e rrezikut mbeten të porealizuara, të cilat kanë rezultuar se nuk kanë qenë adekuate dhe funksionale për institucionin tonë. Informatë shtesë është përditësimi i planit. Në përputhje me kërkesat ligjore dhe rekomandimet e agjencisë, gjatë procesit të përditësimit janë analizuar rezultatet e zbatimit, janë reflektuar ndryshimet organizative dhe janë harmonizuar masat me nevojat aktuale institucionale. Drafti është finalizuar. Agjencia ka konfirmuar se plani është në rregull dhe për vitin 2026 do të punohet me këtë plan të përditësuar. Faleminderit për vëmendjen. Keni pyetje?

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. E hapim diskutimin. Atëherë që nuk keni pyetje, vazhdojmë me pikën e radhës. Faleminderit nga ju. Pikën e fundit, pikën e 17.

Informata rreth raportit të performancës për komunën e Prizrenit për vitin 2024.

Simir Krasniqi (Kryesues): Për ju fjala zoti Haziz.

Haziz Krasniqi (Zyrtar): Edhe unë po i bie shkurt. Faleminderit kryesues. Të nderuar drejtor, anëtar të kuvendit. Unë po bëj shumë të shkurta pse kam dokumente shumë për me i diskutuar. Veç dua me jap një informacion që komuna e Prizrenit në mesin e 38 komunave që ka Republika e Kosovës është e katërta sa i përket performancës komunale. Prej 38 komunave, komuna e Prizrenit është me 81.28 pikë të përqindjes. Kjo bën komunën e Prizrenit që e para në nivel të vendit sa i përket komunave të cilat kanë mbi 100.000 banorë. Komunitat që janë në vendin e parë, të dytë edhe të tretë janë komunitat që kanë diku 50.000 banorë. Performanca matet për 16 fusha

me 93 indikatorë dhe dhjetra nën indikatorë. Sa për informacionin tuaj shtesë, aktualisht është i hapur sistemi i performancës për me i fut të dhënat për performancën të 2025-ës. Komisioni është duke kryer punën e vetë. Unë si koordinator jam duke ndihmuar në këtë proces. Sigurisht që këto punë të madhe bëjnë drejtorët edhe pa mbështetjen e kryetarit të komunës së Shaqir Totaj nuk kishim mundur me ardhë deri tek kjo përqindje. Faleminderit. Nëse keni diçka?

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Haziz. E hapim diskutimin, kemi pyetje? Atëherë që nuk kemi pyetje, e mbyllim këtë seancë dhe shihemi në seancat e radhës të rregullta. Ju faleminderit për pjesëmarrjen.



Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi